



HETIMI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI: Manual Trajnimi për një forcë policore profesioniste

Përkthim i bashkëfinancuar
nga Bashkimi Evropian



HETIMI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI:

Manual Trajnimi për
një forcë policore
profesioniste

Autorë

**Joanna Perry
dhe Paul Franey**

Redaktimi juridik

Altin Hazizaj

Ky manual u përkthye dhe redaktua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të asnjë pale.

© 2020 Këshilli i Evropës.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. I licencuar në Bashkimin European sipas 21 kushteve të miratuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme ose përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çfarëdo sistemi depozitimi ose marrjeje informacioni, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimit (F67075- Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Lënda

HYRJE	5
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI MANUALIN	7
MODULI 1: PSE JEMI KËTU?	9
MODULI 2: KONCEPTET KRYESORE	22
MODULI 3: POLICIMI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI	52
MODULI 4: HETIMI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI	67
MODULI 5: BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE	105
“SI DO TË VEPROHET MË TEJ”: HARTËZIMI I HETIMIT TË KRIMEVE TË URREJTJES SIPAS KONTEKSTIT TË VENDIT, POLITIKAT PUBLIKE	122
ANEKSI 1: MODEL PROGRAMI PËR ORGANIZIMIN E TRAJNIMEVE NJËDITORE DHE DYDITORE	126

Hyrje

Policia është në vijën e parë të sistemit të drejtësisë penale dhe pika e parë e kontaktit për shumë viktime të krimeve të urrejtjes.¹ Pa zotëruar aftësitë bazë për identifikimin dhe hetimin e krimeve që ndodhin për shkak të urrejtjes së personave LGBTI², policia nuk mund të sigurojë drejtësi dhe mbrojtje për viktimat, të fitojë besimin e komunitetit apo të kontribuojë për zbatimin e paanshëm dhe transparent të ligjeve të vendit për krimet që kanë për bazë urrejtjen.

Këshilli i Evropës ka punuar për një kohë të gjatë për ndërgjegjësimin e publikut mbi dhunën e shënjestëruar, përfshirë krimet që ndodhin për shkak të racës, fesë, gjinisë apo urrejtjen për shkak të homofobisë dhe transfobisë. Rezolutat kryesore të Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e Komitetit të Ministrave, si dhe ato të Asamblesë Parlamentare, pranojnë dëmin dhe ndikimin që kanë diskriminimi dhe krimet kundër personave LGBTI, si dhe rëndësinë e mbështetjes së viktimave, bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe trajnimit të profesionistëve ligjzbatues dhe profesionistëve të tjerë në fushën e drejtësisë penale.³

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e qartë për sa i takon rëndësisë së “demaskimit” të motiveve të urrejtjes për shkak të homofobisë, duke paralajmëruar pasojat e mosveprimit në këtë mënyrë: “Krimet me motive paragjyquese pa dyshim do të ishin trajtuar njëjloj si çështjet e zakonshme gjyqësore pa këto nuanca, por indiferenca, do të ishte njëjloj si t’i pranoje zyrtarisht krimet e urrejtjes apo, madje, si të bëje një marrëveshje të heshtur me to”⁴

Ky Manual është parashikuar për trajnerët e punonjësve të policisë, hetuesit, drejtuesit e policisë apo prokurorisë, punonjësit që trajtojnë krimet e urrejtjes apo oficerët e policisë që punojnë në vijën e parë, në vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Qëllimi i Manualit është që të ofrojë mbështetje, informacion dhe mjete të përshtatshme për kryerjen e trajnimeve për hetimin e krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI. Manuali mbështetet në standardet e Këshillit të Evropës, sidomos në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe në standarde të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe materialet që ekzistojnë tashmë për trajnimin e zyrtarëve ligjzbatues.

Ky Manual mbështetet tek qasja e të drejtave të njeriut dhe kontributi i ekspertëve të fushës. Mbi të gjitha, Manuali vendos në qendër të vëmendjes viktimën dhe komunitetin, duke pranuar se besimi i tyre tek zbatimi i ligjit dhe bashkëpunimi është kyç i suksesit të hetimeve të këtyre krimeve.

Trajnimi i policisë është vetëm një element i qasjes gjithëpërfshirëse ndaj hetimit dhe ndjekjes së krimeve të urrejtjes. Sistemi i dokumentimit që përdor policia duhet të bëjë të mundur dokumentimin e gjithë aspekteve të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, ndaj praktika e mirë hetimore duhet të mbështetet dhe shoqërohet me protokolle dhe udhëzues të tjerë zyrtarë të përgatitur nga Policia. Duke qenë partner kryesor i policisë, Prokuroria dhe prokurorët duhet t’i nënshtrohen trajnimit, në mënyrë që të përgatiten dhe të dërgohen në gjykatë çështje të suksesshme dhe objektive të krimeve për shkak të urrejtjes. Së fundi, edhe zyrtarët dhe drejtuesit politikë që njohin dëmet që sjellin krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI duhet të angazhohen për sigurimin e burimeve të nevojshme me qëllim zhvillimin në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë të këtyre trajnimeve.

1. Këshilli i Evropës pranon se termi “viktimë” nuk pranohet nga shumë njerëz, të cilët kanë qenë në shënjestër të krimeve të urrejtjes. Ne e pranojmë se, në shumë raste, njerëzit preferojnë termin “i mbijetuar” meqenëse ai pasqyron më mirë përvojën që kanë përjetuar. Në këtë Manual përdoret termi “viktimë” pasi ai përputhet më mirë me statusin ligjor dhe teknik të një personi të vënë në shënjestër nga krimi për shkak të urrejtjes, i cili është në kontakt me policinë dhe agjencitë e ndjekjes penale më gjerë. Siç theksohet gjatë gjithë Manualit, policia duhet të zbatojë një qasje që vendos në qendër viktimën, si dhe ta pyesë personin se si preferon që t’i drejtohen dhe, kurdo është e mundur, duhet t’i drejtoheni sipas zgjedhjes së bërë nga vetë personi i dëmtuar.
2. Personat lezbike, gejt, biseksualë, transgjinatorë dhe interseks.
3. Shih, sidomos, Rekomandimin CM/Rec(2010)5 të Komitetit të Ministrave për Vendet Anëtare lidhur me masat për luftimin e diskriminimit për shkak të orientimit seksual apo të identitetit gjinor; dhe Rezolutën 2048 (2015) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës “Për diskriminimin kundër personave transgjinatorë në Evropë”.
4. Shih “Identoba kundër Gjeorgjisë”.

Ky Manual mbështetet në standardet e Këshillit të Evropës për luftën kundër krimeve për shkak të urrejtjes dhe diskriminimit, si dhe tek puna dhe ekspertiza e Njësisë për Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor për të asistuar Vendet Anëtare lidhur me zbatimin e politikave efektive, legjislacionit dhe masave praktike për identifikimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI dhe mbrojtjen e viktimave të këtyre veprave.

Vështrim i përgjithshëm mbi Manualin

Ky Manual përmban pesë module si dhe Seksionin “Si do të veprohet më tej”. Modulet konsistojnë në aktivitete të ndryshme praktike që zbërthehen në hapa të qartë, përfshirë të dhëna specifike për bashkërendimin e kohës dhe udhëzues për punët përgatitore që duhen bërë gjatë trajnimit.

Moduli i Parë përqendrohet tek rëndësia e rolit të strukturave drejtuese të policisë dhe angazhimit për suksesin e trajnimit të policisë për ndjekjen e krimeve të urrejtjes, e cila siguron shqyrtimin në një periudhë të hershme të pasojave të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, duke u dhënë mundësi pjesëmarrësve që të mësojnë për kontekstin më të gjerë të diskriminimit dhe paragjykimeve që përjetojnë personat LGBTI në vendet e Këshillit të Evropës.

Moduli i Dytë mbështet pjesëmarrësit që të arrijnë të kuptojnë konceptet kryesore, si: “orientimi seksual”; “identiteti gjinor” dhe “karakteristikat seksuale”; “krim i urrejtjes”, si dhe koncepte më të gjera si: “homofobia”, “transfobia”, “stereotip” dhe “diskriminim”. Ai krijon bazën për përdorimin e teknikave më specifike të hetimit të krimeve të urrejtjes, që trajtohet në Modulin e katërt.

Moduli i Tretë përmban ushtrime që fuqizojnë mbështetjen edhe më të madhe të punonjësve të agjencive ligjzbatuese tek standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut në përpjekjet e tyre për hetimin me efektivitet të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI. Në materiale përfshihet një vështrim gjithëpërfshirës dhe ushtrime praktike të standardeve më të rëndësishme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që duhet të forcojnë policimin efektiv të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI.

Moduli i Katërt përqendrohet tek qasja që vendos në qendër viktimën, për zhvillimin e hetimeve të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, dhe aftësitë kryesore që duhen për mbledhjen e provave që kanë si motiv kryesor paragjykimet, si elementin kryesor që bën dallimin ndërmjet krimeve të urrejtjes nga krimet e zakonshme. Hulumtohen në mënyrë të posaçme nevojat e veçanta të personave transgjinorë, si viktima të krimit. Së fundi, pjesëmarrësit ftohen që të pranojnë sfidën për të hyrë në kontekstin e marrëdhënieve aktuale që kanë me komunitetin LGBTI në vend.

Moduli i Pestë ndihmon pjesëmarrësit që të kuptojnë punën e organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) dhe se si mund të punojë policia më mirë së bashku me to për përmirësimin e përgjigjes ndaj viktimave. Moduli përfshin kontributin e drejtpërdrejtë të organizatave të shoqërisë civile, të cilat shpjegojnë shërbimet që ofrojnë, të dhënat që kanë mbledhur dhe çfarë kanë mësuar lidhur me nevojat e viktimave LGBTI. Ky do të jetë një rast për pjesëmarrësit që të bashkëpunojnë me përfaqësuesit e shoqërisë civile me qëllim identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim dhe bashkëpunim.

Qëllimi i seksionit të fundit (që është fakultativ), “Si do të veprohet më tej”, është që të mbështesë pjesëmarrësit për të identifikuar çështjet që mund të pengojnë zbatimin e trajnimit në shkallë vendi, dhe për të zbatuar një qasje që synon zgjidhjen dhe trajtimin e këtyre çështjeve. Pjesëmarrësit inkurajohen që të krijojnë një hartë të kontekstit të tyre kombëtar, përfshirë boshllëqet dhe mundësitë, bazuar në elementet kryesore të nevojshme për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj krimeve për shkak të urrejtjes, përfshirë: kuadrin ligjor; sistemet e dokumentimit të krimeve të urrejtjes; disponueshmërinë apo mungesën e udhëzimeve dhe udhëzuesve për ndjekjen e krimeve të tilla; trajnimin dhe shërbimet e specializuara për mbështetjen e viktimave etj.

SHËNIM PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC-TË)

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) janë një partner i rëndësishëm i policisë në përpjekjet e saj për të kuptuar dhe reaguar me efektivitet kundër krimeve që ndodhin për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI. Duke pranuar rolin e tyre qendror për monitorimin e krimeve të urrejtjes dhe mbështetjen e viktimave, Këshilli i Evropës ka përfshirë OSHC-të më të rëndësishme në hartimin dhe botimin e këtij Manuali, duke i falënderuar për mbështetjen e tyre.

OSHC-të janë një burim i rëndësishëm për policinë në disa çështje specifike: si ofruese të shërbimeve mbështetëse për viktimat, partnere në trajnim për policinë dhe burim thelbësor të dhënash dhe informacioni lidhur me përhapjen dhe ndikimin e krimeve të urrejtjes. Për këtë arsye, çdo modul përfshin informacione se si mund ta shfrytëzojë policia ekspertizën dhe mbështetjen e organizatave të specializuara të shoqërisë civile. Moduli i Pestë i kushtohet të mësuarit për të punuar sa më mirë me OSHC-të për identifikimin dhe hetimin me efektivitet të krimeve të urrejtjes dhe për mbështetjen e viktimave.

Gjithashtu, OSHC-të përbëjnë një grup të rëndësishëm i cili synohet nga ky Manual, që mund të përdoret si një burim përkrahjeje për inkurajimin e forcave policore lokale dhe kombëtare që të mund të ndjekin seanca trajnimi lidhur me hetimin dhe reagimin kundër krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI.

SI DUHET PËRDORUR KY MANUAL: NJË QASJE E PËRSHTATUR

Ky Manual është përgatitur në mënyrë të tillë që të lehtësojë fleksibilitetin maksimal të trajnerëve. Aktivitetet dhe modulet duhen zgjedhur sipas përbërjes së pjesëmarrësve, nevojave të organizatës pritëse apo kërkesave të tjera specifike si kufizimet kohore, etj.,. Rekomandohet që trajnuesi të lexojë vështrimin e përgjithshëm të Manualit, si dhe modulet specifike, aktivitetet dhe shënimet për trajnuesit, me qëllim që të vlerësojë cilat module dhe aktivitete janë më të përshtatshmet për trajnim.

Për lehtësi referimi, agjendat model për trajnime një ose dyditore gjenden tek Aneksi 1. Për të patur kohën e mjaftueshme dhe angazhimin që duhet për arritjen e rezultateve kryesore për sa i takon të të mësuarit, rekomandohet ndjekja e agjendës dyditore. Gjithashtu, rekomandohet që trajnuesit ta lexojnë Manualin përpara finalizimit të agjendës për t'u siguruar që për kontekstin e tyre lokal janë zgjedhur modulet dhe aktivitetet më të përshtatshme.

Moduli i Parë: Pse jemi këtu?

HYRJE NË TRAJNIM DHE QËLLIMI I TIJ

Ky modul jep një pasqyrë të përgjithshme të trajnimit. Ai shpjegon se pse është i rëndësishëm trajnimi dhe çfarë do të mësojnë pjesëmarrësit nga policia duke marrë pjesë në të. Në qendër të modulit është hapja e tij nga një drejtues i Policisë, i cili rendit arsyet pse janë të rëndësishme të kuptuarit, hetimi dhe ndjekja e krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, duke shprehur pritshmërinë se pjesëmarrësit do të angazhohen në trajnim dhe në përpjekjen për të mësuar. Me qëllim zbatimin në një periudhë afatgjatë të dijeve që merren nga ky trajnim, është thelbësore që të gjithë ata, të cilët kanë role drejtuese në polici, të jenë tërësisht të angazhuar për të mbështetur çfarëdo është e nevojshme për të kryer hetimin me efektivitet të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI. Gjithashtu, pjesëmarrësit duhet ta dëgjojnë këtë mesazh drejtpërsëdrejti nga eprorët e tyre. Ekziston një ndryshim i madh për sa i takon rëndësisë së një çështjeje kur e dëgjon atë nga një trajnues krahasuar me atë kur e dëgjon nga eprori yt!

Pjesa e dytë kryesore e modulit përqendrohet tek kontributi i organizatave të shoqërisë civile për të sjellë këndvështrimin e një viktime dhe për të parashtruar ndikimin e thellë që mund të kenë krimet e urrejtjes tek individët dhe komunitetet e tyre. Së fundi, ky është një rast për pjesëmarrësit që të mësojnë lidhur me kontekstin më të gjerë të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, duke marrë dije se krime të tilla janë vetëm një pjesë e diskriminimit dhe paragjykitimit që përjetojnë personat LGBTI në mbarë vendet e Këshillit të Evropës.

REZULTATET E PËRFTUARA NGA TË MËSUARIT

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të kuptojnë pse krimet e urrejtjes dhe dhuna kundër personave LGBTI kërkojnë një qasje të posaçme dhe specifike;
- ▶ do të pranojnë se përmirësimet në këtë fushë duhen mbështetur nga ana e strukturave drejtuese të policisë;
- ▶ do të kuptojnë përhapjen dhe ndikimin e krimeve të urrejtjes dhe formave të ndryshme të dhunës, përfshirë dhunën në familje, ndaj komunitetit LGBTI;
- ▶ do të perceptojnë detyrën kryesore të policisë për mbrojtje, hetimin e krimeve dhe ofrimin e një shërbimi të respektueshëm dhe të barabartë.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE:

Aktiviteti 1.1: Kontribut i një drejtuesi të lartë për të përgatitur tablonë e trajnimit

Aktiviteti 1.2: Histori, ku bëhet përshkrimi i një krimi të urrejtjes kundër personave LGBTI

Aktiviteti 1.3: Pasqyrë e statistikave për dhunën dhe diskriminimin kundër personave LGBTI

AKTIVITETI 1.1: KONTRIBUTI I NJË DREJTUESI TË LARTË TË POLICISË PËR TË PËRGATITUR TABLONË E TRAJNIMIT

Përpara seancës, përpiquni që të takoheni me përfaqësuesin/përfaqësuesen e policisë apo të diskutoni me të në telefon ose me anë të postës elektronike për një përmbledhje të çështjeve kryesore të prezantimit të tij/saj. Natyrisht, ai/ajo do të ketë pikëshikimin e vet për çështjen për të cilën duhet të flasë. Sidoqoftë, ju mund të bëni këto sugjerime:

- ▶ Theksoni se policia duhet të ofrojë shërbim të barabartë për gjithë komunitetet, duke i trajtuar të gjitha viktimat me respekt dhe dinjitet, pavarësisht nga sfondi apo origjina e tyre. Vini në dukje se ky është një parim thelbësor i shërbimit policor që ju synoni ta mbronni apo arrini.
- ▶ Pranoni ndikimin veçanërisht të dëmshëm të krimeve të urrejtjes ndaj personave LGBTI dhe nevojën për hetimin me efektivitet të gjetjes apo identifikimit të motivit ose motiveve të njëanshme ose paragjyquese, punoni me shërbimin e prokurorisë për ndjekjen penale efektive të këtyre krimeve dhe zbatoni ligjet përkatëse mbi krimet që ndodhin për shkak të urrejtjes.
- ▶ Bisedoni për rezultatet përfundimtare që duhet të nxjerrin pjesëmarrësit nga trajnimi, d.m.th., aftësitë dhe kompetencat për të hetuar me efektivitet krimet e urrejtjes, aftësitë dhe njohuritë për të punuar me komunitetet në fjalë (në bashkëpunim, nëse është nevojë) dhe, së fundi, aftësinë për të përmirësuar dokumentimin e krimeve dhe besimin e viktimave për të punuar me policinë për çështje të tilla të vështira dhe të një natyre konfidenciale.
- ▶ Pranoni se, në rast pretendimesh për incidente të policisë me komunitetin LGBTI, ato do të hetohen plotësisht dhe do të trajtohen në përputhje me procedurat e caktuara nga ligji.
- ▶ Shpjegoni si do t'i monitorojnë strukturat drejtuese të policisë rezultatet përfundimtare të trajnimit dhe jepni siguri se trajnimi do të zbatohet në të gjithë shërbimin policor (për të gjithë forcën policore).

AKTIVITETI 1.2: KRIMET E URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI: KËNDVËSHTRIMI I VIKTIMËS

Mbani parasysh që, nëse nuk është e mundur që në këtë seancë të ftohet një organizatë e shoqërisë civile (OSHC), duhet ta bëni të qartë që në fillim se ajo ka luajtur një rol të konsiderueshëm në përgatitjen e Manualit apo të trajnimit. Mesazhi i rëndësishëm është: "Ne kemi punuar me shoqërinë civile për krijimin e këtij moduli; ju duhet të punoni me shoqërinë civile për zbatimin e tij."

Përpara seancës, gjeni pak kohë për identifikimin e organizatave të shoqërisë civile që monitorojnë krimet e urrejtjes dhe/ose ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për viktimat në nivel lokal apo kombëtar. Është me rëndësi që të vendoseni në kontakt me OSHC-të që punojnë me gjithë grupet e komunitetit LGBTI. Personi juaj i kontaktit në polici duhet të ketë një ide se cilat janë OSHC-të aktive në zonë, në qytet apo në vendin tuaj. Gjithashtu, mund të shkoni tek hatecrime.osce.org dhe të shfletoni seksionin për OSHC-të në faqet e shtetit përkatës, me qëllim identifikimin e OSHC-ve aktive në rajon.⁵ Për një kontakt të përshtatshëm nëse keni dëshirë, gjithashtu, ju mund të pyesni ndonjë koleg nga "ILGA-Europe"⁶, TGEU⁷ apo Njësia SOGI e Këshillit të Evropës. Përpiquni që të takoni përfaqësuesin/përfaqësuesen e OSHC-së ose të diskutoni me të në telefon apo me anë të postës elektronike për një përmbledhje të çështjeve kryesore të prezantimit të tij/saj. Bëjini atij/asaj një përmbledhje të përgjithshme të trajnimit dhe tërhiqini vëmendjen tek fakti se bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe OSHC-ëve do të trajtohet në mënyrë të hollësishme tek Moduli i Pestë.

Inkurajoni përfaqësuesin/përfaqësuesen që të sjellë me vete informacion për organizatën e tij/saj dhe të

5. Për shembull, OSHC-të aktive në monitorimin e krimit për shkak të urrejtjes në Spanjë mund t'i shihni duke bërë kërkime në Seksionin "Informacione për shoqëritë civile" në adresën: <http://hatecrime.osce.org/spain?year=2015>

6. <http://www.ilga-europe.org/who-we-are/contact-us>

7. <http://tgeu.org/about>; bëni kërkime në këtë faqe për një listë të organizatave anëtare sipas vendeve, përfshirë të dhënat për kontaktim.

sugjerojë si mundet policia dhe organizata të bashkëpunojnë për këtë çështje. Pa dyshim përfaqësuesi/përfaqësuesja do të ketë idetë e tij/saj për atë që do të flasë. Gjithashtu, ju mund të bëni këto sugjerime.

- ▶ Parashtroni pjesëmarrësve këndvështrimin e viktimës përmes një historie specifike të një krimi urrejtjeje ndaj një personi LGBTI, ose bëni një përmbledhje të ndikimit të krimeve të urrejtjes, siç evidentohet në punën tuaj.
- ▶ Shpjegoni nevojat e viktimave të krimeve të urrejtjes dhe pse është vështirë që ato të bëjnë kallëzim në polici për incidentet.
- ▶ Përshtesni zhvillimin e trajnimit dhe kontributin e OSHC-së dhe vini në dukje angazhimin e OSHC-së përgjatë të gjithë trajnimit dhe sidomos tek Moduli i Pestë.
- ▶ Bëni disa sugjerime specifike dhe realiste (edhe sikur ato të jenë thjesht hapa të vegjël!) si mund t'i përmirësojë policia marrëdhëniet me OSHC-të dhe komunitetet e interesuara.

AKTIVITETI 1.3: KONTEKSTI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI

Ekzistojnë një sërë mënyrash sesi mund t'i paraqisni statistikat lidhur me krimet e urrejtjes, si dhe dhunën dhe diskriminimin kundër personave LGBTI. Ju mund të përdorni të dhënat e këtij seksioni për të krijuar një prezantim në *PowerPoint* ose mund të përdorni prezantimet 1.3 dhe 1.4 si bazë për diskutime në grup.

Kjo seancë duhet të zgjasë rreth 10 minuta. Ajo mund të ndërthuret me aktivitetin 1.2.

1. **Përpara seancës**, shpenzoni pak kohë për të lexuar prezantimet 1.3 dhe 1.4, të cilat përmbajnë statistika dhe informacione marrë nga raporte kryesore ndërkombëtare. A mund të shtoni informacione të tjera që kanë të bëjnë me kontekstin lokal ose kombëtar, bazuar në informacionet që keni në dispozicion apo që mund të gjeni *online*? Përdorni listën e botimeve, që jepet në fund të këtij moduli, për burime të mëtejshme informacioni dhe raste specifike studimore. A ekzistojnë statistika lidhur me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI në nivel vendi? Cili është burimi i tyre? A vijnë ato nga burime zyrtare si p.sh. raportet e policisë? Nga OSHC-të lokale dhe kombëtare? A ka Raporte ndërkombëtare? Është me rëndësi që të sqarohen burimet e informacionit që keni gjetur, që të jeni të përgatitur për çfarëdo sfide për sa i takon vërtetësisë së informacionit të përdorur. P.sh., është mirë që të përdoren të dhënat e OSHC-ve, por ne e dimë se policia mund të mos i pranojë këto të dhëna si tablo zyrtare të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI. Nëse kjo gjë del gjatë trajnimit, duhet ta shmangni kundërshtimin drejtpërsëdrejti të policisë në këtë moment, por të shpjegoni se:

- ▶ të dhënat lidhur me krimet e urrejtjes mund të sigurohen nga disa burime;
- ▶ edhe pse mund të mos jenë të njohura për policinë, të dhëna të tilla nga OSHC-të përbëjnë një material të mirë informues që të fillohet të kuptohen përvojat e personave LGBTI;
- ▶ trajnimi duhet të përdoret për të identifikuar burime të tjera informacioni lidhur me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, si dhe për të identifikuar mënyra për përmirësimin e burimeve zyrtare të informacionit lidhur me këtë temë.

Kur të kërkonte informacione dhe statistika lidhur me kontekstin kombëtar, referojuni burimeve të listës që jepet në prezantimin 1.5.

2. Hapeni seancën duke shpjeguar se, kur bëhet fjalë për statistika lidhur me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, duhen mbajtur mend dy çështje të rëndësishme: së pari, personat LGBTI janë më të rrezikuar që të jenë objekt i dhunës dhe diskriminimit sesa popullsia e përgjithshme dhe, së dyti, ka më pak gjasa që ata të bëjnë kallëzim në polici se kanë qenë apo janë viktimë e krimeve të urrejtjes. Më pas, theksoni se puna e punonjësit të policisë është e vështirë: punonjësit e policisë duhet t'i bindin personat LGBTI që duhet të bëjnë kallëzim për krimet që ndodhin kundër tyre, dhe duhet t'i inkurajojnë ata që të japin sa më shumë informacion që të jetë e mundur për ngjarjen, në një vend ku ata ndihen të sigurt. Më tej, oficerët e policisë duhet të garantojnë se masat e duhura janë duke u marrë për të hetuar krimin.

3. Thojini grupit se, për sa u takon shifrave dhe statistikave që do të jepni, duhet mbajtur parasysh se çdo rast lidhet me persona të veçantë, si në rastin referuar në seancën e mëparshme. Është me rëndësi që të krijohet një ide lidhur me shifrat që tregojnë krimet e urrejtjes, por duke mbajtur mirë parasysh edhe impaktin që ato sjellin.

4. Tani kaloni tek çështjet kryesore lidhur me përhapjen dhe ndikimin e krimeve të urrejtjes dhe më gjerë të diskriminimit, duke përdorur si bazë për diskutim prezantimet 1.3 dhe 1.4. Nga ana tjetër, prezantimet mund t'i përdorni për të përgatitur një prezantim në *PowerPoint*.

5. Së fundi, shpërndajeni prezantimin 1.5. Shpjegoni se pjesëmarrësit mund ta përdorin atë kur të përgatiten për seancat e trajnimit të kolegëve që do t'i drejtojnë vetë.

PREZANTIMI 1.3: KONTEKSTI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI


Në rajonin e Këshillit të Evropës informacionet dhe statistikat lidhur me krimet e urrejtjes janë shumë të kufizuara, por ekzistojnë prova të konsiderueshme që tregojnë se përqindja e personave LGBTI, të cilët kanë qenë viktimat të krimeve të urrejtjes, është e lartë. Pjesët e zgjedhura në vijim, që janë marrë nga disa raporte kryesore ndërkombëtare, japin informacion specifik lidhur me krimet e urrejtjes dhe diskriminimin që kanë përjetuar personat LGBTI, informacion ky që mund të përdoret për të krijuar një ide për sa i takon përhapjes dhe ndikimit të këtyre incidenteve në kontekstin tuaj. Është me rëndësi që të vihet në dukje se, në vende të ndryshme, ekzistojnë pabarazi të konsiderueshme dhe kjo është diçka që duhet shqyrtuar me kujdes në kontekstin tuaj.

Shumë organizata të shoqërisë civile (OSHC-ë) mbledhin të dhëna lidhur me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI në mbarë rajonin e Këshillit të Evropës, ndërsa, në të njëjtën kohë, numri i raporteve zyrtare është relativisht i vogël. Figura më poshtë tregon se, gjatë ushtrimit për Raportimin Vjetor të Krimeve për Shkak të Urrejtjes për vitin 2015, në 24 shtete OSHC-të kanë raportuar incidente për shkak të urrejtjes pranë Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), ndërsa vetëm 12 shtete kanë raportuar të dhëna pranë ODIHR-it.



Nëse keni mundësi të përdorni internetin, gjeni një moment për të kërkuar disa raporte për akte dhune individuale të kryera kundër personave LGBTI dhe komuniteteve të tyre, duke hyrë në këtë faqe: <http://hatecrime.osce.org/what-hate-crime/bias-against-lgbt-persons>. Po aty do të gjeni edhe të dhëna zyrtare dhe të dhëna të OSHC-ëve të ndara në pasqyra për vende të veçanta për krimet e urrejtjes.


Figurat e tjera më poshtë përmbajnë pjesët e zgjedhura në vijim, të cilat janë nxjerrë nga raporti i Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore të Njeriut (FRA) nga anketimi më i madh që është bërë ndonjëherë për personat LGBT dhe përvojat e tyre për sa u takon diskriminimit, dhunës, krimeve të urrejtjes dhe çështjeve të tjera, me titull: *“Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjjinorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore”*. Ndërsa nuk përfshin vendet jashtë BE-së, raporti jep një tablo të hollësishme të përvojave individuale dhe krahasimet me vende jashtë BE-së mund të nënkuptohen. Më poshtë, ne po sjellim në vëmendje disa çështje kryesore për çdo grafik. Merrni në konsideratë dhe mendoni se çfarë konkluzionesh të tjera mund të nxirren nga të dhënat.



FRA, faqe 57, *Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjjinorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore*

Nga kjo tabelë mund të shihet se mundësitë janë më të mëdha që viktima të dhunës të jenë personat transgjjinorë.


Figura 33: Përhapja e dhunës për shkak të urrejtjes gjatë 12 muajve të mëparshëm, sipas llojit të dhunës dhe grupit LGBT (%)



FRA, faqe 57, Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjjinorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore

Mbani parasysh se personat transgjjinorë kanë më shumë gjasë se grupet e tjera që të jenë viktime të një akti të dhunshëm.

Figura 40: Incidente të sulmit me motive urrejtjeje të natyrës seksuale si përqindje e incidenteve të përgjithshme të dhunës me motive urrejtjeje, sipas grupit LGBT (%).



Pyetje: FA1_5. A mendoni se incidenti i FUNDIT i sulmit fizik/seksual apo kërcënimit me dhunë gjatë 12 muajve të fundit ndodhi pjesërisht apo plotësisht sepse ju u perceptuat të ishit [kategoria në bazë të A3 apo A4]? Po.

FA1_4. Duke menduar për sulmin E FUNDIT fizik/seksual apo kërcënimin E FUNDIT me dhunë, çfarë ju ndodhi? 2. Sulm seksual; 3. Sulm fizik dhe seksual. Variabël i përlllogaritur.

Shënim: Ndër kategoritë e vetëidentifikimit tek A3 dhe A4 janë të përfshirë grua transgjjinore, transeksuale me një të kaluar transeksuale, burrë me një të kaluar transeksuale, varianti gjinor, mbajtës veshjesh tipike për seksin e kundërt, homoseksual, lezbike, burrë homoseksual, biseksual ose tjetër.

Baza: Të anketuarit pjesëmarrës në anketimin e personave LGBT në vendet e BE-së, të cilët janë sulmuar fizikisht/seksualisht apo janë kërcënuar me përdorim të dhunës gjatë 12 muajve të mëparshëm pjesërisht ose tërësisht sepse janë perceptuar si LGBT.

Burimi: ADTH, anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së, 2012

FRA, faqe 62, Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjjinorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore

	E fundit	Më e rënda
A ishte vetëm autori i veprës kriminale?		
Vetëm	36	36
Më shumë autorë të veprës kriminale	64	64
Cila ishte gjinia e autorit(autorëve) të veprës kriminale?		
Mashkull	84	86
Femër	4	4
Edhe mashkull edhe femër	12	10
Nuk e di	0	0
A mendoni se autori(autorët) i (e) veprës kriminale ishte/ishin...?		
Gej	3	3
Lezbike	0	1
Biseksualë	1	2
Heteroseksualë/i rregullt	72	69
Me orientim të përzier seksual	4	4
Nuk e di	20	21
Kush ishte/ishin autori(autorët) i (e) veprës kriminale?		
Njeri i familjes/i shtëpisë	7	7
Fqinj	6	5
Koleg i punës	5	4
Ndokush nga shkolla, kolegji apo universiteti	12	14
Klient, konsumator apo pacient	4	3
Ndokush tjetër që e njihni	12	11
Anëtar i ndonjë grupi ekstremist/racist	15	14
Adoleshent a grup adoleshentësh	36	33
Oficer policie	4	3
Oficer sigurie/rojë	4	3
Zyrtar tjetër publik (p.sh.: roje kufiri, punonjës civil)	3	2
Ndokush tjetër që nuk e njihni	45	42
Person(persona) tjetër(të tjerë)	3	3

Kini parasysh se dhuna seksuale është një kategori me goxha peshë ndër format e dhunës së përjetuara nga personat LGBT. Gjithashtu duhet të keni parasysh se gratë biseksuale janë veçanërisht të rrezikuara.

FRA, faqe 64, Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjitorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore


Mbani parasysh se, në përqindjen më të madhe të akteve të dhunës, autori i veprës penale ka qenë adoleshent apo një grup adoleshentësh (përveç akteve të dhunës kur autori i veprës penale ka qenë i panjohur).

	E fundit	Më e rënda
Në shtëpinë time	8	8
Në një godinë, apartament tjetër banimi	2	2
Në shkollë, universitet	5	7
Në vendin e punës	4	3
Në një kafene, restorant, pub, lokal	11	9
Në makinë	1	1
Në transportin publik	8	7
Në një klub sportiv	1	0
Diku tjetër në mjedise të brendshme	3	2
Në rrugë, shesh, parkim makinash apo vend tjetër publik	44	43
Në një park, pyll	4	6
Në një pikë takimi (p.sh.: lokal, bar) apo veprimtari vetëm për personat LGBT (p.sh.: Parada e Krenarisë*)	3	4
Diku tjetër jashtë në natyrë	5	6
Tjetër	2	2

FRA, faqe 65, Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjjinorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore

Mbani parasysh se vendi më i zakonshëm, ku kanë ndodhur aktet e dhunës, ka qenë në rrugë, shesh, parkim makinash apo vend publik.

Figura 42: Incidenti më i rëndë i dhunës me bazë urrejtjen, për të cilin është bërë kallëzim në polici, sipas personave LGBT (%)



Pyetje: FA2_5. A mendoni se ky akt i dhunës fizike/sexuale apo kërcënim me dhunë ndodhi pjesërisht apo plotësisht sepse ju u perceptuat të ishit [kategoria në bazë të A3 apo A4]? Po.

FA2_11. A bëtë ju apo dikush tjetër kallëzim në polici për të?

Shënim: Ndër kategoritë e vetëidentifikimit tek A3 dhe A4 janë të përfshirë grua transgjjinore, transeksuale me një të kaluar transeksuale, burrë me një të kaluar transeksuale, varianti gjinor, mbajtës veshjesh tipike për seksin e kundërt, homoseksual, lezbike, burrë homoseksual, biseksual ose tjetër.

Baza: Të anketuarit pjesëmarrës në anketimin e personave LGBT në vendet e BE-së, të cilët janë sulmuar fizikisht/sexualisht apo janë kërcënuar me përdorim të dhunës gjatë pesë viteve të mëparshëm pjesërisht ose tërësisht sepse janë perceptuar si LGBT.

Burimi: FRA, anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së, 2012

* Paradat e Krenarisë (të njohura, gjithashtu, si marshime të krenarisë, veprimtari të krenarisë dhe festivale të krenarisë) për komunitetin LGBT janë aktivitete për të festuar dhe manifestuar kulturën dhe krenarinë e të qenit lezbike, gej, biseksualë dhe transgjjinorë (LGBT).

FRA, faqe 66, Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjitorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore

Mbani parasysh se në polici është bërë kallëzim vetëm për një përqindje të vogël të këtyre incidenteve.

Krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI ndodhin në kontekstin e dhunës në familje, diskriminimit dhe paragjykitimit.

Për shembull, një përqindje e konsiderueshme e personave LGBTI përjetojnë diskriminim në vendin e punës dhe në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve. Nga anketimi i FRA-së u konstatua se 19% e personave LGBT ndiheshin të diskriminuar në punë. Diskriminimin në shkallën më të lartë e kishin përjetuar personat transgjitorë (30%). Gjithashtu, nga anketimi u konstatua se 32% e personave LGBT ndiheshin të diskriminuar kur shkonin në restorant apo kafene, kur kërkonin strehim, në kujdesin shëndetësor, kur kërkonin shërbime bankare apo sigurimi, si dhe në klube sportive e palestra.

Prova të niveleve të ndryshme të dhunës gjinore në përvojën e personave LGBTI për sa u takon krimeve të urrejtjes dhe formave të tjera të diskriminimit.

Vetëkuptohet se personat LGBTI kanë edhe identitete të tjera, si: gjinia, mosha, etnia dhe besimi fetar, që mund të ndërliqhen dhe të krijojnë përvoja dhe nevoja specifike. Këto duhen kuptuar më mirë dhe duhen marrë parasysh sa nga policia ashtu edhe nga shërbimet e tjera.

Gjinia: nga anketimi i FRA-së u konstatua se 55% e grave lezbike personalisht ndjenin diskriminim apo ngacmime për shkak të orientimit të tyre seksual, krahasuar me 45% të burrave gej. Siç vërehet në tabelat më sipër, ka më shumë gjasë që viktima të krimeve të dhunshme të urrejtjes dhe diskriminimit të bëhen personat transgjitorë.

Mosha: nga anketimi i FRA-së u konstatua se personat LGBT në moshë më të re kanë më shumë gjasë që të përjetojnë diskriminim apo ngacmime për shkak të orientimit të tyre seksual sesa personat LGBT në moshë më të madhe: 57% e të anketuarve të grupmoshës 18–24 ndiheshin të diskriminuar krahasuar me 45% të të anketuarve të grupmoshës 25–39.

Etnia: Nga raporti i Policisë Metropolitane të Londrës “Përvoja e grave lidhur me homofobinë dhe transfobinë” u konstatua se, pas një akti dhune për shkak të urrejtjes ndaj personave gej apo transgjitorë, gratë me origjinë afro-karaibiane kishin më shumë gjasë që të ndryshonin sjelljen apo pamjen e tyre se sa gratë e tjera (MPS, 2008).

Studime të tjera:

- ▶ “Sjellja e Provave: Dhuna kundër personave trans, përvojat nga Projekti ProTrans ‘Mbrojtja e personave transgjitorë nga dhuna’”⁸
- ▶ Ky raport sjell konkluzione nga një projekt që ka mbështetur organizatat, të cilat kanë monitoruar diskriminimin dhe krimet e urrejtjes ndaj personave transgjitorë në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës. Nga projekti u konstatua se personat transgjitorë janë në rrezik shumë të madh të akteve të dhunshme dhe diskriminimit në shkallë të gjerë. Raporti është një burim i mirë i rasteve të shkurtra studimore nga një larmi vendesh.
- ▶ “Sjellja e Provave: dokumentimi i dhunës ndaj personave transgjitorë, përvoja nga Armenia, Gjeorgjia, Gjermania, Moldavia, Rusia dhe Ukraina”
- ▶ Ky raport e shtrin punën monitoruese, që përmendet më sipër, në një numër më të madh vendesh (që renditen tek titulli). Gjithashtu, ai dokumenton dhunën nga ana e strukturave, përfshirë diskriminimin, dhunën shumë të rëndë gjatë ndërveprimit shoqëror dhe dhunën e ushtruar nga policia.
- ▶ “Ritja e raportimit lidhur me dhunën për shkak të urrejtjes ndaj personave gej apo transgjitorë” është një raport i Shoqatës Ndërkombëtare Europiane e Lezbikeve, Gejve, Biseksualëve, Transgjitorëve dhe personave Intersex (“ILGA-Europe”).
- ▶ Ky raport sjell konkluzione të një projekti që ka mbështetur organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë monitoruar krime dhe incidente për shkak të urrejtjes në 12 vende, përfshirë vende jo anëtare të BE-së, si: Bosnjë-Hercegovina, Moldavia, Turqia dhe Ukraina. Raporti pasqyron konkluzionet e rëndësishme të raportit të FRA-së, përfshirë faktin se një numër i madh i krimeve për shkak të urrejtjes kryhet në hapësira publike; se personat trans rrezikojnë në mënyrë më të ndjeshme dhunë të rëndë fizike; dhe se në polici bëhen ndjeshëm më pak kallëzime për krimet e urrejtjes.

8. http://tgeu.org/wp-content/uploads/11/2013/TGEU_protrans_publication_1_Nov.pdf

PREZANTIMI 1.4: PËRVOJA PERSONALE

Ky prezantim përmban disa histori personale në bazë të statistikave.

Përkthimi i figurës:

“Edhe pasi ka kaluar më shumë se një vit ende kam frikë... Pas përjetimit të dhunës nuk mund të kaloj më në rrugë pa e kthyer vazhdimisht kokën pas për të parë se mos më vjen njeri nga pas për të më goditur... Jam ende e traumatizuar, nganjëherë kam maktë”.

Michelle, ndaj të cilës është ushtruar dhunë në Katania, Itali

Marrë nga: “Për shkak të asaj që jam: homofobia, transfobia dhe krimet e urrejtjes në Europë”, faqe 7.

Bosnjë-Hercegovinë: incident i dhunës fizike

Për tre vjet rresht një djalë është dhunuar në mënyrë të vazhdueshme nga një grup të rinjsh të lagjes së tij. Ata e qëllonin shtëpinë e tij me gurë dhe objekte, duke e ofenduar, kërcënuar dhe kanosur për shkak se ai ishte homoseksual. Ndërsa për shumë nga këto incidente ishte bërë kallëzim në polici, nga frika viktimat nuk pranonte t'i identifikonte agresorët e tij nga fotografitë në dosjet e policisë. Ngjarjet u përshkallëzuan derisa, një ditë, të njëjtët autorë të krimit e rrethuan viktimën rrugës për në qytet dhe, në mes të ditës, e ngacmuan dhe ushtruan dhunë fizike ndaj tij, duke i shkaktuar një dëmtim të rëndë të kockave të legenit, që kërkonte ndërhyrje urgjente kirurgjikale. U kontaktuan menjëherë oficerët e policisë që hetonin çështjen dhe, pas një interviste tjetër me viktimën dhe një hetimi të plotë, ata i identifikuan dhe i arrestuan autorët e krimit. Fatkeqësisht, meqenëse ligjet vendase mbi krimet e urrejtjes nuk e përfshijnë orientimin seksual, ky rast nuk do të klasifikohet dhe as do të trajtohet si krim për shkak të urrejtjes.

Nga “ILGA-Europe”, “Rritja e raportimit lidhur me dhunën për shkak të urrejtjes ndaj personave gej apo transgjinorë” (del së shpejti).

Ukrainë: grupe të organizuara që gjurmojnë pjesëtarë të komunitetit LGBTI për t'i sulmuar.

Një aktivist i LGBTI në Lviv, i cili monitoronte grupet e ekstremistëve të djathtë, mësoi se militantët e një grupi të tillë kishin marrë vesh për një festë të personave gej, që ishte planifikuar për disa ditë më pas. Gjatë dy ditëve në vijim, një burim përmes internetit dokumentoi përgatitjet e pjesëtarëve të grupit, si dhe planet e tifozëve të klubit lokal të futbollit për ta sulmuar këtë aktivitet të personave LGBT, që përfshinte udhëzime të hollësishme se kush duhej goditur, si dhe çfarë mjetesh do të përdorehin. Për shembull, organizatorët angazhuan shoqet e militantëve, në kuadër të një “fushate kanosjeje” për të rrahur lezbiket, pasi meshkujt nuk donin që t'i rrihnin vajzat lezbike. Ditën e festës, aktivistët e LGBTI mbërritën tek vendi i takimit të grupit ekstremist të djathtë, për të cilin ishte rënë dakord, dhe panë disa grupe të rinjsh veshur me të zeza, djem e vajza, numri i të cilëve shkonte diku tek 60. Shumë prej tyre mbanin çanta shpine, nga të cilat dukeshin shkopinj të bejsbollit. Ata shkuan grupe-grupe drejt vendit ku organizohej festa e LGBT. Aktivistët i ndoqën dhe u telefonuan më përpara organizatorëve të festës, duke u treguar lëvizjet e militantëve. Faktikisht, militantët i njohën aktivistët e LGBTI dhe u përpoqën t'i sulmonin, por aktivistët arritën të fshiheshin në një restorant “McDonald's”, ndërsa militantët vazhduan rrugën për tek vendi ku bëhej festa. Organizatorët e festës LGBT kishin punësuar paraprakisht një roje private dhe i kërkuan policisë mbrojtje. Policia po priste tek vendi ku bëhej festa, por nuk bëri arrestime.

Nga “ILGA-Europe”, “Rritja e raportimit të dhunës për shkak të urrejtjes ndaj personave gej apo transgjinorë”

Moldavia: shënjestrimi në mënyrë aktive i meshkujve gej, duke organizuar takime përmes internetit

Një tendencë shqetësuese, që e pati zanafillën në Rusi, lidhet me agresorët që organizojnë takime ballë për ballë me viktimat përmes faqeve të internetit të posaçme për organizime takimesh të personave gej. Në një rast të tillë, një burim gej në Moldavi la takim me një burrë tjetër në një kafene në mbrëmje herët. Kur vendosën që të bënin një shëtitje në një park të veçuar, viktimat u grabit dhe u sulmua me ligësi, që solli si rezultat thyerjen e nofullës. Viktimat tha se, sikur të mos ia kishte mbathur atëherë kur duhej, situata mund të kishte vajtur shumë më keq dhe se motivet e autorit të krimit ishin lehtësisht të perceptueshme, meqenëse gjatë aktit të dhunës ky i fundit kishte përdorur fjalë fyese homofobike. Për incidente të ngjashme ka patur njoftime edhe në Bosnjë-Hercegovinë, ku viktimat janë grabitur e rrahur gjatë takimeve që janë organizuar përmes grupit të faqeve të internetit të posaçme për organizim të takimeve.

Nga “ILGA-Europe”, “Rritja e raportimit të dhunës për shkak të urrejtjes ndaj personave gej apo transgjinorë”

Turqi: ndikimi psikologjik

Nga raporti u konstatua se menjëherë pas incidenteve shumica e viktimave pësojnë dëmtime të rënda psikologjike, që kanë ndikim të përhershëm dhe prekin shumë aspekte të jetës së tyre. Shumë pak prej tyre kanë kërkuar mbështetje profesionale për të kapërcyer pasojat serioze të çrregullimit nga stresi post-traumatik, depresioni, ankthi, zemërimi apo paranoja. Më shumë se gjysma e viktimave, që iu nënshtruan trajtimit psikologjik, thanë se nuk ishin trajtuar siç duhet.

Nga "ILGA-Europe", "Rritja e raportimit të dhunës për shkak të urrejtjes ndaj personave gej apo transgjjinorë"

PREZANTIMI 1.5: REFERIME, LITERATURË SHITESË DHE KËSHILLA PËR TË BËRË KËRKIME TË MËTEJSHME

Burime të Këshillit të Evropës

Studime tematike për vendin lidhur me homofobinë, transfobinë dhe diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, Këshilli i Evropës (2011)

Ky grup i faqeve të internetit përmban referime ndaj raporteve gjithëpërfshirëse të kërkuara nga Këshilli i Evropës për situatën ligjore dhe sociale lidhur me homofobinë, transfobinë dhe diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor për çdo shtet anëtar të Këshillit të Evropës.⁹

Në studimet ligjore hulumtoni seksionin mbi krimet e urrejtjes me qëllim që të kuptoni udhëzimet dhe ligjet ekzistuese mbi krimet e urrejtjes në nivel kombëtar.

Shfletoni raportet sociale për të gjetur të dhëna mbi incidentet e krimeve të urrejtjes, përfshirë incidente ku është përfshirë edhe vetë policia.

Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në Evropë, Këshilli i Evropës (2011)

Ky raport sjell të dhënat e mbledhura në kuadër të studimit të mësipërm për të dhënë një tablo të plotë për sa i takon ligjit mbi krimin për shkak të urrejtjes dhe reagimeve në 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.¹⁰ Shih, në mënyrë të posaçme, Seksionin 3.2 "Dhuna kundër personave LGBT".

Studime tematike për vendin lidhur me homofobinë, transfobinë dhe diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor – përditësim i vitit 2010, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore të Njeriut (FRA) (2010)¹¹

Ky raport sjell të dhëna dhe informacione për incidentet, ligjet dhe reagimet ndaj krimeve të urrejtjes në Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian, që janë mbledhur për studimin e mësipërm tematik nga Këshilli i Evropës.

Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjnorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore të Njeriut (FRA) (2014)¹²

Ky botim bën të njohura konkluzionet e anketimit më të madh të personave LGBT në Evropë i cili evidentoi në mënyrë të saktë përvojat e tyre për sa i takon diskriminimit, dhunës dhe ngacmimit. Për efekt të Moduleve Një dhe Tre, ky Manual mbështetet tek konkluzionet e këtij raporti. Gjatë përgatitjeve për trajnimin, ju mund ta përdorni këtë raport për të krijuar raste studimore specifike për vendin dhe të bëni kërkime në kontekstin e vendit. Shih, në mënyrë të posaçme, Seksionin 2.5 "Dhuna dhe ngacmimi".

Raportet të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për vendet individuale¹³

Grafiku i rregullt i vizitave të ECRI-t në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, që kanë realizuar ekspertët nga gjithë rajoni, përfshin shqyrtimin e hollësishëm të çështjeve që prekin personat LGBT, në mënyrë të veçantë, të krimeve të urrejtjes. Në raporte përfshihen përmbledhje të hollësishme të të dhënave zyrtare dhe të shoqërisë civile për krimin për shkak të urrejtjes, një oponencë e politikave dhe ligjeve mbi krimet e urrejtjes dhe rekomandime specifike për përmirësim. Gjithashtu, në çdo raport përfshihet përgjigjja zyrtare ndaj situatës specifike të vëzhgimeve dhe rekomandimeve të ECRI-t. Këto raporte mund të përbëjnë lëndë leximi shumë të dobishme kur planifikohen trajnime, për të patur një ide për sa i takon situatës në vend, përfshirë çështje që prekin personat LGBT, dhe rëndësisë që i jep shteti ndjekjes së krimeve të urrejtjes ndaj personave LGBT.

Të drejtat e njeriut dhe personat Intersex. "Libri i bardhë", botuar nga Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut¹⁴

Ky raport përmban një analizë të rrallë të çështjeve që prekin personat Intersex (ndërseksualë) në mbarë rajonin e Këshillit të Evropës dhe më gjerë, dhe parashtron shembuj të zakonshëm të diskriminimit që ata përjetojnë.

9. <http://www.coe.int/en/web/commissioner/thematic-work/lgbt-country-studies>

10. http://www.europewatchdog.info/wp-content/uploads/11/2016/LGBTStudy2011_en.pdf

11. <http://fra.europa.eu/en/national-contribution/2012/country-thematic-studies-homophobia-transphobia-and-discrimination>

12. <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/eu-lgbt-survey-european-union-lesbian-gay-bisexual-and-transgender-survey-main>

13. http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/countrybycountry_en.asp

14. <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=2933521&SecMode=1&DocId=2367288&Usage=2>

Puna tematike dhe puna në vende të ndryshme dhe raportet e Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut

Në përpjekje për të kuptuar dhe reaguar ndaj çështjeve që prekin personat LGBTI, Komisioneri ka ndërmarrë një numër të madh aktivitetesh, në qendër të të cilave ka qenë një temë a një vend. Në punën tematike përfshihet një raport lidhur me diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe një raport i pazakontë lidhur me çështjet aktuale që prekin personat Intersex, botuar më 2015.¹⁵

Gjithashtu, Komisioneri bën vizita të rregullta në vende të ndryshme për të hulumtuar situatën lidhur me të drejtat e njeriut të grupeve të cenueshme në nivel vendi. Çështjet LGBTI nuk përfshihen në të gjitha vizitat që bëhen në vende të ndryshme, sidoqoftë, vlen të përdoret funksioni “Kërkim” i grupit të faqeve të internetit për vizitat në vende të ndryshme për të hulumtuar nëse është kryer ndonjë vizitë në vendin a vende të caktuara, ku planifikoni të zhvilloni një seancë trajnimi.¹⁶

Burime të tjera

Për shkak të asaj që jam: homofobia, transfobia dhe krimet e urrejtjes në Evropë, “Amnesty International” (2013)¹⁷

Ky raport plotëson anketimin e personave LGBT në vendet e BE-së, një përmbledhje e të cilit jepet më sipër në rastet studimore mbi krimin për shkak të urrejtjes ndaj personave LGBT në Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian. Përveç kësaj, bëhen vlerësime kritike për politikën dhe kuadrin ligjor dhe propozohen rekomandime për përmirësim në nivel kombëtar dhe evropian. Ky raport është i dobishëm si burim i rasteve studimore të vendeve të ndryshme, si dhe për të krijuar një ide për kontekstin ligjor dhe të politikave në disa vende evropiane.

Të dhëna nga raportimi vjetor i OSBE-së lidhur me krimet e urrejtjes

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ka monitoruar dhe raportuar për krime dhe incidente për shkak të urrejtjes në Rajonin e OSBE-së qysh nga viti 2008. Në faqen e internetit të kësaj organizate, ku raportohet për krimet e urrejtjes, jepen hollësi lidhur me të dhënat zyrtare dhe të shoqërisë civile, informacion lidhur me politikën dhe udhëzimet specifike për agjencitë e ndjekjes penale, hollësi lidhur me ligjet aktuale mbi krimin për shkak të urrejtjes dhe vendimet gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe bëhen përmbledhje të rekomandimeve specifike të organizatave ndërkombëtare, përfshirë Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës të Këshillit të Evropës dhe Zyrën e Komisionerit të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut.

Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë anëtare të OSBE-së. Për këtë arsye, këto faqe mund të jetë të dobishme nëse kërkoni një tablo të situatës në shtetin ku planifikoni të zhvilloni një seancë trajnimi. Këto faqe të internetit përdoren si burim për Modulën e Parë të këtij Manuali.

“ILGA-Europe” “Rritja e raportimit lidhur me dhunën për shkak të urrejtjes ndaj personave LGBT” (Referenca mund të gjendet në faqen e internetit të “ILGA-Europe” kur të publikohet).¹⁸

“Sjellja e provave: Dhuna kundër personave transgjinerë, përvojat nga Projekti ProTrans ‘Mbrojtja e personave transgjinerë nga dhuna’”¹⁹.

Ky raport sjell konkluzionet e një projekti që ka mbështetur organizata, të cilat kanë monitoruar diskriminimin dhe krimet e urrejtjes ndaj personave transgjinerë në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës. Në kuadër të projektit është konstatuar se rreziku i akteve të dhunshme dhe diskriminimit në shkallë të gjerë ndaj personave transgjinerë është shumë i madh. Raporti është një burim i mirë i rasteve të shkurtra studimore nga një sërë vendesh.

“Sjellja e provave: Dokumentimi i dhunës ndaj personave transgjinerë, përvoja nga Armenia, Gjeorgjia, Gjermania, Moldavia, Rusia dhe Ukraina”.

15. <http://www.coe.int/en/web/commissioner/thematic-work/lgbti>

16. www.coe.int/en/web/commissioner/country-report

17. Gjendet në adresën: <https://www.amnesty.org/en/documents/eur2013/014/01/en/>

18. Shoqata Ndërkombëtare Evropiane e Lezbikeve, Homoseksualëve, Biseksualëve, Transgjinerëve dhe Interseks (“ILGA-Europe”).

19. http://tgeu.org/wp-content/uploads/11/2013/TGEU_protrans_publication_1_Nov.pdf

Moduli i Dytë: Konceptet kryesore

HYRJE DHE HISTORIKU

Siç parashtrohet në Modulin e Parë dhe siç do të bëhet më e qartë ndërsa vazhdojmë punën sipas programit, personat LGBTI përzgjidhen në mënyrë shpërpjesëtimore nga autorët e krimit për të qenë viktimat e krimeve të tyre. Personat LGBTI shpesh ngurrojnë të bëjnë kallëzim në polici për krimet e urrejtjes dhe, kur bëjnë kallëzim, shpeshherë policia nuk i dokumenton këto krime siç duhet apo, nuk i dokumenton fare.

Për të reaguuar në mënyrë profesionale ndaj nevojave të personave LGBTI viktimat të krimeve të urrejtjes, policia duhet të jetë në gjendje që të identifikojë personat LGBTI, karakteristikat e sjelljes diskriminuese dhe çfarë përbën krim të urrejtjes.

Në pjesën (a) të këtij moduli, pjesëmarrësit do të marrin njohuri se cili është komuniteti LGBTI dhe do të njihen me konceptet e orientimit seksual (LGB), të identitetit gjinor (T) dhe të karakteristikave seksuale (I).

Pjesëmarrësit, më tej, do të marrin njohuri për konceptet lidhur me të menduarit dhe sjelljet negative ose diskriminuese kundër personave LGBTI. Homofobia, transfobia, stereotipet dhe diskriminimi kundër personave LGBTI përbëjnë bazën për pjesën më të madhe të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI.

Në pjesën (b) të këtij moduli, do të jepet përkufizimi i krimit të urrejtjes dhe krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI. Do të ravijëzohen disa nga karakteristikat kryesore të krimeve të urrejtjes. Këto koncepte do të formojnë bazën e Modullit 4, që do të marrë në analizë krimin për shkak të urrejtjes nga këndvështrimi i punës policore praktike.

Pjesët (a) dhe (b) të ndërthurura do t'u japin pjesëmarrësve bazën për të marrë njohuri lidhur me çështje specifike që shqyrtohen në këtë program trajnimi.

Moduli 2(a): Konceptet dhe përkufizimet kryesore – komuniteti LGBTI – homofobia, transfobia, stereotipet dhe diskriminimi

REZULTATET E PËRFTUARA NGA TË MËSUARIT

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të kuptojnë konceptet kryesore të orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes së gjinisë dhe pjesët përbërëse: L, G, B, T dhe I;
- ▶ do të kuptojnë konceptet e homofobisë, transfobisë, stereotipet dhe diskriminimit, dhe si lidhen ato me rolin e oficerit të policisë;
- ▶ do të jenë të aftë ta zbatojnë terminologjinë gjatë gjithë seancës së trajnimit dhe në punën e tyre.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE DHE AFATET KOHORE

- ▶ Aktiviteti 2.1: Të kuptuarit e terminologjisë kryesore lidhur me komunitetin LGBTI: prezantimi në seancë plenare nga moderatorët e kursit (30 minuta)
- ▶ Aktiviteti 2.2: Të kuptuarit e stereotipeve: puna në grupe pasuar nga prezantimi në seancë plenare dhe diskutimet (20 minuta)
- ▶ Aktiviteti 2.3: Të kuptuarit e stereotipeve: puna individuale pasuar nga diskutimet (25 minuta)

AKTIVITETI 2.1: TË KUPTUARIT E TERMINOLOGJISË BAZË LIDHUR ME PERSONAT DHE KOMUNITETIN LGBTI. PREZANTIM NË SEANCË PLENARE NGA MODERATORËT E KURSIT (30 MINUTA)

Konceptet dhe përkufizimet kryesore – prezantim

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme, stilolapsa

Prezantimet 2.1a dhe 2.1b

Në këtë modul moderatori do ta njohë grupin me këto koncepte kryesore në seancën plenare:

- ▶ Orientimi seksual (LGB), identiteti gjinor (T) dhe ndërseks (I)
- ▶ Homofobia, transfobia, stereotipet dhe diskriminimi

Pjesëtarët e grupit duhen udhëzuar që të marrin shënime lidhur me ato që kuptojnë nga prezantimi dhe lidhur me konceptet kryesore. Për ta mundësuar këtë, mund të përdoret fleta e punës tek prezantimi 2.1 për të ndihmuar grupin që të dokumentojë atë që mëson ndërkohë. Prezantimi 2.1b mund të përdoret për të lehtësuar më tej të kuptuarit e kësaj fushe.

Këto njohuri mund të testohen në një fazë të mëvonshme tek moduli gjatë aktivitetit 2.6, duke përdorur prezantimin 2.6.

Shënim për trajnuesit:

Faqet vijuese japin informacione që mund të përshtaten për seanca të trajnimit lokal. Përshtatjet duhen bazuar tek njohuritë ekzistuese të grupit të caktuar për të cilin synohen dhe tek niveli i hollësive që kërkohen, në përputhje si me faktorët kohorë, ashtu dhe me thellësinë e trajnimit që do të ofrohet. Rishikoni materialin dhe zgjidhni ato pjesë që janë më specifike për të mundësuar marrjen e njohurive nga oficerët e policisë në fjalë.

Jeni të lutur të mbani parasysh se ky ushtrim nuk është i përshtatshëm për diskutime lidhur me personat Intersex. Arsyeja është se figura nuk pasqyron shumëllojshmërinë e karakteristikave seksuale që përfshihen në përkufizimin e personave ndërseksualë. Gjatë diskutimit të këtyre çështjeve, jeni të lutur t'i referoheni gjuhës në aktivitetin 2.1 dhe prezantimin 2.1a.

Orientimi seksual: komponenti "LGB"

Orientimi seksual i referohet aftësisë së çdo personi për tërheqje të thellë emocionale, afektive dhe seksuale ndaj individëve të seksit të kundërt (heteroseksualë) apo të seksit të njëjtë (gej, lezbike) ose ndaj të dyja sekseve (biseksualë).²⁰

Me këtë program trajnimi lidhen këto përkufizime për sa i takon orientimit seksual:

- ▶ **Lezbike:** vajzë / grua që tërheqjen kryesore romantike, emocionale, fizike dhe seksuale e ka ndaj vajzave apo grave.
- ▶ **Gej:** djalë / burrë që tërheqjen kryesore romantike, emocionale, fizike dhe seksuale e ka ndaj djemve/ ndaj burrave. Ky term mund të përdoret edhe për lezbiket, biseksualët dhe, në disa raste, mund të përdoret si term ombrellë për gjithë personat LGBT.
- ▶ **Biseksual:** person, i cili ndien tërheqje të konsiderueshme romantike, emocionale, fizike dhe seksuale ndaj personave të të dy sekseve. Frekuenca, intensiteti apo cilësia e tërheqjes nuk drejtohen domosdoshmërisht në mënyrë të barabartë ndaj të dy sekseve.
- ▶ **Heteroseksual:** person, i cili, në aspektin emocional, romantik ose seksual, ndien tërheqje a përkushtim ndaj personave të seksit të kundërt.²¹

Çdo njeri ka një orientim seksual. Përqindja e saktë e popullsisë lezbike, homoseksuale apo biseksuale është e paqartë dhe në shumë vende nuk dihet. Përqindjet ndryshojnë nga njëri studim në tjetrin, dhe numri i njerëzve, të cilët tregojnë se kanë patur takime me persona të të njëjtit seks, është më i lartë se sa numri i personave që deklarohen si lezbike, gej apo biseksualë. Shifrat e deklaruara ndryshojnë nga vendi në vend në bazë të normave kulturore, besimeve fetare dhe nivelit të përgjithshëm të respektit dhe pranimin në shoqëri. "Stonewall", një organizatë britanike që mbështet të drejtat e homoseksualëve, vlerëson se homoseksualët, lezbiket apo biseksualët përbëjnë rreth 5-7% të popullsisë britanike.²² Instituti "Williams" vlerëson se 3.5% të popullsisë amerikane në moshë të rritur e përbënin homoseksualët, lezbiket apo biseksualët, dhe se 8.2% deklarojnë se ishin angazhuar në akte seksuale me persona të të njëjtit seks.²³ Ndërsa shifrat e sakta janë të paqarta, ne e dimë tashmë se një pjesë e popullsisë përbëhet nga lezbike, gej apo biseksual. Edhe sikur shifra të jetë 3%, kjo do të ishte e barabartë me mbi 220.000.000 njerëz²⁴ Kudo në botë. Në të gjithë kontinentet, personat lezbike, gej dhe biseksualë përfaqësojnë një grup të madh të pakicës.

Identiteti gjinor: komponenti "T"

Ndër personat **transgjinorë** përfshihen personat, të cilët kanë një identitet gjinor që ndryshon nga seksi biologjik me të cilin kanë lindur. Personat transgjinorë dëshirojnë ta përshkruajnë identitetin e tyre ndryshe nga seksi që përcaktohet që në lindje. Këtu përfshihen persona, të cilët ndjejnë se qoftë me anë të veshjeve, aksesoreve, manierizmave, mënyrave të të folurit, kozmetikës apo të modifikimit në trup, duhet, parapëlqejnë apo zgjedhin ta paraqesin veten ndryshe nga pritshmëritë e rolit gjinor që iu është përcaktuar që në lindje. Këtu përfshihen, ndër shumë të tjerë, persona, të cilët nuk identifikohen me klasifikimet "mashkull" ose "femër", transeksual, transvestit dhe persona që mbajnë veshje tipike për seksin e kundërt.

20. <http://www.coe.int/en/web/sogidatabase/glossary>

21. <http://rainbowcenter.uconn.edu/terms/>

22. https://www.staffs.ac.uk/assets/Stonewall20%-20%Employment20%regulations20%-20%guidelines20%for20%employers_tcm21515-44.pdf

23. <http://williamsinstitute.law.ucla.edu/research/census-lgbt-demographics-studies/how-many-people-are-lesbian-gay-bisexual-and-transgender/>

24. <https://www.census.gov/popclock/>

Një burrë transgjinnor është një person që është përcaktuar që i përket seksit “femër” në lindje, por që ka një identitet gjinnor që është “mashkull” ose që bën pjesë në spektrin e identitetit gjinnor mashkullor. Një grua transgjinnore është një person që është përcaktuar “mashkull” në lindje, por që ka një identitet gjinnor që është “femër” ose që bën pjesë në spektrin e identitetit gjinnor femëror.

Disa persona transgjinnorë nuk duan të identifikohen as si mashkull apo femër, ose duan të identifikohen si mashkull dhe femër njëkohësisht, pra, si persona që nuk përkojnë me ndarjen mashkull-femër ose burrë-grua (ndarje jo sipas binarëve femër-mashkull).

Klasifikime të ngjashme për orientimin seksual të personave transgjinnorë përdoren më shumë sipas identitetit të tyre gjinnor se sa seksit që përcaktohet në lindje. Një burrë transgjinnor heteroseksual, për shembull, është një burrë transgjinnor, të cilin e tërheqin partneret femra. Një grua transgjinnore lezbike e tërheqin partneret femra. Fjala transgjinni i referohet faktit të të paturit të një identiteti ose shprehive transgjinnore.

Identiteti gjinnor i referohet përvojës individuale të personit, përvojë kjo thellësisht e ndërë për sa i takon gjinisë, që mund të përkojë ose jo me seksin që përcaktohet në lindje, dhe përfshin ndjesinë personale të trupit dhe shprehje të tjera të gjinisë (pra, “shprehja e gjinisë”), si: veshja, të folurit dhe manierizmat.

Zakonisht, **seksi** i një personi përcaktohet në lindje dhe, duke vazhduar më pas, bëhet fakt ligjor dhe social. Sidoqoftë, disa persona kanë vështirësi që të identifikohen me seksin e përcaktuar në lindje – këta persona quhen persona “**transgjinnorë**” ose “**trans**”. Identiteti gjinnor nuk është njëlloj si orientimi seksual dhe personat transgjinnorë mund të identifikohen si heteroseksualë, biseksualë apo gej/lezbike.²⁵

Një përkufizim tjetër i **identitetit gjinnor është** “Ndjenja/ndjesia e brendshme e një individi e të qenurit i gjinisë mashkullore, femërore apo e një gjinie tjetër (jo domosdoshmërisht e dukshme për të tjerët).”²⁶

Në Evropë, është normale që të përdoret termi ombrellë “transgjinnor” apo “trans” për të përmbledhur morinë e mënyrave të ndryshme në të cilat individët mund ta identifikojnë gjininë e tyre që është ndryshe nga popullsia e përgjithshme.

Përsëri, si në rastin e orientimit seksual, është shumë vështirë të përcaktohet numri i personave, të cilët identifikohen se kanë mungesë përputhjeje ndërmjet identitetit të tyre gjinnor dhe seksit me të cilin kanë lindur. Sipas disa vlerësimeve, ky numër është ndërmjet 0.3 për qind dhe 3 për qind të popullsisë.²⁷ Duke patur parasysh stigmën sociale dhe diskriminimin e përhapur ndaj personave transgjinnorë, përlogaritjet në popullsi janë të vështira.

Siç ndodh me orientimin seksual, secili prej nesh ka një identitet gjinnor. Për shumicën e popullsisë ekziston përputhja ndërmjet seksit tonë biologjik dhe ndjenjës sonë të identitetit gjinnor. Për ata që nuk e kanë këtë përputhje, përcaktimi i identitetit të tyre gjinnor mund të jetë një rrugëtim i dhembshëm dhe i ndërlikuar dhe, shpeshherë, ndikon ndjeshëm në jetën e tyre.

Shprehja e gjinisë lidhet me shprehjen e gjinisë së personit përmes veshjes, mbajtjes, të folurit, modelit të flokëve, gjuhës së shenjave, ndërveprimeve sociale dhe sjelljeve të tjera.²⁸ Shprehja e gjinisë, kundrejt identitetit gjinnor, është ajo çka është nga jashtë.

Ndërsa identiteti gjinnor lidhet me atë se si ndihemi, shprehja e gjinisë lidhet me morinë e zgjedhjeve që bëjmë në përditshmëri lidhur me atë se çfarë veshim dhe si vishemi dhe sillemi. Shumica nga ne i quan këto gjëra të mirëqena, por, kur identiteti ynë gjinnor nuk përputhet me gjininë që na është përcaktuar në lindje, marrja e vendimit si duhet të shprehet ai fizikisht mund të jenë diçka e ndërlikuar dhe, shpeshherë, duhet marrë një vendim që ndryshon jetën.

Tranzicioni

Shpeshherë, procesi i ndryshimit të gjinisë quhet *tranzicion*. Ky është procesi përmes të cilit kalon një person nga të qenit i konsideruar kryesisht i një gjinie tek të qenit i konsideruar kryesisht i një gjinie tjetër, dhe koha që kërkon kjo gjë. Tranzicioni i një personi mund të ketë aspekte sociale, ligjore dhe/ose mjekësore.

Tranzicioni mund të jetë një ndryshim social që kërkon ndryshime, ndër të tjera, në pamjen fizike, veshje dhe marrëdhëniet shoqërore. Gjithashtu, ai mund të kërkojë tranzicion të konsiderueshëm fizik, duke përdorur terapinë me hormone dhe, për disa njerëz, operacion për ndryshimin e seksit.

25. <http://www.coe.int/en/web/sogidatabase/glossary>

26. Zyra e Viktimave të Krimit (2014), “Reagimi kundër dhunës seksuale ndaj viktimave transgjinnore”.

27. Po aty.

28. Aleanca Skoceze e Personave Transgjinnorë, “Identiteti gjinnor – udhëzues fillestar për mbështetjen e personave transgjinnorë”.

Personat, të cilët i kanë marrë në mënyrë të përhershme karakteristikat fizike të gjinisë me të cilën identifikohen, mund të mos e quajnë më veten pjesë të ombrellës trans.

Germa treguese e gjinisë

Germa treguese e gjinisë (Gjini-treguesi) është diçka me të cilën punonjësit e policisë ndeshen pothuajse çdo ditë. Treguesit janë identifikues të gjinisë që, shpeshherë, gjenden në dokumente, si: karta kombëtare e identitetit, lejet e drejtimit të mjetit dhe pasaportat. Treguesit më të dukshëm të gjinisë janë përcaktimet mashkull/femër ose z./znj. Ato mund të jenë edhe tituj profesionesh, përemra pronorë apo numra të koduar, si: numrat e sigurimit shoqëror dhe numrat e kodit tatimor, që mund të përdorin kombinime të caktuara për burra dhe gra.²⁹

Në shumë vende, ndryshimi i gërmës treguese të gjinisë në dokumentet e identitetit mund të jetë tejet i vështirë, për të mos thënë i pamundur. Kjo gjë shkakton vështirësi për personat transgjnorë në situata kur dokumentacioni kërkohet për ndërveprim nga autoritetet publike, siç është policia. Kjo do të shtjellohet edhe më tej në Modulin Katër.

Përemrat

Përemrat janë fjalë që mund të përdoren për t'iu referuar një individi në vend të emrit të tij. Ndër përemrat e zakonshëm përfshihen ai/ajo, atë/atë, i tij/i saj. Disa individë transgjnorë përdorin përemra të gjinisë asnjansë ose, në vend të përemrave gjnjorë, përdorin «ata/i tyre». Kjo do të analizohet më tej në Modulin e Katërt.

Disa përkufizime të tjera të termit trans

Ekziston një mori mënyrash se si mund ta përcaktojnë shprehjen e gjinisë specifike dhe formimin e identitetit gjnjor personat, të cilët klasifikohen në ombrellën transgjnore. Një numër prej tyre parashtrihen më poshtë. Sidoqoftë, nëse nuk jeni të sigurt për termin që duhet përdorur, mbani parasysh se, përgjithësisht, termi **“trans”** konsiderohet përfshirës dhe i respektueshëm. Kur keni të bëni me një individ, shpeshherë, më e mira është ta pyesni personin në mënyrë të respektueshme. Përsëri, në Modulin e Katërt ne do ta shohim më tej si duhet ndërvepruar më së miri nga pikëpamja profesionale me personat trans.

Transeksual është term që përdoret për persona, të cilët kanë një identitet gjnjor që nuk përkon me seksin e përcaktuar në lindje, dhe të cilët, si pasojë, e korrigjojnë atë seks duke modifikuar aspektin e tyre fizik apo funksionet e tyre trupore ndërsa i nënshtrohen trajtimit për ndryshimin e gjinisë.

Një burrë trans **femër në mashkull/FNM** është dikush, që është klasifikuar femër në lindje, por ka identitet gjnjor mashkullor dhe ndryshon që të jetojë përherë si burrë.

Një grua trans **mashkull në femër/MNF** është dikush, që është klasifikuar mashkull në lindje, por ka identitet gjnjor femëror dhe ndryshon që të jetojë përherë si grua.

Mbajtës i veshjeve tipike për seksin e kundërt është një term për të përshkruar njerëzit, të cilët vendosin të mbajnë veshje që, përgjithësisht, lidhen me gjininë e kundërt. Ata veprojnë kështu pasi kjo i plotëson në aspektin emocional apo seksual. Fjala **“transvestit”** nuk përdoret më dhe për disa njerëz mund të jetë fyese.³⁰

Burrë i veshur si grua është një term që, historikisht, është përdorur nga burrat gej, të cilët vishen me rroba që, zakonisht, i mbajnë gratë për qëllime zbatimje ose plotësimi personal. Janë edhe gratë e veshura si burra, të cilat, biologjikisht, janë femra dhe vishen si burra.³¹

Person cisgender³² është një term që përdoret për të dhënë përshkrimin e atyre, të cilët nuk janë transgjnorë – d.m.th., që cilët kanë një identitet gjnjor ose performojnë në një rol gjnjor që shoqëria e konsideron të përshtatshëm për seksin e tyre.³³

Person queer (lexo Kujër)³⁴ është një term që përdoret nga personat të cilët nuk duan të pranojnë dualizmin gjnjor (mashkull/femër) duke përkrahur një identitet më fluid, apo jotradicional.³⁵

Binari gjnjor është një koncept social i formuar në shoqëri që tregon se ekzistojnë vetëm dy gjini: mashkull dhe femër.

29. <http://www.coe.int/en/web/sogidatabase/glossary>

30. <http://www.transequality.org/issues/resources/teaching-transgender-guide-leading-effective-trainings>

31. <http://www.transequality.org/issues/resources/teaching-transgender-guide-leading-effective-trainings>

32. Tregon një person, identiteti personal dhe gjinia e të cilit përkojnë me seksin e tij në lindje.

33. <http://rainbowcenter.uconn.edu/terms/>

34. Person që nuk pajtohet me dallimet konvencionale të gjinive, duke mos e identifikuar veten me asnjërën apo kombinimin e tyre.

35. <http://rainbowcenter.uconn.edu/terms/>

Gjini jo-binarizuese jep përshkrimin e një identiteti gjinor që nuk është as mashkull, as femër; ose identiteteve gjinore që janë jashtë ose i kapërcejnë dy konceptet tradicionale të mashkullit dhe femrës.³⁶

Interseks (Ndërseksual): komponenti “I”

Njerëzit Intersex (ndër-seksual) janë personat që nuk përputhen me normat mjekësore dhe të shoqërisë të të ashtuquajturve trupa femërorë dhe mashkullorë për sa i takon seksit të tyre kromozomal, gonadal, endokrin apo anatomik.

Kjo e fundit bëhet e dukshme, për shembull, tek karakteristikat dytësore seksuale, si: masa muskulore, përhapja e qimeve dhe shtatlartësia, ose tek karakteristikat kryesore seksuale, si: organet e brendshme dhe të jashtme gjinore dhe/ose struktura e kromozomeve dhe e hormoneve.

Mund të përdoret edhe një përkufizim më i thjeshtë praktik: personat Intersex janë Intersex pasi karakteristikat e tyre të lindura seksuale janë ose mashkullore dhe femërore në të njëjtën kohë, ose jo krejt mashkullore apo femërore, *apo* as mashkullore, as femërore.

Ekzistojnë shumë forma të ndryshme të ndër-seksit; ajo është më shumë një spektër a term ombrellë se sa një kategori e vetme. Fjala ka zëvendësuar termin “hermafrodit”, që është përdorur gjerësisht nga mjekët gjatë shekullit të 18-të dhe 19-të. Të përdorësh termin hermafrodit sot konsiderohet thellësisht fyese.

Një person ndërseksual është i lindur. Dallimet mund të jenë të dukshme qartë në lindje. Disa veçori bëhen të dukshme në moshën e pubertetit, gjatë përpjekjeve për ngjizje ose rastësisht. Raste të tjerë mund të zbulohen vetëm gjatë një autopsie.

Një ndryshim i rëndësishëm ndërmjet personave Intersex dhe personave transgjinorë është se, shpeshherë, personat Intersex identifikohen si të tillë nga mjekët, kur janë fëmijë të vegjël ose gjatë adoleshencës. Shpeshherë, organet e tyre gjinore mund të operohen ose organet e tyre riprodhuese mund të hiqen përpara se të vijnë në moshën kur mund ta japin ose jo pëlqimin e tyre.

Statistika më e ulët, që është përdorur duke iu referuar personave Intersex, është 1 në 200 (0.5 për qind e lindjeve). Shpeshherë, citohen statistika edhe më të ulëta prej 1 në 2000, por këto statistika përfshijnë vetëm disa persona Intersex, të cilët janë operuar në fëmijëri. Agjenci të ndryshme, siç janë Kombet e Bashkuara, kanë përdorur statistika deri në 1.7%.

Kjo i bën dallimet ndërgjinore më të zakonshme se sikur të lindësh i shurdhët e, madje, po aq të zakonshme sa sikur të kesh flokë të kuq.³⁷

Është e qartë se rreziku i diskriminimit dhe i shkeljeve të të drejtave të njeriut të personave Intersex ka qenë dhe mbetet i madh. Një numër i vogël vendesh e kanë pranuar shprehimisht personat interseks si kategori të mbrojtur për efekt të ligjeve mbi krimet e urrejtjes (p.sh.: Skocia dhe Malta në Këshillin e Evropës). Vetë Këshilli i Evropës ka theksuar rëndësinë e përfshirjes së karakteristikave seksuale si aspekt i mbrojtur për qëllime të legjislacionit mbi krimet e urrejtjes (vendosni referimin).

Komunitete komplekse dhe përvoja të përbashkëta

Informacioni më sipër tregon komunitete disi komplekse që klasifikohen në ombrellën LGBTI.

Komuniteti LGBTI nuk klasifikohet në ato që konsiderohen norma të dyfishta seksuale dhe gjinore. Sidoqoftë, në shumë raste, individë brenda një nëngrupi nuk e shohin veten si persona që kanë përvoja të përbashkëta me personat e nëngrupeve të tjera. Shumë persona LGB nuk shohin ndonjë lidhje të natyrshme ndërmjet komunitetit të tyre dhe personave transgjinorë. Shumë persona transgjinorë e shohin çështjen e identitetit të tyre gjinor si çështje që është e dallueshme nga orientimi seksual dhe në fushatën për njohje mbështesin qasje të veçanta. Gjithashtu, një person mund të jetë anëtar i më shumë se një nëngrupi (p.sh.: një person trans që e konsideron veten lezbike).

Ndërmjet personave LGB (orientimi seksual), personave transgjinorë (identiteti gjinor dhe shprehja e gjinisë) dhe personave Intersex (karakteristikat seksuale) ekzistojnë dallime koncize. Ndërsa përvojat e jetës të personave në fjalë mund të jenë shumë të ndryshme, shpeshherë, grupet përmblihen në një term të vetëm ombrellë për të mbështetur të kuptuarit se grupet janë objekt i sjelljeve diskriminuese të të njëjtit lloj, përfshirë krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI.

36. https://lgbt.wisc.edu/documents/Trans_and_queer_glossary.pdf

37. <http://www.ilga-europe.org/what-we-do/our-advocacy-work/trans-and-intersex/intersex>

Informacioni për personat Intersex si viktimë të krimeve të urrejtjes është i kufizuar, ndërsa agjencitë ligjzbatuese dhe OJQ-të janë vetëm në fillim të përcaktimit të këtyre përvojave.

Përkatësia në më shumë se një grup të diskriminuar ose paragjykuar (interseksionaliteti) i referohet diskriminimit të shumëfishtë që mund të përjetojë dikush duke qenë pjesë e më shumë se një grupi të paragjykuar. Interseksionaliteti i shton sfidat që ekzistojnë në jetën e personave LGBTI. Për shembull, një gruaje zezake lezbike, mund t'i duhet që të përballë me racizmin, homofobinë dhe seksizmin. Sjellja diskriminuese mund të mos vijë thjesht nga shoqëria në përgjithësi; edhe vetë brenda komunitetit LGBTI ekziston racizmi dhe brenda pakicave raciale ekziston homofobia.

Një personi mysliman trans mund t'i duhet që të përballë si me diskriminimin për shkak të fesë, ashtu dhe me urrejtjen ndaj personave transgjinorë, nga persona brenda komunitetit dhe nga ata jashtë tij.

PËRKUFIZIMET KRYESORE: HOMOFOBIA, TRANSFOBIA, STEREOTIPET DHE DISKRIMINIMI

Homofobia përkufizohet si frikë joracionale dhe neveri ndaj homoseksualizmit dhe personave lezbike, gej dhe biseksualë mbi bazën e paragjykimeve. Një përkufizim i thjeshtë do të ishte "*frikë apo antipati për personat LGB*".

Transfobia përkufizohet si frikë joracionale dhe neveri për mospërputhjen e gjinisë të personave transgjinorë me seksin e tyre në bazë të paragjykimit. Një përkufizim i thjeshtë do të ishte "*frikë apo antipati për personat transgjinorë*".

Homofobia dhe urrejtja ndaj personave transgjinorë në shoqëri mund të shfaqen në formën e shmangies, përjashtimit social, diskriminimit, sjelljes abuzive, dhunës e, madje, të vrasjes me paramendim.

Homofobia dhe transfobia mund të vijnë si rezultat i qëndrimeve dhe besimeve që i marrim ose i mësojmë nga prindërit, miqtë, shkollat, komuniteti, drejtuesit fetarë dhe figurat sociale me influencë (politikanët/njerëzit e famshëm). Homofobia dhe transfobia ndeshen në masë të ndryshme në gjithë vendet.

Stereotip është një qëndrim a besim ndaj një personi ose personave në bazë të veçorive apo karakteristikave që kanë, ose grupeve që u përkasin³⁸. Përkufizim tjetër i **stereotipit** është:

Një përgjithësim i paragjykuar ose i tejthjeshtëzuar për një grup të tërë personash pa marrë parasysh dallimet e tyre individuale. Shembuj të stereotipeve janë:

- ▶ Të gjitha lezbiket janë si meshkuj
- ▶ Të gjithë emigrantët afrikanë janë kriminelë
- ▶ Të gjithë oficerët e policisë e shpërdorojnë pushtetin që kanë
- ▶ Të gjithë myslimanët janë ekstremistë fetarë

Stereotipet janë perceptime të paracaktuara dhe të satirizuara që sjellin si rezultat veshjen e të njëjtave veçori përgjithëse gjithë anëtarëve të grupeve të caktuara, pa u kushtuar vëmendje veçorive të tyre individuale. Stereotipet mund të çojnë në paragjykime ndaj grupeve të tjera dhe, përfundimisht, në sjellje dhe veprime diskriminuese.

Ndonëse shpeshherë janë negative, stereotipet mund të jenë edhe komplimente. Sidoqoftë, stereotipet pozitive gjithsesi mund të kenë impakt negativ, thjesht sepse nënkuptojnë përgjithësim të gjera që injorojnë realitetet individuale.³⁹ Një shembull i kësaj do të ishte se gratë kujdesen për fëmijët më mirë se burrat. Ky stereotip injoron realitetin se janë të shumta gratë që abuzojnë, për shembull, me fëmijët dhe nuk duhet të lihen që të kujdesen për ta.

Koncepti i **paragjykimit** është i lidhur me konceptin e stereotipit.

Paragjykimi është një gjykim paraprak dhe një ide apo qëndrim i paracaktuar ndaj personave ose grupeve të tjera. Shpeshherë, paragjykimet janë negative dhe, përgjithësisht, bazohen më shumë në thashetheme, hamendje, ndjenja dhe besime se sa në njohuri dhe fakte. Paragjykimet ndikojnë si në veprimet tona, ashtu dhe në interpretimet që u bëjmë ne veprimeve të të tjerëve.

38. OSBE (2014) TAHCLE, Manual trajnimi "Për krimin për shkak të urrejtjes" për trajnues, përgatitur për programin mësimor të zbatimit të ligjit.

39. <https://lgbtrc.usc.edu/education/terminology/>

Shënim për trajnuesit:

Legjislati vendas dhe përkufizimet përkatëse të diskriminimit duhen rishikuar përpara seancës së trajnimit dhe duhen përfshirë, sipas rastit. Pjesëmarrësve duhet t'u jepet si përkufizimi i diskriminimit, ashtu dhe përkufizimi i grupeve të mbrojtura që parashikon legjislati.

Diskriminimi: Shumica e vendeve kanë përkufizime ligjore të diskriminimit. Shpeshherë, përkufizimet parashikojnë si diskriminimin e drejtpërdrejtë, ashtu dhe diskriminimin e tërthortë. Përkufizimi në vijim i diskriminimit është më i gjerë dhe pasqyron përvojat e komunitetit LGBTI dhe të komuniteteve të pakicave të tjera në shumë vende:

“Diskriminimi ndodh kur anëtarë të një grupi social më të fuqishëm sillen në mënyrë të padrejtë ose mizore ndaj anëtarëve të një grupi social më pak të fuqishëm. Diskriminimi mund të marrë shumë forma, përfshirë si aktet individuale të urrejtjes apo padrejtësisë, ashtu dhe mohimet nga ana e institucioneve të privilegjeve që u njihen normalisht grupeve të tjera”.

<https://lgbtrc.usc.edu/education/terminology/>

Përkufizimi ligjor i diskriminimit

Ligjërisht, **diskriminimi** përcaktohet si trajtim i pajustificuar, i pabarabartë:

1. *Diskriminimi i drejtpërdrejtë ndodh kur, për një arsye që lidhet me një a më shumë shkaqe të ndaluara, një person a grup personash trajtohet në mënyrë më pak të favorshme nga sa trajtohet, është trajtuar apo do të ishte trajtuar një person a grup tjetër personash në një situatë të krahasueshme; ose kur, për një arsye që lidhet me një a më shumë shkaqe të ndalura, një person a grup personash bëhet objekt i një dëmtimi.*

Me fjalë më të thjeshta: Diskriminimi i drejtpërdrejtë ndodh kur një person ose persona trajtohet/trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se shumica e popullsisë për shkak të përkatësisë në një grup të pakicës.

Ndër shembujt e këtij diskriminimi do të ishte refuzimi nga ana e një oficeri të policisë për të pranuar kallëzimin për krim nga një viktimë e krimit, sepse viktima është nga komuniteti i personave transgjinjorë, romë apo nga një komunitet fetar i pakicës.

2. *Diskriminimi i tërthortë ndodh kur një dispozitë, kriter a praktikë i vë personat, të cilët kanë një status apo një karakteristikë që lidhet me një ose më shumë shkaqe të ndaluara (përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor) në një pozitë të posaçme të pafavorshme krahasuar me persona të tjerë, përveç kur dispozita, kriteri a praktika është objektivisht e justifikueshme nga një synim legjitim, dhe mjetet për arritjen e atij synimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme.*

Me fjalë më të thjeshta: Diskriminimi i tërthortë ndodh kur praktika, rregulla apo politika të caktuara e vënë një person a persona në një pozitë të pafavorshme krahasuar me anëtarët e shumicës. Nganjëherë, diskriminimi i tërthortë është më i vështirë për t'u identifikuar se sa diskriminimi i drejtpërdrejtë.

Një shembull i këtij diskriminimi do të ishte njohja e të drejtave për leje të posaçme vjetore punonjësve të policisë që janë të martuar, kur politikat dhe/ose legjislati nuk i njohin marrëdhëniet ndërmjet njerëzve me të njëjtin seks.

Një shembull tjetër do të ishte mospranimi për të njohur kualifikimet arsimore të marra jashtë vendit ku operon forca policore, edhe sikur ato të jenë po aq të mira sa dhe kualifikimet arsimore lokale. Kjo formë e tërthortë e diskriminimit do t'i përjashtonte personat me prejardhje etnike të ndryshme që të punësoheshin në polici.

PREZANTIMI 2.1: MBANI SHËNIM!

Cila është përbërja e komunitetit LGBTI? – Konceptet dhe përkufizimet kryesore


Orientimi seksual	
LGB	L - G - B -
Identiteti gjinor	
Shprehja e gjinisë	
Transgjisor ose T	
Interseks	

Sjellja e dëmshme sociale – koncepte kryesore dhe përkufizime

Homofobia	
Transfobia	
Stereotipet	
Diskriminimi	I drejtpërdrejtë - I tërthortë -

PREZANTIMI 2.1B: PREZANTIMI I KONCEPTEVE KRYESORE

Biskota e njeriut xhenxhefil (ginger) është një mjet ndihmës për të identifikuar dhe kuptuar konceptet kryesore LGBT që janë diskutuar deri tani në këtë modul. Jeni të lutur të mbani parasysh se ky ushtrim nuk është i përshtatshëm për diskutime lidhur me personat Intersex. Arsyeja është sepse figura nuk pasqyron diversitetin e karakteristikave seksuale që përputhen me përkufizimin e personave Intersex. Kur të diskutoni për çështje ndërgjinore, jeni të lutur t'i referoheni gjuhës në aktivitetin 2.1 dhe prezantimin 2.1a.⁴⁰



Orientimi seksual: Çfarë ndiejmë për të tjerët, të cilët na tërheqin emocionalisht dhe fizikisht, çfarë kemi në zemrat tona. Të qenit homoseksual, lezbike, biseksual apo heteroseksual.

Identiteti gjinor: Çfarë mendojmë dhe ndiejmë për gjininë tonë; çfarë kemi në trurin tonë (p.sh.: ndihem mashkull apo femër apo të dyja bashkë).

Shprehja e gjinisë: Si e shprehim ne veten përmes sjelljes dhe pamjes fizike. Veshja, flokët, bizhuteritë, manierizmat tona etj. Të qenit, ndër grupet e tjera, trans, cisgender apo mbajtës veshjesh tipike për seksin e kundërt.

Seksi ynë: Përbërja biologjike e kromozomeve dhe organeve fizike. Çfarë është ajo që na bën të jemi mashkull, femër, të dyja apo asnjëra.

Lezbike: grua tërheqjet kryesore romantike, emocionale, fizike dhe seksuale të së cilës janë ndaj grave të tjera.

Gej: burrë tërheqjet kryesore romantike, emocionale, fizike dhe seksuale të të cilit janë ndaj burrave të tjerë.

Biseksual: person, i cili ndien tërheqje të konsiderueshme romantike, emocionale, fizike dhe seksuale ndaj pjesëtarëve të të dy sekseve.

Heteroseksual: person, i cili, në aspektin emocional, romantik ose seksual, ndien tërheqje a përkushtim ndaj pjesëtarëve të seksit të kundërt.

Transgjinorë: persona, të cilët kanë një identitet gjinor që ndryshon nga gjinia që përcaktohet në lindje, dhe ata persona, të cilët dëshirojnë ta përshkruajnë identitetin e tyre gjinor ndryshe nga gjinia që përcaktohet në lindje.

40. <http://itspronouncedmetrosexual.com/03/2012/the-genderbread-person-v0-2/>

AKTIVITETI 2.2: TË KUPTUARIT E STEREOTIPEVE - PUNË NË GRUPE, PASUAR NGA PREZANTIMI NË SEANCË PLENARE DHE DISKUTIME (20 MINUTA)

Shënim për trajnuesit:

Ky ushtrim duhet moderuar me kujdes me qëllim që mbledhja e stereotipeve negative kundër personave LGBTI të mos përdoret si mundësi për të shfaqur homofobinë apo transfobinë. Kjo mund të jetë e përshtatshme në mjedise pune shumë të vështira apo kur moderatori nuk ka përvojë në menaxhimin e diskutimeve ku debatohet.

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme, stilolapsa

Dhoma ose hapësirë në dhomën e trajnimit për ndarjen në grupe

1. Ndajini pjesëmarrësit në katër grupe.
2. Çdo grupi caktojini detyrën që të mbledhë sa më shumë stereotipe që të jetë e mundur në këto fusha:
 - ▶ grupit të parë t'i kërkohet që të mbledhë stereotipe negative për personat LGBTI;
 - ▶ grupit të dytë t'i kërkohet që të mbledhë stereotipe negative për policinë;
 - ▶ grupit të tretë t'i kërkohet që të mbledhë stereotipe pozitive për personat LGBTI;
 - ▶ grupit të katërt t'i kërkohet që të mbledhë stereotipe pozitive për policinë.
3. Jepuni grupeve pesë minuta kohë që të identifikojnë stereotipet përkatëse. Pastaj, mblidhni sërish pjesëmarrësit dhe kërkoni që grupet të parashtrajnë konkluzionet e tyre. Hidhni rezultatet në katër fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme.
4. Përmes një diskutimi të përgjithshëm, bëni këto pyetje:
 - ▶ A japin stereotipet një përshkrim të saktë të grupeve individuale?
 - ▶ Çfarë dëmi mund t'u sjellin stereotipet anëtarëve të dy grupeve në fjalë?

Ushtrimi duhet të ekspozojë paragjykimet dhe të tregojë se gjithë grupet vuajnë nga stereotipet. Shqyrtimi paralelisht i personave LGBTI dhe i policisë duhet të krijojë një lidhje ndërmjet policisë dhe komunitetit LGBTI.

[Burimi: Polack, R. dhe LeDeroff, J. (2010), "Përmbledhje me informacione dhe këshilla e 'ILGA-Europe' për trajnimin e oficerëve të policisë lidhur me ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes ndaj personave LGBT", "ILGA-Europe"]

AKTIVITETI 2.3A: TË KUPTUARIT E STEREOTIPEVE - PUNË NË GRUPE PASUAR NGA PREZANTIMI NË SEANCË PLENARE DHE DISKUTIME (20 MINUTA)

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme

Letër, stilolapsa

1. Lëri pjesëmarrësit që të punojnë vetë, duke u kërkuar që të mendojnë për ndonjë moment kur ata ose ndonjë pjesëtar i familjes së tyre janë karakterizuar nga ndonjë stereotip. Lëri që të dokumentojnë cili ka qenë impakti i atij karakterizimi.
2. Pas disa minutash, kërkoni që një numër pjesëmarrësish të parashtrajnë përvojën e tyre.

AKTIVITETI 2.3B: TË KUPTUARIT E STEREOTIPEVE 2: DISKUTIM NË GRUP (15 MINUTA)

Bazuar në diskutimin e mësipërm, bëjini grupit pyetjet më poshtë, duke i hedhur idetë e tyre në tabelën me fletë të lëvizshme:

- ▶ Duke patur parasysh perceptimin që keni për stereotipet, cilët janë risqet ndaj individëve, familjeve dhe komuniteteve nëse nuk sfidahej stereotipet?
- ▶ Cilët janë risqet nëse punonjësit e policisë kanë këto stereotipe?

Moduli 2 (b): Konceptet dhe përkufizimet kryesore – krimet e urrejtjes

REZULTATET E PËRFTUARA NGA TË MËSUARIT

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të kenë njohuri të qarta të përkufizimit të krimeve të urrejtjes;
- ▶ do të arrijnë të bëjnë dallimin e një krimi të urrejtjes nga një incident për shkak të urrejtjes;
- ▶ do të kenë njohuri për disa prej veçorive kryesore të krimeve të urrejtjes që lidhen me policimin;
- ▶ do të hulumtojnë kontekstin e tyre kombëtar/lokal të policimit;
- ▶ do të jenë të aftë për të përdorur terminologjinë gjatë gjithë seancës së trajnimit dhe në punën e tyre;
- ▶ do të kuptojnë se, edhe sikur të mos ekzistojë legjislacioni mbi krimin për shkak të urrejtjes, krimet e urrejtjes, si koncept i policimit praktik dhe social, ende ekzistojnë.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE DHE AFATET KOHORE

- ▶ Aktiviteti 2.4: Çfarë janë krimet e urrejtjes? Prezantim dhe diskutim (20 minuta)
- ▶ Aktiviteti 2.5: Pyetje të shpejta për përkufizimet (10 minuta)
- ▶ Aktiviteti 2.6: Përcaktoni përmbajtjen e legjislacionit kombëtar mbi krimet e urrejtjes (10 minuta)

AKTIVITETI 2.4: ÇFARË PËRBËN KRIM TË URREJTJES? PREZANTIM DHE DISKUTIM (30 MINUTA)

Shënim për trajnuesit:

Legjislacioni vendas dhe përkufizimet ligjore të krimeve të urrejtjes /incidentit për shkak të urrejtjes/gjuhës së urrejtjes duhen rishikuar përpara trajnimit dhe duhen përfshirë, sipas rastit. Pjesëmarrësit duhet të marrin njohuri si për përkufizimet, ashtu dhe për grupet e mbrojtura që parashikon legjislacioni.

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme, stilolapsa, letër

Prezantimi 2.4a

Prezantimi 2.4b

Në këtë aktivitet, trajnuesi do të japë përkufizimin e krimeve të urrejtjes dhe disa koncepte kryesore përkatëse në seancë plenare. Prezantimi 2.4a mund t'u shpërndahet pjesëmarrësve (pasi të jetë përshtatur, sipas nevojës, për përdorim lokal). Prezantimi 2.4b mund të përdoret nga pjesëmarrësit për të testuar njohuritë e tyre për konceptet kryesore.

Përkufizimet kryesore

Përkufizim

Krim i urrejtjes: akt kriminal me motiv paragjykses

Ndër krimet e urrejtjes përfshihen kanosja, kërcënimet, dëmet pasurore, dhuna, rrahja, vrasja me paramendim ose ndonjë vepër tjetër penale, kur viktimi, ndërtesa ose objektivi i veprës kriminale përzgjidhen për shkak të lidhjes, besnikërisë, përkatësisë, mbështetjes apo anëtarësisë së tyre reale ose të perceptuar në një grup të

mbrojtur përgjithësisht nga legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi.

Dy janë elementet thelbësorë të krimeve të urrejtjes:

a) ka ndodhur një **vepër penale**, dhe

b) autori i veprës kriminale e ka kryer atë bazuar në një **motiv paragjykses**

Pa secilin prej elementeve të mësipërm, një incident nuk mund të cilësohet krim për shkak të urrejtjes.

Krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI janë akte kriminale për motive paragjykses. Ato janë krime për shkak të urrejtjes, kur viktimat, ndërtesa apo objektivi i veprës kriminale përzgjidhen për shkak të lidhjes, besnikërisë, përkatësisë, mbështetjes apo anëtarësisë së tyre reale ose të perceptuar në një grup LGBTI. Duhet të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm se motivi i autorit të veprës kriminale është orientimi seksual, identiteti gjinor, shprehja e gjinisë apo karakteristikat seksuale të viktimës.⁴¹

Incidente me motive urrejtjeje janë ngjarje, akte apo shfaqje intolerance që kryhen me një shkak paragjykses (motivi) që mund të mos arrijnë pragun e krimeve për shkak të urrejtjes, për shkak se ekzistojnë të dhëna të pamjaftueshme për t'i paraqitur në gjykatë si prova të veprës kriminale apo motivit paragjykses, ose për shkak se vetë akti mund të mos përbëjë vepër penale në bazë të legjislacionit vendas.

Bërja e një komenti, për shkak të urrejtjes ndaj personave transgjitorë, kundër dikujt në rrugë me zë të lartë mund të jetë incident urrejtjeje, nëse komenti dhe sjellja kërcënuese nuk janë të mjaftueshme për të dhënë një dënim penal.

Gjuha e urrejtjes u referohet shprehjeve publike që përhapin, provokojnë, nxisin ose justifikojnë urrejtjen, diskriminimin apo dhunën ndaj një grupi të caktuar (zakonisht i përkasin një pakice) – për shembull, deklarata që bëhen nga drejtuesit politikë, fetare apo opinionistë të tjerë, që shpërndahen nga media ose në internet, të cilat synojnë të provokojnë apo nxisin urrejtje.

Gjuha e urrejtjes mund të jetë ose jo krim, në varësi të legjislacionit vendas.

Gjenocidi përfshin sjellje të qëllimshme për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial, fetar ose social. Krimet për shkak të urrejtjes mund të jenë në kuadër të procesit që çon në gjenocid. Mund të konsiderohen se disa akte individuale të gjenocidit përbëjnë krime për shkak të urrejtjes.

Një veçori kryesore e krimeve për shkak të urrejtjes është se, në rast se nuk ndiqen, ato mund të **përkallëzohen**. Gjuha e urrejtjes, që mbetet pa u goditur, mund të bëjë që personat të përfshihen në dëme kriminale dhe/ose akte dhune. Pasojat mund të përkallëzohen nga individit tek familja e tij, tek pjesëtarët e komunitetit të tij dhe tek gjithë shoqëria.

Për këtë arsye është me rëndësi që shkollat, komunitetet, qeveritë dhe policia të ndërhyjnë, sipas rastit, në mënyrë të menjëhershme për të parandaluar përkallëzimin e sjelljeve diskriminuese.

Karakteristikë e mbrojtur është veçori thelbësore e një grupi, si: raca, besimi fetar, etnia, kombësia, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, karakteristikat seksuale apo ndonjë faktor i ngjashëm i përbashkët që është *thelbësor për identitetin e personit*. Karakteristikat e mbrojtura përfaqësojnë pjesë të karakterit tonë si individë që *nuk mund t'i ndryshojmë lehtë*. Ato priren të jenë karakteristika ku ekziston një *model* i dukshëm i *diskriminimit në kohë* dhe kulturë.

Shpeshherë, në legjislacion, orientimi seksual dhe identiteti gjinor jepen si karakteristika të mbrojtura, meqenëse ato janë karakteristika personale që nuk mund të ndryshohen. Modele të qarta të diskriminimit kundër personave LGBTI identifikohen në kultura të ndryshme edhe në shekujt e mëparshëm. Ndër këto modele përfshihet kriminalizimi, abuzimi dhe stigmatizimi social i personave LGBTI.

Shpeshherë, krimet e urrejtjes quhen **krime me mesazh**, meqenëse, shpeshherë, synimi i autorit të veprës kriminale është që t'i dërgojë një mesazh një grupi a komuniteti se ata nuk janë të mbrojtur. Është përgjegjësi e komunitetit të drejtësisë penale, përfshirë policinë, që t'u dërgojë një **mesazh** autorëve të veprës penale se shoqëria nuk do t'i tolerojë të tilla krime.

Shkrimi "Vdekje të gjithë pederastëve" në murin e ndonjë qendre a pikëtakimi të komunitetit LGBT është krim me mesazh. Përmes këtij akti gjithë komunitetit lokal LGBT i dërgohet një mesazh se ai nuk është i mbrojtur.

Mbani parasysh se **nuk është e nevojshme që të tregoni** se autori i veprës penale e **urrente** grupin e përzgjedhur. Mjafton të tregohet se viktimat u zgjedhën si rezultat i përkatësisë në një grup të mbrojtur

41. <http://www.coe.int/en/web/sogidatabase/glossary>

(**përzgjedhje paragjyquese**). Gjithashtu, autori i krimit të urrejtjes mund të jetë pjesëtar i të njëjtit grup.

Për shembull, shpeshherë, kriminelët përzgjedhin burra gej si objektiva shantazhi, meqenëse shpresojnë të arrijnë të përfitojnë para prej tyre për shkak të frikës së ekspozimit. Kriminelët mund të mos i urrejnë burrat gej në fjalë, por thjesht dëshirojnë të bëjnë para në mënyrën më të lehtë të mundshme.

Duhet mbajtur parasysh se jo gjithë vendet kanë ligje mbi krimet e urrejtjes. Në këto vende mund të jetë e dobishme që, kur shkohet në polici, këto incidente të ndiqen si **krime me motive urrejtjeje**.

Nuk është e domosdoshme që viktima të jetë pjesë e grupit të mbrojtur. Viktima mund të jetë edhe një person që shënjestrohet për shkak të **mbështetjes** për atë grup, **ose** që është **identifikuar gabimisht** sikur është pjesë e grupit.

Për shembull, viktima mund të jetë një burrë heteroseksual, që kalonte përpara një bari për persona gej dhe u mor gabimisht si klient dhe, si pasojë, u rrah nga naziskinet. Viktima mund të jetë edhe një personalitet televiziv që mbështet të drejtat e homoseksualëve dhe vihet në shënjestër nga grupet e djathta si rezultat i kësaj mbështetjeje.

Viktima mund të mos e dijë se ka qenë **viktimë** e krimeve të urrejtjes ose **mund të mos e kuptojë konceptin**. Kjo nuk e mohon faktin se incidenti mund të jetë një rast i krimeve të urrejtjes.

Viktima mund ta dijë ose jo se është vënë në shënjestër pasi është anëtar i një grupi të pakicës. I takon policisë që të identifikojë nëse ekziston një motiv paragjyqes dhe, sipas rastit, t'ia shpjegojë këtë viktimës. Perceptimi i viktimës është vetëm një nga faktorët e shumtë që duhen marrë në konsideratë këtu (shih Modulin Katër "Treguesit e njëanshmërisë").

PREZANTIMI 2.4A – DOKUMENT INFORMUES PËR KRIMET E URREJTJES

Përkufizime:

Krim për shkak të urrejtjes: një akt kriminal me motiv paragjykses. Ndër krimet e urrejtjes përfshihen kanosja, kërcënimet, dëmet pasurore, aktet e dhunës, vrasja me paramendim ose ndonjë vepër tjetër penale, kur viktimat, ndërtesa ose objektivi i veprës kriminale përzgjidhen për shkak të lidhjes, besnikërisë apo përkatësisë së tyre reale ose të perceptuar në një grup të mbrojtur, apo për shkak të mbështetjes për këtë grup ose anëtarësisë në të.

Krim për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI: një akt kriminal me motiv paragjykses. Krimet për shkak të urrejtjes, kur viktimat, ndërtesa ose objektivi i veprës kriminale përzgjidhen për shkak të lidhjes, besnikërisë apo përkatësisë së tyre reale ose të perceptuar në një grup LGBTI, apo për shkak të mbështetjes për këtë grup ose anëtarësisë në të. Duhet të ketë një dyshim të arsyeshëm që motivi i autorit të veprës penale të jetë orientimi seksual apo identiteti gjinor i viktimës.

Dy elementet thelbësore të krimeve të urrejtjes janë se:

- a) ka ndodhur një **vepër kriminale**, dhe
- b) autori i veprës kriminale kishte **motiv paragjykses**.

Incidentet për shkak të urrejtjes janë ngjarje, akte apo shfaqje të mungesës së tolerancës, që kryhen për motive të paragjyqimeve që ka personi që mund të mos arrijnë pragun e krimeve për shkak të urrejtjes, për shkak se ekzistojnë të dhëna të pamjaftueshme për t'i paraqitur në gjykatë si prova të veprës penale apo motivet paragjyquese të saj, ose për shkak se vetë akti mund të mos përbëjë vepër penale në bazë të legjislacionit vendas.

Gjuha e urrejtjes ndaj personave LGBT u referohet shprehjeve publike që përhapin, provokojnë, nxitin ose justifikojnë urrejtjen ose diskriminimin ndaj personave LGBT, për shembull, deklaratat që bëhen nga drejtues politikë ose fetarë apo opinionistë të tjerë, që qarkullohen nga shtypi ose në internet, të cilat synojnë të provokojnë urrejtje.

Gjenocidi përfshin sjellje të qëllimshme për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial, fetar ose një grup tjetër social. Krimet për shkak të urrejtjes mund të jenë në kuadër të procesit që shpie në gjenocid. Mund të konsiderohet se aktet individuale të gjenocidit përbëjnë krim për shkak të urrejtjes.

Një veçori kryesore e krimeve të urrejtjes është se, në rast se nuk zgjidhen, ato mund të **përkallëzohen**. Gjuha e urrejtjes, që lihet e pakontrolluar, mund të çojë në dëm kriminal ose dhunë. Ndikimi që ajo ka mund të përkallëzohet nga individi tek familja, tek komuniteti lokal apo tek e gjithë shoqëria.

Një **karakteristikë e mbrojtur** është veçoria thelbësore e një grupi, si: raca, besimi fetar, etnia, kombësia, gjinia, orientimi seksual apo ndonjë faktor i ngjashëm i përbashkët që është *thelbësor për identitetin e tij*. Karakteristikat e mbrojtura përfaqësojnë pjesë të karakterit tonë si individë që *nuk mund t'i ndryshojmë lehtë*. Ato priren të jenë karakteristika kur ekziston një *model* i dukshëm i *diskriminimit në kohë* dhe kultura të ndryshme.

Shpeshherë, krimet e urrejtjes quhen **krim mesazh**, meqenëse, shpeshherë, synimi i autorit të veprës kriminale është që t'i dërgojë një mesazh një grupi a komuniteti se nuk janë të mbrojtur. Është përgjegjësi e komunitetit të ndjekjes penale që t'u dërgojë një **mesazh** autorëve të veprës kriminale se shoqëria nuk do t'i tolerojë të tilla krime.

Mbani parasysh se **nuk është e nevojshme që të tregoni** se autori i veprës penale e **urrente** grupin e përzgjedhur. Është e mjaftueshme të tregohet se viktimat u zgjedhën si rezultat i përkatësisë në një grup të mbrojtur (**përzgjedhje e njëanshme**). Autori i krimit të urrejtjes mund të jetë edhe pjesëtar i të njëjtit grup.

Duhet mbajtur parasysh se jo gjithë vendet kanë ligje kundër krimeve të urrejtjes. Në këto vende mund të jetë e nevojshme që, kur paraqiten në polici, këto incidente të ndiqen si **krime me motive urrejtjeje**.

Nuk është e domosdoshme që viktimat të jetë pjesë e grupit të mbrojtur. Viktima mund të jetë një person që shënjestrohet për shkak të **mbështetjes** për atë grup, **ose** që është **identifikuar gabimisht** sikur është pjesë e grupit.

Viktima mund të mos e dijë se ka qenë **viktimë** e krimeve të urrejtjes ose **mund të mos e kuptojë konceptin**. Kjo nuk e mohon faktin se incidenti mund të jetë një rast i krimeve të urrejtjes.

PREZANTIMI 2.4B – TEST I SHPEJTË LIDHUR ME NJOHURITË MBI KRIMET E URREJTJES

1	Plotësoni vendet bosh (e njëjta përgjigje për të dyja) Shpeshherë, krimet e urrejtjes cilësohen si krime _____. Cilësohet kështu pasi autorët e veprave penale dëshirojnë t'i dërgojnë një _____ komunitetit se pjesëtarët e tij nuk janë të mbrojtur.
2	A duhet të bëjë viktima kallëzim për krimin si një krim për shkak të urrejtjes që policia ta hetojë incidentin si të tillë? Shpjegoni shkurtimisht përgjigjen tuaj.
3	Çfarë modeli mund të shfaqet në rast se krimet e urrejtjes nuk ndiqen në një fazë të hershme?
4	Cilët janë dy komponentët kryesorë që duhet të jenë të pranishëm në çdo krim për shkak të urrejtjes? 1) _____ 2) _____
5	A duhet të jetë viktima një person LGBTI që të konsiderohet si viktimë e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI? Shpjegoni shkurtimisht përgjigjen tuaj.
6	A është e nevojshme që, gjatë një hetimi të plotë penal të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, të provohet se autori i veprës kriminale e urrente viktimën?
7	A është gjuha e urrejtjes krim për shkak të urrejtjes?
8	Rendisni karakteristikat e mbrojtura siç e parashikon legjislacioni vendas mbi krimet e urrejtjes.
9	Rendisni dy veçori të përbashkëta të një karakteristike të mbrojtur: 1) _____ 2) _____

AKTIVITETI 2.5: PYETJET MË TË SHPEJTA PËR PËRKUFIZIMET (5 MINUTA)

Materialet e nevojshme:

Stilolapsa

Prezantimi 2.5a (pyetja kuic) dhe 2.5b (përgjigjja)

Jepini çdo pjesëmarrësi një prezantim. Informojini pjesëmarrësit se pikësynimi i ushtrimit është që koncepti kryesor të lidhet me përkufizimin e dhënë. Në mbarim të kohës prej pesë minuta, jepni përgjigjet dhe kërkojuni pjesëmarrësve që t'i mbledhin pikët e tyre. Merrni në konsideratë që personit me pikët më të larta t'i jepni një shpërblim.

PREZANTIMI 2.5A – PYETJE TË SHPEJTA PËR PËRKUFIZIMET

Koncepti kryesor	Vendosni shkronjën	Përkufizimi
Diskriminimi		A Fjalët që mund të përdoren për t'iu referuar një personi në vend të emrit të tij, p.sh.: ai/ajo, atij/asaj, ata.
Homofobia		B Aftësia e një personi për tërheqje të thellë emocionale, afektive dhe seksuale dhe marrëdhënie intime dhe seksuale me të tjerë.
Trans		C Frikë joracionale/neveri ndaj homoseksualizmit dhe personave LGB në bazë të paragjyqimeve.
Interseks (Ndërseksual)		D Persona, të cilët kanë një identitet gjinor që nuk përkon me seksin e përcaktuar në lindje, dhe e modifikojnë pamjen e tyre trupore apo funksionet e tyre trupore duke bërë operacion për ndryshimin e gjinisë.
Tranzicioni		E Burrë tërheqjet kryesore romantike, emocionale, fizike dhe seksuale të të cilit janë përkundrejt burrave.
Stereotipet		F Zgjedhjet që bëjmë në përditshmëri se çfarë veshim dhe si vishemi dhe sillemi që tregojnë gjininë tonë.
Identiteti gjinor		G Proces i ndryshimit social, ligjor dhe/ose mjekësor që përfshin, ndër të tjera, pamjen fizike, veshjen dhe marrëdhëniet shoqërore.
Biseksual		H Trajtim i pajustificuar, i pabarabartë.
Lezbike		I Persona, të cilët, në aspektin emocional, romantik ose seksual ndiejnë tërheqje/përkushtim ndaj seksit të kundërt.
Përemra		J Frikë joracionale/neveri për mospërputhjen e gjinisë së personave transgjinorë në bazë të paragjyqimit.
Transeksual		K Term ombrellë që përdoret për të përmbledhur morinë e mënyrave të ndryshme në të cilat individët mund ta identifikojnë gjininë e tyre që është e dallueshme nga popullsia e përgjithshme.
Orientimi seksual		L Ndjesia e brendshme e një individi e të qenit i gjinisë mashkullore, femërore apo i një gjinie tjetër.
Heteroseksual		M Person, i cili ndien tërheqje të konsiderueshme romantike, emocionale, fizike dhe seksuale ndaj pjesëtarëve të të dy seksve.
Transfobia		N Një përgjithësim i paragjykuar ose i tejthjeshtëzuar për një grup të tërë personash pa marrë parasysh dallimet e tyre individuale.
Shprehja e gjinisë		O Grua tërheqjet kryesore romantike, emocionale, fizike dhe seksuale të së cilës janë ndaj grave.
Gej		P Përcaktime, si: mashkull/femër ose z./znj., që gjenden normalisht në dokumentet e identitetit.
Treguesi i gjinisë		Q Person i lindur me veçori fizike, hormonale ose gjenetike që nuk janë tërësisht femërore, as tërësisht mashkullore; një ndërthurje e mashkullores dhe femërores; ose as femër, as mashkull.

PREZANTIMI 2.5B – PËRGJIGJET E PYETJEVE KUIC PËR PËRKUFIZIMET

Koncepti kryesor	Vendosni shkronjën		Përkufizimi
Diskriminimi	H	A	Fjalët që mund të përdoren për t'iu referuar një personi në vend të emrit të tij, p.sh.: ai/ajo, atij/asaj, ata.
Homofobia	C	B	Aftësia e një personi për tërheqje të thellë emocionale, afektive dhe seksuale dhe marrëdhënie intime dhe seksuale me të tjerë.
Trans	K	C	Frikë joracionale/neveri ndaj homoseksualizmit dhe personave LGB në bazë të paragjykit.
Interseks (Ndërseksual)	Q	D	Persona, të cilët kanë një identitet gjinor që nuk përkon me seksin e përcaktuar në lindje, dhe e modifikojnë pamjen e tyre trupore apo funksionet e tyre trupore duke bërë operacion për ndryshimin e gjinisë.
Tranzicioni	G	E	Burrë tërheqjet kryesore romantike, emocionale, fizike dhe seksuale të të cilit janë përkundrajt burrave.
Stereotipet	N	F	Zgjedhjet që bëjmë në përditshmëri se çfarë veshim dhe si vishemi dhe sillemi që tregojnë gjininë tonë.
Identiteti gjinor	L	G	Proces i ndryshimit social, ligjor dhe/ose mjekësor që përfshin, ndër të tjera, pamjen fizike, veshjen dhe marrëdhëniet shoqërore.
Biseksual	M	H	Trajtim i pajustificuar, i pabarabartë.
Lezbike	O	I	Persona, të cilët, në aspektin emocional, romantik ose seksual ndiejnë tërheqje/përkushtim ndaj seksit të kundërt.
Përemrat	A	J	Frikë joracionale/neveri për mospërputhjen e gjinisë së personave transgjinorë për shkak të paragjyqimeve.
Transeksual	D	K	Term ombrellë që përdoret për të përmbledhur morinë e mënyrave të ndryshme në të cilat individët mund ta identifikojnë gjininë e tyre që është e dallueshme nga popullsia e përgjithshme.
Orientimi seksual	B	L	Ndjësia e brendshme e një individi e të qenit i gjinisë mashkullore, femërore apo i një gjinie tjetër.
Gej	I	M	Person, i cili ndien tërheqje të konsiderueshme romantike, emocionale, fizike dhe seksuale ndaj pjesëtarëve të të dy sekseve.
Transfobia	J	N	Një përgjithësim i paragjykuar ose i tejthjeshtëzuar për një grup të tërë personash pa marrë parasysh dallimet e tyre individuale.
Shprehja e gjinisë	F	O	Grua tërheqjet kryesore romantike, emocionale, fizike dhe seksuale të së cilës janë ndaj grave.
Homoseksual	E	P	Përcaktime, si: mashkull/femër ose z./znj., që gjenden normalisht në dokumentet e identitetit.
Treguesi i gjinisë	P	Q	Person i lindur me veçori fizike, hormonale ose gjenetike që nuk janë tërësisht femërore, as tërësisht mashkullore; një ndërthurje e mashkullores dhe femërores; ose as femër, as mashkull.

AKTIVITETI 2.6: PËRCAKTONI PËRMBAJTJEN E LEGJISLACIONIT KOMBËTAR MBI KRIMET E URREJTJES (30 MINUTA)

Materialet e nevojshme:

Letër dhe stilolapsa

Në këtë aktivitet, grupit i caktohet detyrë që të diskutojë për legjislacionin vendas mbi krimin për shkak të urrejtjes, dhe të tregojë perceptimin që ka si përpilohet legjislacioni. Pjesëmarrësit do të pyeten nëse kanë patur përvojë për sa i takon hetimit të krimeve të urrejtjes, dhe si kanë funksionuar në praktikë hetimi dhe ndjekja penale. Duhet hulumtuar këto fusha:

- ▶ Çfarë lloj ligji (rritje e masës së dënimit specifik, rritje e dënimit të përgjithshëm, vepër specifike kriminale)?
- ▶ Cilat janë karakteristikat e mbrojtura?
- ▶ Çfarë politike ndjek policia për hetimin e krimeve për shkak të urrejtjes?
- ▶ Çfarë roli luani ju si hetues?
- ▶ Çfarë roli luan prokurori, siç e kuptoni ju?
- ▶ Çfarë roli luan gjyqësori, siç e kuptoni ju?
- ▶ Çfarë përvoje keni patur ju deri më sot lidhur me legjislacionin?
- ▶ A e konsideroni efektiv?

LEGJISLACIONI DHE KONTEKSTI I SHQIPËRISË PËR MBROJTJEN E PERSONAVE LGBTI NGA KRIMET E URREJTJES DHE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË ORIENTIMIT SEKSUAL DHE IDENTITETIT GJINOR (OSIGJ)⁴²

Legjislati shqiptar ndër vite ka ardhur duke u përmirësuar dhe përafuar gjithnjë e më shumë me standardet ndërkombëtare të OKB-së dhe të Këshillit të Evropës. Një sërë ligjesh të reja, ndër të tjera, po i garantojnë të drejtat e barabarta komunitetit LGBTI, të cilat po zgjerojnë edhe fushën e zbatimit të ligjeve penale apo civile për eliminimin e diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe/apo identitetit gjinor (OSIGJ).

Pavarësisht se realiteti për shumë persona LGBTI është i vështirë dhe ata përballen me dhunë në familje, në rrethin e ngushtë shoqëror, me nofka, sharje dhe diskriminim të hapur apo të tërthortë në jetën e përditshme, është përgjegjësi e organeve ligjzbatuese në Shqipëri që të trajtojnë çdo ankesë apo denoncim të bërë nga ana e personave LGBTI me profesionalizëm dhe përgjegjësinë që kërkohet dhe pritet nga punonjësit e policisë.

Policia përballlet me komunitetin LGBTI, ashtu si me çdo komunitet tjetër shoqëror, në dy momente kryesore. Momenti i parë është kur një individ LGBTI vjen të ankohet pranë një komisariati apo punonjësit policie për një vepër penale të ndodhur ndaj tij/saj – dhe ku kërkohet që policia të ndërmarrë një sërë hapash specifike për të hetuar krimin e ndodhur. Kjo pjesë e punës së policisë është e lidhur me zbatimin e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale si dhe sipas rastit Ligjit për Policinë e Shtetit.

Ndërkohë që momenti i dytë, është kur vetë Policia e Shtetit, si institucion, dhe stafi i saj përballen me akuza për dhunë, diskriminim dhe shkelje të ligjit përkundrejt individëve apo komunitetit LGBTI. Policia është një institucion që rregullohet nga ligjet dhe procedurat e saj të veçanta, si p.sh. Ligji për Policinë e Shtetit, por në të njëjtën kohë, janë edhe një sërë ligjesh të tjera që mund të merren në konsideratë dhe që kanë ndikim në mbrojtjen e policisë nga sjellja e papërshtatshme apo e paligjshme e punonjësve, siç mund të jetë Kodi Penal, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Masat e Mbrojtjes të Dhunës në Familje, Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve etj.

Sjellja dhe bashkëpunimi midis policisë dhe komunitetit LGBTI në Shqipëri ndër vite ka ardhur duke u përmirësuar dhe forcuar, megjithatë nuk përjashtohen asnjëherë rastet kur punonjësi i policisë mund të mbajë qëndrime paragjyquese, diskriminuese ose përjashtuese ndaj personave LGBTI. Në këtë kuadër qëllimi i këtij manuali trajnimi dhe i kontekstit ligjor të vendit, është që t'i ndihmojë punonjësit e zbatimit të ligjit, të kenë një kuptim sa më të mirë të ligjeve kryesore që kanë të bëjnë me krimet e urrejtjes dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Kushtetuta e Shqipërisë

Kushtetuta, në një sërë dispozitash të saj, synon nxitjen e respektimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Neni 18 i dedikohet në mënyrë specifike sanksionimit të parimit të mos-diskriminimit dhe barazisë përpara ligjit për të gjithë shtetasit. Ndonëse Kushtetuta nuk parashikon shprehimisht orientimin seksual dhe identitetin gjinor si shkaqe për mbrojtjen nga diskriminimi, përsëri ligjvënësi e ka përfshirë çështjen OSIGJ tek gjendja sociale, si një ndër shkaqet që Kushtetuta ofron mbrojtje të posaçme.

Neni 18 i Kushtetutës

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Ajo çka është e rëndësishme të thuhet në lidhje me Nenin 18 të Kushtetutës është:

- ▶ Të gjithë individët në sytë e ligjit dhe institucioneve të zbatimit ligjit janë të barabartë dhe ligji i mbron të gjithë qytetarët e vendit pa përjashtim;
- ▶ Askush nuk mund të diskriminohet apo vendoset në një situatë më pak të favorshme apo përjashtuese krahasuar kjo me individët e tjerë, pavarësisht shkaqeve dalluese të tyre apo të perceptuara si të tilla.

42. Kjo pjesë e Manualit të Trainimit është përgatitur nga Av. Altin Hazizaj, Ekspert Kombëtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi për shkak të OSIGJ

- ▶ Kushtetuta rikonfirmon atë çka konsiderohet si “diskriminim pozitiv”, pra mbrojtja e posaçme apo mbështetja e përligjur që mund t’i jepet një apo disa grupeve specifike të shoqërisë, si një mjet për të nxitur arritjen e barazisë me pjesën tjetër të shoqërisë (p.sh. dhënia e bursave për studentët e ekselencës, vendosja e kuotave gjinore në politikë apo kuotave për pjesëmarrjen e minoriteteve në vendim-marrjen lokale etj.,,).

Kodi Penal

Kodi Penal i vitit 1995 solli një ndryshim pozitiv në drejtim të dekriminalizimit të marrëdhënieve seksuale në seks të njëjtë si dhe mbrojtjes së individëve nga krimet e urrejtjes. Falë mbështetjes së ekspertëve të Këshillit të Evropës, Shqipëria më së fundi, e solli legjislacionin e saj penal në vijë me atë të shteteve të tjera evropiane, ku qenia LGBT nuk ishte më një subjekt i veprës penale.

Megjithatë duhet thënë se deri në vitin 2013 mbrojtja nga krimet e urrejtjes nuk u shtri në drejtim të mbrojtjes edhe të komunitetit LGBTI. Mungesa e informacionit, paragjykimet dhe vizibilitetit të komunitetit LGBTI deri në atë kohë, i bënte veprat penale ndaj individëve LGBTI shpesh të padukshme apo të pakapshme nga sistemi i drejtësisë, për shkak të mos-raportimit të tyre si të tilla.

Falë mbështetjes së Avokatit të Popullit dhe organizatave LGBTI në Shqipëri, ndryshimet që iu bënë Kodit Penal nga Kuvendi i Shqipërisë, e shtrinë mbrojtjen e tyre, ndër të tjera, tek krimet e urrejtjes (në dy nene), dhe tek rrethanat rënduese të veprës penale. Më poshtë do të gjejmë një prezantim të normave dhe koncepteve të reja që u bënë pjesë e Kodit Penal.

Neni 50 i Kodit Penal: Rrethanat rënduese

Rëndojnë dënimin rrethanat që vijnë (germa J e ndryshuar vijon si më poshtë):

j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.

Neni 50 i KP paraqet një rëndësi të posaçme për punonjësit e zbatimit të ligjit, pasi ndër të tjera, kërkon që Gjykatësit të mbajnë parasysh gjatë dhënies së dënimit edhe faktorët dhe shkaqet që kanë shpënë në kryerjen e veprës penale, për shkak të karakteristikave apo përkatësisë së viktimës së veprës dhe që rëndojnë pozitën e autorit të krimit. Këto karakteristika të viktimës ndër të tjera përfshijnë edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Neni 50 paraqet rëndësi për punonjësit e policisë dhe të prokurorisë si gjatë intervistimit të viktimës që i ka mbijetuar veprës penale, dëshmitareve, ashtu edhe gjatë mbledhjes së provave materiale, për të vërtetuar rrethanat dhe motivet në të cilat ka ndodhur krimi dhe nëse karakteristikat e viktimës kanë qenë faktor vendimtar apo ndikues në ngjarjen kriminale.

Nuk duhet neglizhuar fakti që viktimat e krimeve të urrejtjes mund të mos jenë në dijeni të faktit që ligji penal u jep atyre mbrojtje të posaçme dhe se karakteristikat apo përkatësia e tyre (p.sh. qenia aktiviste/e pranë një organizate LGBTI) janë të rëndësishme për dënimin e veprës penale. Po ashtu mund të ndodhë që viktimat të mos duan të identifikohen bazuar tek karakteristikat e tyre, sidomos kur ato përbëjnë një shkak për diskriminim apo paragjykime shoqërore. Në këtë kuadër merr rëndësi edhe informimi i viktimës apo viktimave për hapësirat që ligji penal iu njeht atyre në lidhje me rrethanat rënduese të veprës penale.

Neni 253, Shkelja e barazisë së shtetasve

Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Neni 253 ishte neni i dytë që u amendua nga Kuvendi, për të përfshirë ndër të tjera edhe diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetin gjinor. Neni ndjek të njëjtën linjë të Nenit 18 të Kushtetutës, ku garantohet barazia e shtetasve përpara ligjit dhe mos-diskriminimi. Në kuptimin e tij të gjerë neni kërkon të parandalojë sjelljen apo qëndrimet kriminale që vijnë nga ana e punonjësve me funksione shtetërore, por pa përjashtuar edhe ata që i përkasin sferës private të të drejtës, por që ofrojnë shërbime publike.

Pritshmëria e normës penale, sipas Nenit 253 është:

- ▶ Eliminimi i pabarazisë midis individëve të cilët vendosen në kontakt me punonjësit me funksione shtetërore ose me shërbimet publike;
- ▶ Punonjësit duhet të jenë duke ushtruar detyrën e tyre;
- ▶ Bërja e dallimit midis dy qytetarëve me të drejta të njëjta, të cilët kërkojnë të njëjtin shërbim nga i njëjti punonjës, për shkaqet e parashikuara më sipër;
- ▶ Pasoja e veprës penale është krijimi i privilegjeve të padrejta ose refuzimi i një të drejte ose përfitimi të njohur nga ligji ndaj një personi për shkaqet e përmendura më sipër, i cili mund të jetë ose përfitues ose kërkues i refuzuar i një të drejte;

Neni 265 - Nxitja e urrejtjes ose grindjeve

Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.

Ligjvënësi shqiptar i ka kushtuar një rëndësi të posaçme mbrojtjes së individëve nga krimet e urrejtjes, të cilat nuk përfshijnë vetëm aktin e të folurit i cili nxit urrejtjen apo shkakton grindje ndërmjet grupeve shoqërore, por njëkohësisht edhe përgatitjen, përhapjen apo ruajtjen e informacionit të shkruar.

Neni 265 merr në konsideratë se format e përhapjes së informacionit (në formën e shkrimeve) janë nga më të ndryshmet, si nëpërmjet medias së shkruar apo edhe në rrjete sociale në internet (online) dhe në këtë aspekt fjalët “me çdo mjet ose formë” nënkuptojnë të gjitha mjetet që një individ mund të përdorë për të nxitur urrejtje dhe grindje.

Në ndryshim nga nenet e tjera të Kodit Penal, të përmendura më sipër, ligjvënësi ka lënë jashtë efektit të mbrojtjes nga krimet e urrejtjes personat transgjinorë, gjë që në fakt përbën një shkak për t’u shqetësuar. E fundit, krimet e urrejtjes, nuk duhen parë asnjëherë të ndara nga vepra të tjera penale që lidhen me të, si p.sh. rrahja, plagosja, vrasja etj. si dhe me Nenin 50 të Kodit Penal që ka të bëjë me rrethanat rënduese të veprës.

RAST STUDIMOR 1 : GJUHA E URREJTJES NË MEDIA

Në Maj 2014, një nga gazetat kryesore në vend, boton një letër të hapur të 57 intelektualëve në Shqipëri, të cilët të frikësuar nga nismat dhe përpjekjet e komunitetit LGBTI për barazi dhe respekt, i shihnin ato si një rrezik për konceptin tradicional të familjes shqiptare.

Letra vijonte:

“Jo shkatërrimit të familjes shqiptare!

Jo gjesteve që inkurajojnë cenimin e unitetit të familjes dhe shoqërisë!

Jo përkrahje publike modeleve që e shndërrojnë shoqërinë tonë në Sodomë dhe Gomorrë! Sepse familja është embrioni i çdo shoqërie dhe i çdo qytetërimi. Familja është shoqëria në miniaturë. Familja fillon me fëmijët. Familja është mjedisi i parë, ku njeriu duhet të mësohet të krijojë mirësi. Paprekshmëria e familjes garanton sigurinë e shoqërisë së madhe njerëzore. Çdo doktrinë sociale, që përpiqet të rrenojë familjen është e papranueshme dhe përveç kësaj, e pazbatueshme. Të rritesh në një familje vërtet të shëndetshme – ky është sukcesi i sukseve. Vartësia e jetës familjare e bën më të moralshëm njeriun. Një popull që nuk duron padrejtësitë në jetën familjare, nuk mund t’i kryejë ato në jetën shoqërore. Sepse familja është kristali i një shoqërie....

Pavarësisht se letra nuk përmendte komunitetin LGBTI në mënyrë të posaçme, autorët e letrës dhe media e bënë të qartë qëndrimin e tyre se ajo i drejtohej lëvizjes dhe komunitetit LGBTI.

Ambasada PINK, një ndër organizatat LGBTI, u ankua pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar konsiderimin e letrës si një mjet të përhapjes së gjuhës së urrejtjes. Pas më shumë se një viti, Prokuroria e Tiranës njoftoi Ambasadën PINK se nuk kishte gjetur elemente të veprës penale të nxitjes së urrejtjes në letrën në fjalë. Ankesa ishte një ndër rastet e para kur komuniteti LGBTI kërkonte veprimin e ligjit për krimet e urrejtjes në Shqipëri.

RAST STUDIMOR 2 : GJUHA E URREJTJES DHE QËNDRIMET DISKRIMINUESE NDAJ KOMUNITETIT LGBTI NGA NJË ZYRTAR PUBLIK.

Rasti më flagrant i diskriminimit dhe shprehjes së homofobisë ndaj komunitetit LGBT në vend gjatë vitit 2012, ishte deklarata e zv. Ministrit të Mbrojtjes z. Ekrem Spahia, e datës 23 Mars 2012 në gazetën Shqiptare dhe disa të përditshme të tjera, ku thuhej se komuniteti LGBT nëse do të dilte në manifestime publike do të "kapej në hu", në të cilën ka përdorur hapur gjuhën e urrejtjes dhe nxitjen e homofobisë.

Ambasada PINK reagoi menjëherë përmes një deklaratë dërguar Kryeministrit të vendit, z. Sali Berisha, ku i kërkohej të merreshin masa të menjëhershme distancimi ndaj qëndrimit të zv.ministrit të Qeverisë së tij.

Menjëherë pas deklaratës së PINK, Kryeministri në një koment të tij në mbledhjen e grupit parlamentar të PD-së, tha se deklaratat e zv.Ministrit të Mbrojtjes, Ekrem Spahiu, janë të papranueshme dhe nuk tregojnë qëndrimin zyrtar të Qeverisë.

Ndërkohë Ambasada PINK reagoi gjithashtu përmes debateve në medien e shkruar dhe atë elektronike. Me iniciativën e PINK u organizua edhe tryeza e rrumbullakët e shoqërisë civile në bashkëpunim me grupimet LGBT në vend, dhe me pjesëmarrjen e organizatave dhe institucioneve të të drejtave të njeriut, nga e cila dolën një sërë rekomandimesh që duhet të zbatohen për respektimin e komunitetit LGBT në vend.

LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI⁴³

Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" përbën një moment të rëndësishëm në zhvillimin e legjislacionit të ri në Shqipëri. Ai përfaqëson një arritje të përbashkët ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile, për të bërë të mundur mbrojtjen e të drejtave të çdo personi pa diskriminim. Ligji është një iniciativë e shoqërisë civile në Shqipëri gjatë vitit 2006 dhe vetëm në vitin 2010, Kuvendi i Shqipërisë ra dakord që të punonte me OJF-të për të bërë të mundur diskutimin dhe miratimin e Ligjit. Në shkurt të vitit 2010, Kuvendi votoi unanimisht miratimin e ligjit, i cili është një ndër normat më moderne në legjislacionin shqiptar, por dhe atë Evropian.

Ligji përbën një risi edhe për personat dhe komunitetin LGBT, pasi për herë të parë në një ligj përmenden orientimi seksual dhe identiteti gjinor si shkaqe të diskriminimit. Ligji përmban një listë jo shteruese shkaqesh, për të cilat ofron mbrojtje nga sjellja diskriminuese, dhe parashikon shprehimisht mes tyre edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Gjithashtu ligji jep përkufizimet e një sërë konceptesh të rëndësishme si diskriminim i drejtpërdrejtë, diskriminim i tërthortë, diskriminim për shkak të shoqërimit, viktimizimi, etj.,

Më poshtë po japim një paraqitje të neneve kryesore të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe disa prej koncepteve të reja që u bënë pjesë e legjislacionit shqiptar, nëpërmjet këtij ligji.

Në Shqipëri ligji ndalon çdo formë të diskriminimit!

Në zbatim të nenin 18 të Kushtetutës, Neni 5 i Ligjit shprehet qartë se në Shqipëri ndalohet çdo formë e diskriminimit, me përjashtim të rasteve të përligjura me ligj (psh. diskriminimi pozitiv).

Neni 5 - Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mos-marrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Shkaqet që përbëjnë diskriminim

Neni 1 përcakton në mënyrë jo shteruese shkaqet për të cilat një person mund të diskriminohet dhe për të cilat ligji ofron mbrojtje dhe dëmshpërblim të dëmit të shkaktuar. Kur themi jo shteruese, kemi parasysh që ligjvënësi ka lënë hapësirë në nenin 1 që pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit, mund të dalin edhe shkaqe të tjera për të cilët qytetarët mund të diskriminohen. Për këtë arsye fjalët "çdo shkak tjetër" duhen të kuptohen si shkaqe joshteruese të shkeljes së ligjit nga forma të reja të diskriminimit.

43. Ligji Nr.221/10, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"

Neni 1- Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Ashtu siç shihet edhe në përkufizimet e Nenit 1, ligji mbron të gjithë individët dhe të gjitha kategoritë kryesore të popullsisë, të cilat kanë tipare, përkatësi apo karakteristika dalluese dhe të cilat përbëjnë një shkak për t'u diskriminuar.

Qëllimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi

Ligjvënësi e ka përcaktuar qartë se cilat janë qëllimet e ligjit (Neni 2):

- ▶ barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- ▶ barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- ▶ mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Çfarë është diskriminimi?

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi e përcakton diskriminimin, si më poshtë (Neni 3 / paragrafi 1):

Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Nëse mund të identifikojmë disa nga aspektet kryesore të nenit mund të themi se diskriminimi është:

- ▶ Dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë e një personi përkundrejt një tjetri;
- ▶ Shkaqet e këtij dallimi, përjashtimi etj., janë jo shteruese dhe të përcaktuara në Nenin 1 të ligjit;
- ▶ Qëllimi është krijimi i kushteve që personi ose një grup personash (një komunitet i caktuar) të pengohen apo të mos ushtrojnë të drejtat dhe liritë e njohura nga korpusi i ligjeve në Shqipëri;
- ▶ Kjo kërkon që veprimet ose mos-veprimet e personit që ushtron diskriminimin të jenë të qëllimshme;

Ndërkohë që personi që diskriminon mund të jetë person fizik ose juridik, privat ose publik.

RAST STUDIMOR 3: DISKRIMINIM I DREJTPËRDREJTË I KOMUNITETIT LGBTI NGA ZYRTARËT PUBLIKË.

Në emisionin "Debati në Channel One" të datës 21.03.2013, transmetuar në televizionin me të njëjtin emër, me temë "Pedofilia në Shqipëri", u diskutua lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, duke marrë shkas nga ngjarja e ndodhur në Qytetin e Tiranës, ku një fëmijë është zhdukur dhe një tjetër është dhunuar seksualisht. Në këtë emision ishin të ftuar gazetarë, analistë dhe politikanë. Ndër të ftuarit në këtë emision ishte dhe z. Ekrem Spahia, politikan, aktualisht Kryetar i Partisë Lëvizja e Legalitetit dhe Zv/Ministër i Mbrojtjes.

Në një analizë që z. Spahia u bën shkaqeve që kanë çuar në një situatë të tillë, shprehet ndër të tjera për "ato e ngrenë zërin duke ndihmuar edhe media, për një kategori që kërkojnë të na e imponojnë si një vlerë për shoqërinë shqiptare, siç janë homoseksualët dhe merren më shumë me ata, dhe nuk merren pikërisht me fëmijët që ata janë krejtësisht pasojat e kësaj lirie që kërkojmë" ose "OJQ-të, po pikërisht ato stimulojnë atë kategori njerëzish që çojnë në këto krime monstruoze dhe prandaj ne jemi kategorikisht kundër tyre, ato kanë një tendencë që të bëjnë sa më shumë, më falni se ne na vjen zor qoftë me e përmend....., jo më ta aplikojmë, të bëjmë sa më shumë homoseksualë. Dhe atëherë kjo është tendenca e tyre t'i mashtrojnë fëmijët me pare, se kanë para ato.....Pra gjëja më pavlerë në shoqërinë njerëzore, kërkojnë të na e imponojnë, na kundërvihen se është një civilizim dhe është njeri modern ai që qenka homoseksual. Dhe kujt t'u drejtohen këta fëmijë, te ata njerëz që duan të shtojnë radhët e tyre dhe të na i nxjerrin nëpër bulevardet e Tiranës".

Pas këtij transmetimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bazuar në nenin 32/1/c të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: "Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji", nenin 46 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: "Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara, Komisioneri me urdhrin nr. 37, datë 05.04.2013, filloi procedimin administrativ kundër z. Ekrem Spahia, i ftuar në këtë emision.

Pas procedimit KMD vendosi se Deklaratat e z. Ekrem Spahia janë diskriminim i drejtpërdrejtë pasi ato paragjykojnë dinjitetin dhe cenojnë të drejtën për siguri dhe mbrojtjen nga dhuna të personave për shkak të orientimit seksual; Detyrimin e z. Ekrem Spahia, të kërkojë publikisht ndjesë brenda 15 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër personave për shkak të orientimit seksual; Detyrohet z. Ekrem Spahia, që brenda 30 ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi dhe moszbatimin e këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.

Neni 7 - Mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.
2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Cilat janë format kryesore të diskriminimi sipas ligjit shqiptar?

Ligji është thelluar duke përkufizuar dhe përcaktuar disa nga format kryesore të diskriminimit. Më poshtë po japim disa nga format kryesore të parashikuara në ligj (Neni 3, paragrafët 2-6):

"Diskriminim i drejtpërdrejtë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

"Diskriminim i tërthortë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

“Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

“Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përcmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

“Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

RAST STUDIMOR 4: GJUHA E URREJTJES NDAJ KOMUNITETIT LGBTI NGA PARTITË POLITIKE NË SHQIPËRI.

Në maj te vitit 2014 Aleanca LGBT dhe Pro LGBT raportuan pranë Komisionerit Kundër Diskriminimit Ankesën ndaj Aleancës Kuq e Zi, e cila në faqen e saj zyrtare në Facebook kishte postuar mesazhe që nxisnin urrejtje dhe dhunë ndaj komunitetit LGBT.

Pas përfundimit të procedurave hetimore, KMD-a vendosi konstatimin e diskriminimit të Komunitetit LGBT, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, nga Aleanca Kuq e Zi, nëpërmjet postimeve dhe publikimeve të bëra në rrjetin social Facebook gjatë muajit Prill 2014. Njëkohësisht, u rekomandua që përfaqësues të Aleancës Kuq e Zi të kërkojnë publikisht ndjesë brenda 15 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, si dhe në të ardhmen të evitohet përdorimi i gjuhës që shkakton përhapjen, nxitjen e urrejtjes apo të formave të tjera të diskriminimit, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre. Komisioneri vendosi sanksion me gjobë ndaj Subjektit Aleanca Kuq e Zi, për mosdhënie të informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në zbatim të nenit 32/2të ligjit Nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Subjekti politik Aleanca Kuq e Zi e ka ankimuar vendimin e Komisionerit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e cila pas procedimit të çështjes mori vendim në mbështetje të Komisionerit Kundër Diskriminimit.

Cilat janë subjektet që mbron ligji?

Sipas Neni 4, ligji ka si qëllim që të mbrojë subjektet e mëposhtme:

- ▶ Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- ▶ Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.
- ▶ Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ligji ndër të tjera për qëllimet e zbatimit të të tij ngre edhe një autoritet të posaçëm, siç është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Qëllimi i Komisionerit është të hetojë të gjitha ankesat e qytetarëve që janë viktime të diskriminimit. Ankesat mund të bëhen drejtpërsëdrejti nga individit i prekur nga diskriminimi ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij ose një organizate që ka një interes legjitim për çështjen në fjalë.

Barra e provës së diskriminimit për qëllime objektive nuk i është lënë viktimës, por personit që supozohet se ka ushtruar diskriminimin. Qëllimi i ligjit është që ushtruesi i diskriminimit duhet të ketë mjaftueshëm fakte dhe të dhëna, që nuk ka patur për qëllim të diskriminoje dhe duhet ta demonstrojë këtë. Po ashtu vlen të theksohet se në çdo moment të hetimit të një ngjarjeje dhe ankese diskriminuese, pala e akuzuar ka të drejtë që t'i kërkojë falje viktimës, duke pranuar në këtë mënyrë edhe fajin, por gjithnjë duke kërkuar që të eliminoje çdo formë diskriminimi që mund të përsëritet ndaj viktimës. Në çdo moment të hetimit pranë Komisionerit, viktime ka të drejtë t'i drejtohet edhe gjykatës për të kërkuar evidentimin e diskriminimit dhe pagesën e dëmit të shkaktuar apo që ka ndodhur për shkak të diskriminimit, qoftë kjo në arsim, në marrëdhëniet e punës, në shërbime apo në shëndetësi etj.

RAST STUDIMOR 5: MBROJTJA NGA DHUNA NDAJ PERSONAVE LGBTI

Në ankesën e sjellë pranë KMD-së, z. K., parashtron problematikën e tij, duke informuar se, në momentin kur ka dalë nga banesa për të shkuar në mjedisin e punës, është sulmuar nga shtetasi E., i cili ka ushtruar dhunë verbale dhe fizike. I është drejtuar me fjalë fyese për shkak të orientimit të tij seksual. Ditën që ka ndodhur ngjarja, ankuesi ka paraqitur një kallëzim në Komisaratin e Policisë nr.1, Tiranë. Ankuesi kërkon nga Komisioneri t'i vendosë gjobë z. E.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Së pari, pretendimet e paraqitura nga z. K kundër z. E., nuk mund të shqyrtohen nga Komisioneri, pasi bazuar në pikën 1, të nenit 7, të LMD, ky ligj siguron mbrojtje nga diskriminimi nga: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash”.*

Së dyti, lidhur me pretendimin e paraqitur nga z. K se është dhunuar fizikisht nga shtetasi E., Komisioneri vëren se, ushtrimi i dhunës fizike, përbën kundërvajtje penale.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.

LIGJI PËR POLICINË E SHTETIT⁴⁴ DHE RREGULLORJA E POLICISË⁴⁵

Puna e Policisë së Shtetit në drejtim të respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut, përfshi edhe të drejtat e personave LGBTI ka ardhur gjithnjë e duke u përmirësuar. Akademia e Policisë dhe kurset e trajnimit për punonjësit e policisë të të gjitha niveleve, kanë sjellë një hapje të policisë përkundrejt dijeve të reja dhe punës në komunitet. Nëse vite më parë, punonjësit e policisë shiheshin si persona që e përndiqnin komunitetin LGBTI, sidomos personat transgjinjorë apo personat gej në vendtakimet e tyre, falë edhe bashkëpunimit gjithnjë e më në rritje midis organizatave LGBTI dhe Policisë së Shtetit, kjo situatë po vjen gjithnjë e duke u përmirësuar.

Vlen të theksohet fakti që përgjatë 10 viteve të fundit përgjatë organizimit të eventeve publike në mbështetje të komunitetit LGBTI, si Festivale, Marshime Krenarie (Pride), Ecje me Bicikleta etj., puna dhe profesionale e policisë së shtetit ka bërë që këto organizime të kalojnë pa asnjë incident dhe punonjësit e policisë kanë qenë në krah të komunitetit dhe mbështetësve të tyre përgjatë Paradave LGBTI në Tiranë.

RAST STUDIMOR 6: POLICIA E SHTETIT GARANTON MBARËVAJTJEN E FESTIVALIT TË 1-RË TË DIVERSITETIT LGBTI

Tiranë 17 Maj 2012 - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë, Shqipëria organizoi për herë të parë një aktivitet masiv publik në një nga sheshet kryesore të Tiranës, të quajtur “Festivali i Diversitetit”, nën moton: “Bëj Lëvizjen e Duhur. Ngri Flamurin!”

Nën organizimin e Ambasadës PINK dhe pjesëmarrjen e institucioneve publike, atyre në mbrojtje të të drejtave të njeriut, organizatave të shoqërisë civile dhe misionëve diplomatike në vend, “Festivali i 1-rë i Diversitetit” theu tabutë mbi komunitetin LGBT dhe organizimeve të tyre publike.

Festivali u çel zyrtarisht në orën 10:00 pranë sheshit “Vëllezërit Frashëri”. Por përpara hapjes së festivalit, një mini-paradë e paparashikuar u organizua rastësisht, kur përfaqësuesve të Ambasadës Pink, Qeverisë Shqiptare, Ambasadës Holandeze, iu bashkua edhe Avokati i Popullit dhe dhjetëra qytetarë, të cilët ecën përgjatë Bulevardit Dëshmorët e Kombit drejt Sheshit “Vëllezërit Frashëri”, për tu bashkuar me miq e kolegë që prisnin në shesh.

Siguria e Festivalit të Diversitetit u mbështet tërësisht nga Policia e Shtetit, e cila garantoj që ky event i parë publik për të drejtat LGBTI të zhvillohej pa asnjë incident.

44. Ligj Nr. 2014/108 “Për Policinë e Shtetit”

45. Miratuar me VKM nr. 750, datë 16.9.2015, Botuar ne fletoren zyrtare nr. 167, datë 23 Shtator 2015.

RAST STUDIMOR 7: POLICIA E SHTETIT GARANTON MARSHIMIN E 1-RË TË KRENARISË NË SHQIPËRI (PARADA LGBTI)

Viti 2014 – Mbahet Marshimi i Parë i Krenarisë në Tiranë

17 Maj 2014 - Kjo Ditë Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë ishte historike për Shqipërinë dhe qytetarët LGBT. Vendi ishte sot dëshmitar i Marshimit të 1-rë të Krenarisë (PRIDE), me aktivistë dhe mbështetës që ecën me flamurin gjigand të paqes në qendër të kryeqytetit.

Java e Diversitetit, organizuar nga Ambasada PINK, Shtëpia e të Drejtave të Njeriut dhe Open Mind Spectrum Albania ka qenë e mbushur me aktivitete të shumta kulturore dhe sociale që kishin si objektiv ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi këtë tematikë. Por gjithçka kulmoi sot me pjesëmarrjen e shumë njerëzve në marshimin e parë në rrugët e kryeqytetit.

“Thuaj Po Dashurisë” ka qenë slogani i këtij Pride që u shoqërua me Panairin e Diversitetit, si dhe në aktivitetet e tjera kundër homofobisë që u zhvilluan në qytet, ku morën pjesë shumë qytetarë të cilët injoruan shiun e rrëmbyeshëm, orët e pushimit të fundjavës dhe u bashkuan në mbështetje të të drejtës për të dashuruar dhe për tu pranuar.

Ambasada PINK, HRA dhe OMSA falenderuan në mënyrë të posaçme punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilët morën masa për të garantuar jo vetëm sigurinë fizike të të gjithë pjesëmarrësve, por edhe bllokimin e rrugëve, informimin e qytetarëve dhe shoqërimin e Pride nga punonjës të policisë gjatë të gjithë marshimit.

Megjithatë situata jashtë kryeqytetit mbetet ende e brishtë dhe dijet që punonjësit e policisë në Tiranë kanë marrë jo detyrimisht u kanë kaluar punonjësve të niveleve të ndryshme në periferi apo jashtë kryeqytetit. Qëllimi i këtij materiali është që duke ndarë eksperiencat pozitive dhe negative të punës së Policisë së Shtetit dhe punonjësve të saj, të arrijë të fuqizojë sjelljen profesionale të saj në të gjitha nivelet, përfshirë edhe një bashkëpunim gjithnjë e më në rritje midis Policisë dhe organizatave LGBTI. Lista e organizatave që punojnë për Mbrojtjen e komunitetit LGBTI në Shqipëri është një tjetër mundësi e mirë për të hapur një dialog të qëndrueshëm midis tyre.

Ligji për Policinë e Shtetit është norma kryesore Ligjore në vend që rregullon jetën e organizatës së policisë në Shqipëri. Si një ligj specifik, ai ka rëndësi për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, pasi e vendos mbi baza të rregulluara dhe profesionale të gjithë funksionimin dhe punën që duhet të bëjnë punonjësit e saj ndër të tjera për mbrojtjen e qytetarëve nga dhuna, veprat penale në shoqëri apo veprimet e paligjshme të punonjësve të policisë.

Neni 5 i Ligjit të Policisë së Shtetit, garanton ndër të tjera edhe parimin e mos-diskriminimit, si një nga parimet bazë të punës së organizatës së policisë.

Neni 5: Parimet e veprimtarisë

Parimet bazë, në bazë të të cilave udhëhiqet Policia e Shtetit në veprimtarinë e saj, janë: a) ligjshmëria; b) mosdiskriminimi; c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; ç) proporcionaliteti; d) pavarësia operationale; dh) paanshmëria politike; e) integriteti, merita dhe profesionalizmi; ë) transparenca; f) ruajtja e informacionit të klasifikuar; g) kontrolli dhe llogaridhënia.

Në zbatim të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”, gjatë vitit 2015 u miratua edhe Rregullorja e Policisë së Shtetit, e cila ka si “...qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të Policisë së Shtetit; të parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të punonjësit të Policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit; i ecurisë në karrierë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; i vlerësimit të performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe rregullave për disiplinën dhe procedurave që ndiqen në rastin e shkeljeve disiplinore.”

Kreu i dytë i Rregullores u dedikohet tërësisht parimeve të veprimtarisë së policisë së shtetit dhe punonjësve të saj. Çfarë përbën rëndësi për këtë pjesë të Manualit është fakti që ndër shumë parime të funksionimit të saj, Policia e Shtetit merr një rol proaktiv dhe sanksionon në dokumentin e saj bazë të organizatës së policisë, dy parime të rëndësishme: a) Parimin e mbrojtjes së interesave të qytetarëve, dhe b) Barazinë dhe mos-diskriminimin.

Neni 108: Mbrojtja e interesave publike dhe të individit

1. Punonjësi i policisë, në ushtrimin e funksioneve mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese dhe ligjore të individit.
2. Punonjësi i policisë nuk kryen, nxit apo toleron asnjë akt torture, trajtim çnjerëzor ose poshtërues në çfarëdo rrethane.

RAST STUDIMOR 8: DHUNA NË FAMILJE NDAJ NJË ÇIFTI GEJ DHE SJELLJA E PAPËRSHTATSHME NGA ANA E PUNONJËSVE TË POLICISË.

Viti 2011 - Një çift gej në Tiranë raportoi në Ambasadën PINK dhunën dhe diskriminimin që kishin pësuar nga policia dhe të afërmit. Pas një incidenti familjar lidhur me faktin që ishin gej dhe që bashkëjetonin, në rastin që njëri nga vëllezërit e djemve i kishte kërcënuar se do t'i vriste, çifti kishte shkuar në Polici për të bërë denoncim për dhunë në familje.

Sapo shpjeguan situatën ata ishin pritur me të qeshura dhe ofendime nga oficerët e Policisë. Në vend që të merrnin denoncimin dhe të merrnin masat e duhura, Policia e mbajti çiftin dhe për 10 orë të tjera, duke i trajtuar si fajtorë të incidentit. Gjatë gjithë kohës që ishin në rajon janë tallur dhe ofenduar për shkak të orientimit të tyre seksual. Pas marrjes në dijeni të incidentit të tyre Ambasada PINK i dërgoi një letër ankese Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe asistoi çiftin në përgatitjen e dokumentacionit. Ambasada PINK negocioi për ndihmë ligjore falas, për rastin, nga një studio ligjore në Tiranë.

Ndërkohë që Neni 109 i Rregullores ndalet në mënyrë specifike tek barazia dhe mos-diskriminimi, si dy parime bazë të punës së çdo punonjësi të Policisë së Shtetit: Ajo çka vlen të theksohet është fakti se ndër të tjera, neni ndalet edhe tek orientimi seksual apo rrethanat e tjera personale si shkaqe për mbrojtje nga diskriminimi.

Neni 109: Barazia dhe mosdiskriminimi

1. Punonjësi i policisë përmbush detyrat në përputhje me të drejtat themelore të individit. Ai udhëhiqet nga parimi i barazisë, lirisë së mendimit, të shprehjes, të besimit, të grumbullimit paqësor, lëvizjes së lirë dhe të drejtës mbi pronën.
2. Punonjësi i policisë nuk privilegjon apo diskriminon asnjë për shkak të përkatësisë etnike, racore, gjinore, gjuhësore, politike apo çdo bindjeje tjetër, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual apo rrethane tjetër personale.

Policia e Shtetit dhe të gjithë punonjësit e saj kanë një mundësi për ta kthyer organizatën e tyre të policisë në një vend ku të drejtat e njeriut, respekti për të drejtat LGBTI si për komunitetin ashtu edhe për zyrtarë të policisë që janë anëtarë të këtij komuniteti, janë në themel të punës së tyre të përditshme.

Moduli i Tretë: Policimi i krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI – qasja e bazuar tek të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimi

HYRJE DHE HISTORIKU

Ndërsa, shpeshherë, mendohen shumë larg çështjeve të “policimit të vërtetë”, të drejtat e njeriut, në fakt, ndikojnë tek përgjegjësitë kryesore të çdo oficeri të policisë, duke filluar me garantimin e mbrojtjes dhe sigurisë për viktimën deri tek kryerja e hetimeve efektive. Mospërmbyshja e këtyre standardeve mund të ketë pasoja serioze. Viktimat mund të humbasin besimin tek përkushtimi i policisë për t’i mbrojtur ato, autorët e veprave kriminale nuk ndalohen dhe janë të lirë të vazhdojnë të shkelin ligjin, ndërsa shërbimet policore rrezikojnë të përballen me kërkesa ligjore për përfshirje në diskriminim, përfshirë që të gjenden në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Krimet për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI ndodhin në kontekstin e rasteve të përditshme të paragjykitimit dhe diskriminimit. Studimet kanë treguar se personat LGBTI përjetojnë armiqësi dhe ngacmime në publik, dhe përballen me diskriminim në punë, në shkollë dhe kur përpiqen të përdorin shërbimet për strehimin dhe shëndetësinë. Disa persona LGBTI përjetojnë ngacmime, madje, dhunë për shkak të veprimeve të policisë. Këto përvoja ndërthuren dhe krijojnë pengesa që i ndalojnë personat LGBTI të bëjnë kallëzim në polici për krimet e urrejtjes, apo të bashkëpunojnë gjatë hetimeve dhe procedimit të mundshëm gjyqësor. Ndër arsytet e zakonshme për moskallëzim përfshihen: viktimat nuk mendojnë se policia do ta marrë ankesën e tyre seriozisht; përvoja e tyre është se të tilla incidente ndodhin aq shpesh sa për to nuk bëhet kallëzim; apo sepse iu frikësohen pasojave nga ana e autorëve të veprave kriminale.

Kjo do të thotë se, kur hetojnë krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, oficerët e policisë duhet të tregohen shumë të kujdesshëm që të shmangin ri-viktimizimin. Siç e mësuam tek Moduli i Dytë, ndërmarrja e hapave të thjeshtë, për të siguruar që rajonet e policisë dhe personeli të jenë të ndjeshëm nga personave LGBTI, mund rrisë mundësinë që viktimat të ndjehet e sigurt, që të bashkëpunojnë gjatë hetimit dhe gjatë procedimit të mundshëm gjyqësor.

Ky modul parashtron standardet për të drejtat e njeriut, të cilat janë më të përshtatshme për policinë në kontekstin e ndjekjes së krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, dhe përmban ushtrime që mund të përdoren për inkurajimin e oficerëve që të bazohen tek standardet dhe parimet për të drejtat e njeriut si mbështetje në përpjekjet e tyre për hetimin me efektivitet të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI. Prezantimi 3.3b jep një tablo të plotë të standardeve më të rëndësishme ndërkombëtare që lidhen me policimin në mënyrë efektive të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI.

Sipas rastit dhe kur është e mundur, duhen ftuar OSHC-të lokale që të bëjnë prezantime dhe të angazhohen në një dialog konstruktiv me pjesëmarrësit për temën e diskriminimit që përjetojnë personat LGBTI në kontekstin kombëtar. Gjatë gjithë këtij moduli theksohen mundësitë që OSHC-të të japin kontributin e tyre.

REZULTATET E PËRFTUARA NGA TË MËSUARIT

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të ndërgjegjësohen për sa i takon kontekstit më të gjerë të paragjyimit, armiqësisë dhe diskriminimit me të cilat përballen personat dhe komuniteti LGBTI (njohuri); do të identifikojnë pengesat specifike për sa i takon kallëzimit të krimeve të urrejtjes me të cilin përballen komuniteti LGBTI, si dhe përgjegjësitë përkatëse të policisë (aftësi);
- ▶ do të kuptojnë standardet e Këshillit të Evropës dhe standardet e tjera për të drejtat e njeriut që lidhen me ndjekjen e krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, përfshirë vendimet kryesore gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe pse ato janë të rëndësishëm për rolin e pjesëmarrësve (njohuri);
- ▶ do të njihen me shkeljet specifike të të drejtave të njeriut që mund të bëjë policia (aftësi);
- ▶ do të familjarizohen me standardet bazë të Këshillit të Evropës dhe standarde të tjera ndërkombëtare.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE DHE AFATET KOHORE

- ▶ Aktiviteti 3.1: Të kuptuarit e kontekstit më të gjerë të paragjyimit dhe diskriminimit që përjetojnë personat dhe komuniteti LGBTI (30 minuta).
- ▶ Aktiviteti 3.2: Identifikimi i pengesave specifike për sa i takon kallëzimit të krimeve të urrejtjes me të cilat përballen komuniteti LGBTI; leximi i raportit të ADTH-ësë (30 minuta).
- ▶ Aktiviteti 3.3: Të kuptuarit e standardeve kryesore të Këshillit të Evropës, të standardeve të tjera për të drejtat e njeriut dhe standardeve kombëtare që lidhen me ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI; të kuptuarit e vendimeve kryesore gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe pse ato janë të rëndësishëm për rolin e oficerit të policisë (njohuri) (60 minuta).

AKTIVITETI 3.1: TË KUPTUARIT E KONTEKSTIT MË TË GJERË TË PARAGJYKIMIT DHE DISKRIMINIMIT QË PËRJETOJNË PERSONAT DHE KOMUNITETI LGBTI

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme, stilolapsa
Prezantimi 3.1

1. Përpara seancës, përgatitni dy fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme:
 - ▶ një fletë të titulluar: “Përvojat e personave LGBTI për sa i takon paragjyimit dhe diskriminimit” në një tabelë me fletë të lëvizshme me katër kolona: hapësirat publike, shërbimet publike (strehimi, arsimit), private, vendi i punës. Mund të bëni gjithashtu një skicë të kategorive si plan të menduar. Gjëja kryesore është që të jenë katër kategori qartësisht të dukshme, me hapësirë të mjaftueshme për të shtuar fjalë.
 - ▶ një fletë të titulluar: “Përvoja e personave LGBTI lidhur me policinë”.

“Përvojat e paragjyimit dhe diskriminimit të personave LGBTI

Hapësirë publike (në rrugë, në restorante / bare)	Shërbime publike (shëndetësi, strehim, arsim)	Private (jeta familjare)	Vendi i punës

2. Përpara seancës së trajnimit, bëni kërkime për të gjetur prova për sa u takon paragjykimet dhe armiqësinë që kanë përjetuar personat LGBTI në kontekstin/vendin ku zhvillohet seanca e trajnimit. Për shembull, për të gjetur të dhëna mund të bëni kërkime në grupet e faqeve të internetit të TGEU dhe "ILGA-Europe". Gjithashtu, për këto informacione mund të kontaktoni OSHC-të lokale (shih 3.2a më poshtë).
3. 5 minuta: paraqisni aktivitetin duke shpjeguar se personat LGBTI përballen me paragjykimin, armiqësinë dhe diskriminimin në shumë fusha të jetës së tyre. Bëjeni të ditur për pjesëmarrësit se në pjesën tjetër të aktivitetit ata do të studiojnë disa shembuj të këtyre përvojave. Shpjegoni se, për momentin, do të donit që ata të ndajnë me ju idetë që ata kanë lidhur me llojet e armiqësisë dhe paragjykimet me të cilat përballen njerëzit LGBTI. Ndërsa pjesëmarrësit propozojnë shembuj, shënojeni në kolonën e duhur. Nëse askush nuk bën ndonjë sugjerim, filloni duke bërë vetë një a dy sugjerime, duke u kthyer tek diskutimet, sipas rastit. Këtu janë disa shembuj që mund t'i shtoni:

Hapësirë publike (në rrugë, në restorante / bare)	Shërbime publike (shëndetësi, strehim, arsim)	Private (jeta familjare)	Vendi i punës
Të shara; vështrimi ngultas	Bullizmi në shkollë; trajtim i pahijshëm nga ana e profesionistëve në fushën e shëndetit; dëbimi pa të drejtë nga banesa nga pronarët	Kërcënimi për t'i nxjerrë nga shtëpia e familjes; dhunë fizike dhe abuzim nga pjesëtarë të familjes	Tallje; komente të papërshtatshme; mungesë e ngritjes në detyrë

4. Ndajini pjesëmarrësit në grupe të vogla me katër ose pesë vetë. Përpiquni që t'i ndani njerëzit, të cilët zakonisht punojnë së bashku, dhe të siguronit një përzierje të mirë të gjinive, nëse është e mundur.
5. Prezantimin 3.1 shpërndajeni tek çdo grup dhe kërkoni që grupet ta lexojnë dhe ta diskutojnë atë për pak minuta. Kujtojeni që të vijnë të përgatitur për të shtuar çështje të tjera në tabelë.
6. Jepuni grupeve 10-15 minuta kohë që të lexojnë prezantimin dhe të bien dakord se çfarë çështjesh do të shtojnë në tabelë. Kontrolloni grupet për të parë që janë në rrugën e duhur.
7. Bashkoni grupet sërish në seancë plenare dhe kërkoni që të dalin dhe të shtojnë çështjet e tyre në tabelë. Inkurajoni që të bëjnë vizatime ose t'i paraqesin çështjet në mënyra të tjera. Në varësi të sugjerimeve të pjesëmarrësve, pyetini të tjerët që janë të pranishëm se çfarë mendojnë për këto ide.
8. Bëni një përmbledhje të çështjeve kryesore: personat LGBTI përjetojnë paragjykimet dhe diskriminim në gjithë fushat e jetës.
9. Tani vendoseni fletën e dytë të letrës në tabelën me fletë të lëvizshme, përvoja e personave LGBTI lidhur me policinë. Nëse nuk ka asnjë përgjigje, ju mund të bëni këto sugjerime:
 - ▶ Mungesë e ndjekjes së ecurisë të incidenteve për të cilat është bërë kallëzim
 - ▶ Përvoja të ngacmimit nga ana e policisë
 - ▶ Përvoja të diskriminimit gjatë reagimeve të policisë
 - ▶ Përvoja të dhunës, përfshirë aktet e dhunës fizike
10. Mbylleni aktivitetin duke nënvizuar çështjet kryesore dhe shpjegoni se grupi do t'i hulumtojë më gjerë këto çështje në aktivitetin e ardhshëm.

PREZANTIMI 3.1: TË KUPTUARIT E KONTEKSTIT MË TË GJERË TË PARAGJYKIMIT DHE DISKRIMINIMIT QË PËRJETOJNË PERSONAT DHE KOMUNITETI LGBTI

Personat LGBTI përjetojnë armiqësi dhe diskriminim në shumë fusha të jetës së tyre. Talljet me bazë urrejtjen homofobike dhe transfobike janë shumë të zakonshme dhe, shpeshherë, personat LGBTI i vështrojnë ngultas në rrugë. Kjo krijon kontekstin e përvojës së tyre për sa u takon krimeve dhe incidenteve të urrejtjes, përvojë kjo që do të ndikojë tek besimi i tyre se policia do të reagojë në mënyrë korrekte në rastet e krimeve të urrejtjes.

Hidhini një sy kësaj diagrame që ka përgatitur Agjencia për të Drejtat Themelore në studimin më të gjerë në BE të personave LGBT.

https://www.dropbox.com/s/erlrz3fo1l4ppsa/eu-lgbt-survey-infographic_en.jpg?dl=0

Çfarë ju tregon kjo tablo për sa i takon përvojës së personave LGBT lidhur me armiqësinë dhe paragjykimin? Tani lexoni çfarë kanë thënë personat, të cilët morën pjesë në anketim. Si mendoni se ndikojnë këto përvoja tek ndjesitë e mbrojtjes dhe sigurisë së personave LGBT në publik dhe gatishmëria e tyre për të bërë kallëzim për krimet dhe incidentet për shkak të urrejtjes ndaj tyre?

Deklarova publikisht se isha lezbike kur isha 18 vjeç. Rregullat e komunikimit ishin komentet negative dhe talljet, dhe kushdo që bënte ndonjë koment në favor të të drejtave të personave LGBT (apo thjesht respekt) marginalizohej dhe sulmohej. Për mua diskriminimi asnjëherë nuk ka nënkuptuar akte të dhunshme fizike, por përfolje, përjashtim, tallje, dhunë psikologjike, të ndjerit e papërshtatshme, frikë për veten dhe personat përreth: partneren, familjen, miqtë".
(Itali, lezbike, 30 vjeç)

"Është e vështirë në Francë që ta mbash punën pasi punëdhënësi e merr vesh se je gej. Menjëherë konsiderohesh i brishtë".
(Francë, person gej, 33 vjeç)

"Kam punuar 24 vjet në një bankë dhe, drejtorët, të cilët mendonin se, duke u treguar i ndershëm lidhur me seksualitetin tim, nuk duhet të ngrihesha në detyrë, pasi nuk mund të meritoja respekt, më kanë diskriminuar vazhdimisht. Një herë, një punonjës i ri kërkoi që t'ia vinin tavolinën në 'një distancë të arsyeshme' nga e imja, pasi kishte frikë se mund të ushtroja dhunë seksuale ndaj tij. Kërkesa e tij u konsiderua e arsyeshme dhe ma larguan tavolinën. Kur më së fundi më ngritën në detyrë, më urdhëruan që ta mbaja të fshehtë seksualitetin tim".
(Greqi, gej, 53 vjeç)

[Unë dhe partnerja ime] nuk shkojmë nëpër klube nate, kryesisht, sepse duket mjaft e rrezikshme nëse mjedisi nuk është i mirëkuptueshëm ndaj personave LGBT, sidomos, nëse ne të dyja jemi vetëm. Për marrëdhënien tonë nuk flasim hapur me pronarin apo personat që jetojnë afër nesh".
(Slloveni, lezbike, 28 vjeç)

Përshtatja në shkallë vendi

Përfshini të dhëna dhe analiza që janë nxjerrë nga raporte të rëndësishme të vendit për krimin për shkak të urrejtjes, nëse gjenden. Citoni qartë burimin, shoqëruar me hollësi si duhet gjetur publikimi.

AKTIVITETI 3.2: IDENTIFIKIMI I PENGESAVE PËR KALLËZIMIN E KRIMEVE TË URREJTJES ME TË CILAT PËRBALLET KOMUNITETI LGBTI, LEXIMI I RAPORTIT TË FRA-SË

Ky aktivitet përmblendh lexime, diskutimin në grupe të vogla dhe një diskutim me moderator në seancë plenare.

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme, stilolapsa

Prezantimi 3.2

1. Përgatisni dy fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme. Fletën e parë titullojeni: "Arsyet për të mos bërë kallëzim në polici". Fletën e dytë titullojeni: "Çfarë nënkupton kjo për policinë? Çfarë mund të bëhet?"
2. Ndajini pjesëmarrësit në grupe të vogla me 4-5 pjesëmarrës. Përpquni që t'i ndani njerëzit, të cilët zakonisht punojnë së bashku, dhe të siguronit një përzierje të mirë të gjinive, nëse është e mundur.
3. Shpërndajuni prezantimin 3.3 dhe kërkonit që të ndjekin udhëzimet. Jepuni grupeve 10-15 minuta kohë për të lexuar tekstin dhe për të shkëmbyer mendime lidhur me pyetjet për prezantimin.
4. Bashkoni sërish grupet e vogla, duke krijuar kështu grupin e madh. Kërkonit që pjesëmarrësit të ndajnë me të tjerët mendimet e tyre lidhur me raportin e FRA-së. A u befasuan kur panë përqindjen e njerëzve, të cilët **nuk** bëjnë kallëzim në polici për krimet? Cilat mendonin se ishin arsyet që njerëzit nuk bëjnë kallëzim? A mendojnë se kjo pasqyron kontekstin e tyre? Shënoni çështjet kryesore në tabelën me fletë të lëvizshme.
5. Kurt'ua shpjegoni pjesëmarrësve këto pyetje, mos harroni të përmendni se raporti i FRA-së bazohet në studime të mirëfillta që mund të aplikohen në kontekste të tjera. Nëse pjesëmarrësit i kundërshtojnë konkluzionet, pranoni se studimi mund të ketë të meta, porse, gjithsesi, ai mund të zbulojë çështje të rëndësishme që duhen trajtuar kur bëhet fjalë për të kuptuar pse personat LGBTI nuk bëjnë kallëzim për krimet e urrejtjes. Nëse jep kontribut edhe ndonjë OSHC lokale, mbështetuni tek ky kontribut për të evidentuar provat lokale të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI dhe arsyet e tyre për të mos bërë kallëzim.
6. Tani kaloni tek fleta e dytë e tabelës me fletë të lëvizshme dhe kërkonit që grupi të thotë çfarë nënkupton kjo për policinë dhe praktikën e tyre.
7. Mbylleni aktivitetin duke i përmblendhur çështjet kryesore në tabelën me fletë të lëvizshme. Këto mund të rimerren në një moment të dytë gjatë trajnimit.

AKTIVITETI 3.2A: PËRFSHIRJA E OSHC-VE LOKALE NË AKTIVITETET 3.1 DHE 3.2 (FAKULTATIVE)

Përfshirja e OSHC-ve lokale dhe kombëtare në realizimin e aktiviteteve 3.1 dhe 3.2 do ta pasuronte më shumë përvojën e pjesëmarrësve. Merrni në konsideratë që t'i përfshini OSHC-të që të bëjnë një prezantim të kontekstit më të gjerë të paragjyimit dhe diskriminimit që përjetojnë personat dhe komuniteti LGBTI, si dhe të pengesave specifike që vështirësojnë kallëzimin e krimeve të urrejtjes me të cilin përballen komuniteti LGBTI. Gjithashtu, përfaqësuesi (përfaqësuesit) e OSHC-ve mund të bashkë-moderojnë diskutimet në grup dhe të kontribuojnë në diskutim duke dhënë informacionet dhe të dhënat e tyre specifike. Referojuni Modullit të Pestë për një diskutim më të thelluar të këtyre çështjeve.

PREZANTIMI 3.2: IDENTIFIKIMI I PENGESAVE SPECIFIKE PËR SA I TAKON KALLËZIMIT TË KRIMEVE TË URREJTJES ME TË CILIN PËRBALLEN KOMUNITETI LGBTI; LEXIMI I RAPORTIT TË FRA-SË

1. Shpenzoni pak minuta për të lexuar Seksionin 2.3 “Denoncimi i dhunës për shkak të urrejtjes” të raportit të titulluar “Anketimi i personave LGBT në vendet e BE-së – anketimi i personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjinjorë në vendet e BE-së – rezultatet kryesore”, publikuar nga Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore të Njeriut, i vitit 2013.

Raporti shpjegon numrin e viktimave që bëjnë kallëzim në polici për krimet e urrejtjes, dhe parashton arsyet pse viktimat nuk bëjnë kallëzim në polici për krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI.
2. Tani lexoni:

http://www.ilgaeurope.org/sites/default/files/womens_experience_of_homophobia_and_transphobia.pdf

Ky raport evidenton ndikimin e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI – sidomos tek gratë – dhe tregon se ato kanë më pak gjasa që të denoncojnë krimet e urrejtjes. Gjithashtu, raporti tregon se gratë nga grupet e pakicave (minoriteteve) kanë më shumë gjasë që të përjetojnë krime më të dhunshme.
3. Pasi ta keni përfunduar këtë aktivitet, diskutojini mendimet tuaja në grup.
4. Në raportin e FRA-së, cila është përqindja e viktimave që kanë bërë kallëzim në polici për krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI?
5. Cilat kanë qenë arsyet kryesore pse viktimat nuk kanë bërë kallëzim në polici?

ÇFARË NËNKUPTON KJO PËR PUNËN TUAJ?

Si grup, bini dakord për një përmbledhje të mendimeve tuaja që mund t’i ndani me kolegët tuaj kur të ktheheni tek grupi i madh.

AKTIVITETI 3.3: TË KUPTUARIT E STANDARDEVE KRYESORE TË KËSHILLIT TË EVROPËS, TË STANDARDEVE TË TJERA PËR TË DREJTAT E NJERIUT, SI DHE TË STANDARDEVE KOMBËTARE PËR HETIMIN E KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI

Ky aktivitet evidenton nevojën e të qenit në qendër të vëmendjes të detyrimeve për të drejtat e njeriut në praktikën policore. Ai nis me fjalët kyç që, më tej, shpjegohen në leximin e çështjes gjyqësore “Identoba kundër Gjeorgjisë”.

Materialet:

Karton/letër A4

Tabelë me fletë të lëvizshme, letër dhe stilolapsa

Prezantimi 3.3a

Prezantimi 3.3b

Shënim për trajnuesin:

Gjatë përgatitjes për këtë seancë, lexoni me kujdes prezantimin 3.3b që përmban informacion të hollësishëm për vendimet e veçanta gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, standardet e Këshillit të Evropës dhe standarde të tjera ndërkombëtare. Vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhen në mënyrë të posaçme me përgatitjen e kësaj seance.

1. Përpara seancës, shkruajini këto terma dhe fraza në copa kartoni ose letre:

- ▶ *Neni 3, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut*
- ▶ *Neni 14, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut*
- ▶ *Detyrimi pozitiv*
- ▶ *Detyrimi procedural*
- ▶ *Demaskimi i motivit homofobik*

Pastaj shkruajeni çdo term në një copë letër për tabelën me fletë të lëvizshme dhe vendosini letrat përreth dhomës.

2. Në fillim të aktivitetit, shpërndajini copat e letrës me termat që u përmendën. Shpjegoni se këto terma dhe fraza janë me rëndësi kryesore për praktikën e qasjes së të drejtave të njeriut ndaj policimit.
3. Kërkoni nga pjesëmarrësit që t’i lexojnë me zë të lartë termat dhe të japin një ide se çfarë nënkuptojnë ato. Shpjegoni se, në këtë moment, ju nuk kërkoni përgjigje të përsosur, por thjesht ide. Kërkoni një pjesëmarrësi tjetër që t’i shkruajë mendimet e dhëna tek tabela me fletë të lëvizshme. Zhvilloni një diskutim të shkurtër për çdo term, por mos ofroni ende asnjë përkufizim. Shpjegoni se do t’i ktheheni kësaj në fund të seancës.
4. Tani shpërndani prezantimin 3.3 që përmban një përmbledhje të çështjes gjyqësore “Identoba kundër Gjeorgjisë”. Prezantoni këtë pjesë të aktivitetit duke shpjeguar se, ndërsa asgjë në këtë përmbledhje nuk është e pasaktë, synimi nuk është që të jepet një përshkrim shterues i fakteve të çështjes gjyqësore, të ligjeve të Gjeorgjisë apo të ligjit (ligjeve) që mori në konsideratë Gjykata. Çështja është që të analizohet një shembull – ky rastisi që ndodhi në Gjeorgji – dhe të identifikohen parimet e përbashkëta të të drejtave të njeriut që aplikohen për gjithë oficerët e policisë.
5. Jepuni pjesëmarrësve 5-7 minuta kohë që të lexojnë prezantimin 3.3. Thojuni që të kërkojnë termat që sapo keni diskutuar bashkërisht si grup dhe t’i analizojnë sërish përkufizimet.
6. Bashkoni pjesëmarrësit në një grup më të madh dhe filloni një diskutim të përqendruar. Kthejuni përkufizimeve dhe termave që prezantuat në fillim të seancës së trajnimit. Filloni me Nenin 3 të Konventës. Pyetini pjesëmarrësit nëse ende pajtohen me përkufizimin dhe nëse do të donin t’i shtonin ndonjë gjë. Pyetini çfarë nënkupton kjo për praktikën e tyre.
7. Tani flisni për termin “detyrim pozitiv”. Pyeteni grupin çfarë do të thotë ai dhe nëse do të dëshironin t’i shtonin ndonjë gjë përkufizimit. Në këtë diskutim mbështetuni tek ky mendim i ekspertit për sa i takon kuptimin të Nenit 3.

Detyrimi pozitiv që dikton Neni 3 do të thotë se shtetet palë duhet të ndërmarrin masa parandaluese dhe hetimore për çfarëdolloj keqtrajtimi të individëve. Kjo do të thotë se shtetet duhet të sigurojnë mbrojtjen efektive të një individi apo individëve nga aktet kriminale të një pale të tretë, si dhe të ndërmarrin veprime të arsyeshme për parandalimin e keqtrajtimit për të cilin autoritetet kanë njohuri ose duhet të kenë njohuri. Përveç kësaj, shtetet duhet të kryejnë hetime zyrtare efektive të keqtrajtimit të pretenduar, edhe sikur ky trajtim të jetë shkaktuar nga individë privatë.

Shpjegoni se këto detyrime ekzistojnë tashmë për shkak të racës, etnisë dhe besimit fetar.

Tani flisni për **Nenin 14**. Pyesni nëse pjesëmarrësit do të dëshironin që t'i shtonin ndonjë gjë përkufizimit të tyre. Gjatë diskutimit, mbështetuni tek ky përkufizim: Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim bazuar në shkaqe të tilla, si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

8. Tani kaloni tek termi **“demaskimi i motivit paragjykues”** dhe çfarë do të thotë ai për praktikën policore. Kujtojuni pjesëmarrësve se do t'i kthehemi kësaj kur të diskutohet për treguesit e qëndrimeve paragjyquese; shpjegoni çfarë do të thotë kjo për praktikën policore, protokollet dhe trajnimin dhe se kjo është një nga arsyt kryesore pse e bëjmë këtë seancë trajnimi. Në diskutimin tuaj mbështetuni tek mendimi i ekspertit.

Përdorni këtë mendim të ekspertit kur të diskutoni për temën dhe çështjen në fjalë.

Praktika policore: *“Ishte me rëndësi thelbësore që autoritetet vendase përkatëse ta bënin hetimin [...], duke ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm me qëllim demaskimin e rolit të motiveve të mundshme homofobike për ngjarjet në fjalë. Ishte e domosdoshme nevoja për të bërë një hetim të rëndësishëm të diskriminimit në bazë të aktit të dhunës [...], duke patur parasysh, nga njëra anë, armiqësinë ndaj komunitetit LGBT dhe, nga ana tjetër, duke marrë parasysh dukshëm gjuhën homofobike të urrejtjes që kishin përdorur agresorët gjatë incidentit. Gjykata vlerëson se, pa një qasje të tillë të ashpër nga ana e autoriteteve ligjzbatuese, pa dyshim krimet me motive paragjykimi do të ishin trajtuar njëjloj si raste të zakonshme pa të tilla nënkuptime, dhe indiferenca në vijim do të ishte njëjloj si pranim zyrtar apo, madje, miratim i krimeve për shkak të urrejtjes” (paragrafi 77).*

9. Së fundi, kaloni tek diskutimi për detyrimet procedurale. Pyetini pjesëmarrësit çfarë nënkupton kjo në praktikën e tyre. Bëjeni të qartë se, kur në shoqëri ekzistojnë prova të homofobisë dhe dikush viktimizohet në bazë të orientimit të tij seksual, policia ka detyrën që ta hetojë atë dhe ky është elementi procedural i detyrimeve të saj për sa u takon të drejtave të njeriut. Mbështetuni tek ky mendim i ekspertit teksa drejtoni diskutimin.

“Gjuha e Gjykatës është tejet e qartë dhe dërgon një mesazh të fortë e të fuqishëm për të gjithë Shtetet Palë: kur në shoqëri ekzistojnë qëndrime negative ndaj pakicave seksuale dhe ekziston një mundësi e njohur për abuzim homofobik, autoritetet ligjzbatuese kanë ‘detyrimin e ngutshëm pozitiv’ (paragrafi 80) që të mbrojnë individët LGBT. Për më tepër, shtetet kanë detyrimin procedural që të hetojnë urrejtjen homofobike ‘duke vënë një theks të posaçëm tek demaskimi i motivit paragjykues’ (paragrafi 80). Siç është shprehur Gjykata, në rast se shtetet nuk e ndërmarrin këtë veprim, ‘do të ishte e vështirë [...] të zbatoheshin masat me qëllim përmirësimin e policimit të [...] demonstratave paqësore në të ardhmen’ (paragrafi 80)”.

<http://echrso.blogspot.co.uk/2015/05/the-judgment-in-identoba-and-others-v.htm>

10. Së fundi, shpërndajeni prezantimin 3.3b dhe tërhiquni vëmendjen pjesëmarrësve tek informacioni i hollësishëm lidhur me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet e tjera përkatëse ndërkombëtare. Theksoni se këto janë burime të rëndësishme në punën e tyre.

PREZANTIMI 3.3A: PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT (GJEDNJ) “IDENTOBA KUNDËR GJEORGJISË”

Ky prezantim jep një përmbledhje të çështjes gjyqësore “Identoba kundër Gjeorgjisë” për qëllime trajnimi. Për hollësi të plota të çështjes gjyqësore, shkoni tek grupi i faqeve të internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: goo.gl/ddlwPG.

Historiku

Çfarë ndodhi?

Identoba mori leje nga autoritetet gjeorgjiane që, më datë 17 maj 2012, të organizonte në qendër të Tbilisit një paradë paqësore për të përkujtuar Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë. Autoritetet konfirmuan se “do të dislokohehin forca policore me qëllim që parada të zhvillohej në mënyrë paqësore”.

Atë ditë, pjesëmarrësit LGBT të paradës u ballafaquan me “njëqind a më shumë kundër-demonstrues, të cilët ishin veçanërisht agresivë dhe përdornin fjalë fyese”. Agresioni u përshkallëzua kur pjesëmarrësve në paradë iu rrëmbyen dhe u grisën banderolat, filluan t’i shtynin dhe godisnin me grushte dhe, të paktën, një person e qëlluan me shkelma dhe e rrahën. Disa pjesëmarrës të paradës pësuan dëmtime fizike. U bënë kërcënime specifike se pjesëmarrësit e paradës “duhet të digjen derisa të vdesin e të shuhen”.

Kur pjesëmarrësit e paradës u ballafaquan me kundër-demonstruesit, policia, “befas, u distanca nga vendngjarja”. Policë të tjerë në vendngjarje u thanë pjesëmarrësve LGBT të paradës se nuk e kishin për detyrë që të ndërhnin, pasi nuk ishin pjesë e patrullës policore. Pas telefonatave të pjesëtarëve të paradës, mbërritën forca të tjera policie, që ndërhnë për të ndaluar rrahjet, por kërcënimet vazhduan. Policia arrestoi disa pjesëmarrës të paradës LGBT. Sipas vendimit gjyqësor të Gjykatës, kjo u bë me qëllim “për t’i penguar se mos bënin ndonjë shkelje administrative – bllokimin e qarkullimit në rrugë – dhe për t’i mbrojtur nga dhuna e kundër-demonstruesve”.

Pas ngjarjes

Palët kërkuese bënë disa ankesa të hollësishme lidhur me dhunën që kishte ndodhur ndaj tyre dhe mungesën e masave mbrojtëse nga ana e policisë (shih paragrafët 20-28).

Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Konteksti i homofobisë dhe armiqësisë

Në pjesën shpjeguese të vendimit të saj gjyqësor në favor të palëve kërkuese, Gjykata u mbështet tek provat e homofobisë dhe qëndrimet negative ndaj personave LGBT në Gjeorgji. Këto prova bazoheshin tek një vizitë që Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut bëri në Gjeorgji, dhe tek provat e siguruar nga Shoqata Ndërkombëtare Evropiane për Personat Lezbike, Gej, Biseksualë, Transgjjinorë dhe Intersex (“ILGA-Europe”). Gjykata erdhi në përfundimin se sfondi i qëndrimeve negative në “disa pjesë të shoqërisë gjeorgjiane” i bënte “veçanërisht të dukshëm nënkuptimet diskriminuese të incidentit të datës 17 maj 2012 dhe nivelin e cenueshmërisë së palëve kërkuese, të cilët, publikisht, u pozicionuan me grupin e synuar të paragjykitimit seksual...” (paragrafi 68). Kjo, bashkë me mungesën e mbështetjes së policisë gjatë paradës, bënte që Gjykata të arrinte në konkluzionin “se trajtimi i palëve kërkuese domosdoshmërisht duhet të ketë shkaktuar tek ata ndjenjat e **frikës, angësisë dhe pasigurisë**, që ishin **të papajtueshme** me respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor dhe **arritën pragun e ashpërsisë në kuptimin e Nenit 3 marrë bashkërisht me Nenin 14 të Konventës”.**

Policia nuk ofroi mbrojtje

Së dyti, Gjykata vlerësoi se autoritetet vendase kishin dijeni ose duhet të kishin patur dijeni për risqet si pasojë e kësaj ngjarjeje, “dhe, rrjedhimisht, kishin detyrimin që të siguronin **më shumë** mbrojtje si shtet” (paragrafi 72). Sidoqoftë, Gjykata erdhi në konkluzionin se policia “nuk arriti t’u sigurojë trembëdhjetë palëve individuale kërkuese mbrojtje të përshtatshme nga aktet e dhunës me motive paragjykuese ndaj individëve privatë gjatë paradës së datës 17 maj 2012” (paragrafi 74).

Mungesa e një hetimi efektiv

Ndonëse autorët e veprave penale ishin kapur në video dhe viktimat kishin pësuar plagë, autoritetet, “në mënyrë të pashpjegueshme, e ngushtuan objektin e hetimit dhe hapën dy çështje të veçanta dhe të shkëputura lidhur me plagët fizike që u ishin shkaktuar vetëm dy palëve individuale kërkuese” (paragrafi 75). Përveç kësaj, hetimi kishte zgjatur mbi dy vjet dhe, në kohën që u dha vendimi gjyqësor, autorëve të veprës penale iu dhanë vetëm gjoba të vogla administrative.

Autoritetet nuk nisën **hetim mbi krimin për shkak të urrejtjes dhe** as nuk zbatuan ligjet ekzistuese të Gjeorgjisë mbi krimet e urrejtjes. Duke patur parasysh rrethanat e çështjes gjyqësore dhe faktin që Gjeorgjia nuk ka ligje mbi krimet e urrejtjes, Gjykata vlerësoi se:

“Ishte me rëndësi thelbësore që autoritetet vendase përkatëse të bënin hetime në atë kontekst specifik, duke ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm me qëllim **demaskimin e rolit të motiveve të mundshme homofobike për ngjarjen në fjalë**. Ishte e domosdoshme nevoja për të bërë një hetim të rëndësishëm të diskriminimit në bazë të aktit të dhunës ndaj paradës së datës 17 maj 2012, duke patur parasysh, nga njëra anë, armiqësinë ndaj komunitetit LGBT dhe, nga ana tjetër, duke marrë parasysh gjuhën dukshëm homofobike të urrejtjes që kishin përdorur agresorët gjatë incidentit. **Gjykata vlerëson se, pa një qasje të tillë të plotë nga ana e autoriteteve ligjzbatuese, pa dyshim krimet me motive paragjykimi do të ishin trajtuar njëjloj si çështje të zakonshme gjyqësore pa këto nuanca, dhe indiferenca, që do të rezultonte, do të ishte njëjloj si të ishte pranim zyrtar apo, madje, miratim i krimeve për shkak të urrejtjes**”.

PREZANTIMI 3.3B: STANDARDET E KËSHILLIT TË EVROPËS DHE NORMAT TË TJERA NDËRKOMBËTARE

Standardet e Këshillit të Evropës

Dokumente informuese të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Këto burime sjellin çështje dhe vendime gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që pasqyrojnë gjithë aspektet e Konventës. Më poshtë jepet një përmbledhje e dokumenteve informuese më specifike.

“Çështje të orientimit seksual”⁴⁶

Ky dokument informues jep një përmbledhje të përditësuar të të gjitha çështjeve gjyqësore në të cilat shqyrtohen reagimet e agjencive të ndjekjes penale kundër incidenteve të krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes ndaj komuniteteve LGBTI në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Jepen informacione të tjera për çështjet gjyqësore të “Identoba kundër Gjeorgjisë” dhe “M.C. dhe C.A. kundër Rumanisë” që merren në konsideratë në këtë Manual në Modulet Tre dhe Pesë. Përveç kësaj, parashtrohen fakte të dy çështjeve gjyqësore në gjykim kundër Gjeorgjisë dhe Kroacisë.

“Homoseksualizmi: aspekte kriminale”⁴⁷

Ky dokument informues jep një pasqyrë të vendimeve përfundimtare të çështjeve gjyqësore që janë dërguar në gjykatë nga palët kërkuese, të cilat pretendojnë trajtim diskriminues nga ana e shteteve të marrëdhënies ndërmjet personave gej, krahasuar me personat heteroseksualë. Sërisht, këto çështje gjyqësore sqarojnë kontekstin siç është përjetuar nga personat LGBTI, të cilët, shpeshherë, trajtohen si të dyshimtë dhe autorë të veprave penale, në vend që të njihen si viktime të mundshme të krimeve të urrejtjes dhe të veprave të tjera penale.

“Çështje të identitetit gjinor”⁴⁸

Ky dokument informues nuk u referohet rasteve të krimeve të urrejtjes apo trajtimit të personave LGBTI nga ana e policisë; sidoqoftë, vendimet gjyqësore që përmbledh, evidentojnë përpjekjet e personave transgjinorë që identiteti i tyre gjinor të njihet në aspektin ligjor dhe social. Siç hulumtohet në këtë modul, është me rëndësi që të kuptohet konteksti i diskriminimit që përjetojnë personat LGBTI, pasi ai mund të minojë besimin e tyre për të bërë kallëzim në polici për incidentet dhe bindjen e tyre se incidentet kundër tyre do të hetohen me efektivitet.

Rekomandim i Komitetit të Ministrave CM/Rec(2001)10 për Kodin Europian të Etikës së Policisë,⁴⁹ përmbledhje e pjesëve të zgjedhura

Pavarësisht nga larmia e shërbimeve dhe institucioneve policore të pranishme në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Komiteti i Ministrave pranon se një numër normash etike duhet të jenë të përbashkëta në gjithë shërbimet. Kodi parashton standarde të hollësishme që policia duhet t'i përmbushë në përpjekje për realizimin e funksioneve të saj kryesore, që përcaktohen më poshtë:

1. Qëllimet kryesore të policisë në një shoqëri demokratike, ku sundon ligji, janë:

- ▶ të mbajë qetësinë dhe rendin publik në shoqëri;
- ▶ të mbrojë dhe respektojë të drejtat dhe liritë themelore të individit, që garantohen

ndër të tjera, në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

- ▶ të parandalojë dhe luftojë krimin;
- ▶ të zbulojë krimin;
- ▶ të ofrojë funksione të ndihmës dhe shërbimit për publikun.

Në kuadër të trajnimit të policisë, ekziston një lidhje e qartë ndërmjet secilit prej këtyre qëllimeve dhe policimit efektiv, të drejtë dhe të sigurt të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI. Gjatë gjithë Kodit theksohen detyrimet e policisë për “të kryer detyrat e saj në mënyrë të drejtë, të udhëhequr, sidomos, nga parimet e paanësisë dhe mosdiskriminimit”, përfshirë në fushat e mbështetjes dhe ndihmës për viktimat; duke krijuar kulturën e mosdiskriminimit dhe respektimit të drejtave individuale në shërbimet policore; dhe

46. http://www.echr.coe.int/documents/fs_sexual_orientation_eng.pdf

47. http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Homosexuality_ENG.pdf

48. http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Gender_identity_ENG.pdf

49. <http://www.refworld.org/docid/43f5c7944.html>

sidomos, lidhur me mbështetjen e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit për sa u takon të drejtave të garantuara në Konventë.

Rekomandimi CM/Rec(2010)5 i Komitetit të Ministrave për Vendet Anëtare lidhur me masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor⁵⁰.

Ky rekomandim evidenton nenet më të rëndësishme të Konventës dhe konkluzionet kryesore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat lidhen me çështje që cenojnë personat LGBTI. Ndër to përfshihet rëndësia e hetimeve efektive të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI; ligjet specifike dhe ligjet në fuqi që mundësojnë gjykatën të marrë në konsideratë motivin parajgykues kundër personave LGBTI; dhe duke mbrojtur të drejtën për lirinë e shprehjes dhe tubimit, sidomos, të drejtën për mbrojtje kur ushtrohet e drejta për lirinë e tubimit.

Më poshtë janë nenet specifike.

“1. Vendet Anëtare duhet të sigurojnë hetime efektive, të menjëhershme dhe të paanshme të rasteve të krimeve dhe të incidenteve të tjera, kur dyshohet me të drejtë se orientimi seksual apo identiteti gjinor i viktimës ka përbërë një motiv për autorin e veprës kriminale; ato duhet të sigurojnë më tej që t’i kushtohet vëmendje e posaçme hetimit të krimeve dhe incidenteve të tilla, kur thuhet se kryhen nga zyrtarë ligjzbatues apo persona të tjerë që veprojnë në cilësi zyrtare, dhe që ata që janë përgjegjës për të tilla akte t’i dorëzohen efektivisht drejtësisë dhe, sipas rastit, të ndëshkohen me qëllim që të shmanget mosndëshkimi.

2. Vendet Anëtare duhet të sigurojnë që, kur merret vendim për sanksionet, motivi parajgykues lidhur me orientimin seksual apo identitetin gjinor mund të merret në konsideratë si rrethanë rënduese.

13. Vendet Anëtare duhet të marrin masat e duhura me qëllim ushtrimin në mënyrë efektive të së drejtës për lirinë e shprehjes, në përputhje me Nenin 10 të Konventës, pa diskriminim për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor, përfshirë për sa i përket lirisë për të marrë e dhënë informacion për subjektet që merren me orientimin seksual apo identitetin gjinor.

14. Vendet Anëtare duhet të marrin masat e duhura në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal me qëllim ushtrimin në mënyrë efektive të së drejtës së lirisë së tubimit paqësor, që garantohet në Nenin 11 të Konventës, pa diskriminim për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor.

15. Vendet Anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet ligjzbatuese të marrin masat e duhura për të mbrojtur pjesëmarrësit në demonstrata paqësore në favor të të drejtave të njeriut të personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjinorë nga përpjekjet për të ndërprerë në mënyrë të paligjshme ose për të penguar ushtrimin efektiv të së drejtës së tyre të lirisë së shprehjes dhe tubimit paqësor.

17. Autoritetet publike të të gjithë niveleve duhen inkurajuar që të dënojnë publikisht, kryesisht në media, çdo pengesë të paligjshme të së drejtës së individëve dhe grupeve të individëve për të ushtruar lirinë e tyre të shprehjes dhe tubimit paqësor, kryesisht kur lidhet me të drejtat e njeriut të personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjinorë.”

Rezolutë e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës 1728 (2010) “Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”⁵¹

Kjo rezolutë jep një pasqyrë dhe pranon shkallën e diskriminimit që përjetojnë personat LGBT, përfshirë krimin për shkak të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes. Ajo plotëson Rekomandimin CM/Rec(2010)5 të Komitetit të Ministrave për Vendet Anëtare lidhur me masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor që përmendet më sipër. Rezoluta u bën thirrje shteteve anëtare të Këshillit të Evropës që “të sigurojnë që të drejtat themelore të personave LGBT, përfshirë lirinë e shprehjes dhe lirinë e tubimit dhe organizimit, të respektohen në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, dhe “të sigurojnë mjetet ligjore për viktimat dhe t’i japin fund mosndëshkimit për ata, të cilët shkelin të drejtat themelore të personave LGBT, në mënyrë të veçantë, të drejtën e tyre për jetën dhe sigurinë”.

Gjithashtu, rezoluta bën thirrje që shtetet anëtare të Këshillit të Evropës “të dënojnë gjuhën e urrejtjes dhe deklaratimet diskriminuese dhe të mbrojnë në mënyrë efektive personat LGBT nga këto deklaratime, duke respektuar të drejtën e lirisë së shprehjes në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, dhe “të miratojnë dhe zbatojnë ligje kundër diskriminimit që, ndër shkaqet për diskriminim, përfshijnë orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si dhe sanksionet për shkeljet”.

50. <http://www.coe.int/en/web/sogi/rec5-2010->

51. <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=17853&lang=en>

Konventa e Këshillit të Evropës mbi Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje⁵²

E njohur si Konventa e Stambollit, ky instrument përfshin angazhime të detyrueshme ligjore lidhur me parandalimin, mbrojtjen, hetimin dhe dënimin. Ndërsa dhuna kundër grave dhe dhuna në familje janë jashtë objektivit të këtij Manuali, është me rëndësi që të mbahet parasysh se edhe personat LGBTI mund të jenë viktimat të kësaj dhune. Gjithashtu, disa raste të dhunës kundër personave LGBTI në familje mund të konsiderohen dhe përjetohen si krim për shkak të urrejtjes dhe dhunë në familje. Është e dobishme që një trajnues ta hulumtojë këtë çështje gjatë diskutimeve në seancë plenare dhe t'i pyesë pjesëmarrësit lidhur me çështjet që ngrihen kur analizohet si ndërvepron dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjininë me krimin për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI.

Konventa përfshin një klauzolë kundër diskriminimit që parashikon se viktimat nuk duhen diskriminuar në bazë të identitetit gjinor apo orientimit seksual. Për historikun dhe informacione të mëtejshme, shih relacionet shpjeguese⁵³ dhe një analizë të dobishme që është bërë nga "Transgender Europe".⁵⁴

Standarde të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Rezoluta e miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB-së, më datë 30 qershor 2016 32/2: "Mbrojtja nga dhuna dhe diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor"⁵⁵

Kjo rezolutë "dënon fuqimisht aktet e dhunës dhe diskriminimit, në gjithë rajonet e botës, të kryera ndaj individëve për shkak të orientimit seksual apo identitetit të tyre gjinor". Me këtë rezolutë, anëtarët e Kombeve të Bashkuara nënshkruan rezolutën, gjithashtu, caktojnë për një periudhë trevjeçare një ekspert të pavarur për mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Eksperti ka një numër rolesh, përfshirë vlerësimin e zbatimit të standardeve përkatëse për të drejtat e njeriut, duke u ofruar shteteve anëtare asistencë teknike, duke u përfshirë në dialog me autoritetet publike dhe duke raportuar në Këshillin për të Drejtat e Njeriut të OKB-së për ecurinë e tyre.

Për më shumë standarde të Kombeve të Bashkuara lidhur me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, hulumtoni bankën e të dhënave të Kombeve të Bashkuara mbi çështjet SOGI.⁵⁶

Direktiva e Bashkimit Evropian 2012/29/EU që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit⁵⁷.

Kjo Direktivë u miratua më datë 25 tetor 2012 dhe hyri në fuqi më datë 15 nëntor 2012. Deri më datë 16 nëntor 2015, Vendet anëtare të Bashkimit Evropian duhet t'i përfshinin dispozitat në ligjet e tyre vendase. Direktiva zbatohet për gjithë viktimat e krimit dhe iu referohet, sidomos, viktimave të krimeve të urrejtjes, përfshirë viktimat e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI. Ajo përcakton detyra specifike për Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian që viktimat e krimeve të urrejtjes t'i trajtojnë si një kategori që kërkon mbrojtje të veçantë; që të sigurojnë që viktimat të kenë akses ndaj shërbimeve mbështetëse specifike bazuar në vlerësimin e nevojave të tyre; dhe të sigurojnë që profesionistët e ndjekjes penale, të cilët mund të hyjnë në kontakt me viktimat, përfshirë policinë, prokurorët dhe gjyqtarët, të kenë trajnimin e përshtatshëm me qëllim që viktimat të trajtohen në mënyrë të respektueshme dhe jodiskriminuese.

Pjesët më poshtë janë zgjedhur nga nenet më të rëndësishme.

Neni 3: E drejta për të kuptuar dhe për t'u kuptuar

1. Vendet anëtare marrin masat e duhura për të asistuar viktimat që të kuptojnë dhe të kuptohen qysh nga kontakti i parë dhe gjatë çdo ndërveprimi të mëtejshëm të nevojshëm që kanë me një autoritet kompetent në kontekstin e procedurave të ndjekjes penale, përfshirë kur informacioni jepet nga ai autoritet.
2. Vendet anëtare sigurojnë që komunikimet me viktimat bëhen në një gjuhë të thjeshtë dhe lehtësisht të kuptueshme, me gojë ose me shkrim. Të tilla komunikime marrin në konsideratë karakteristikat personale të viktimës, përfshirë aftësinë e kufizuar që mund të ndikojë tek aftësia për të kuptuar ose për t'u kuptuar.

52. <http://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/about-the-convention>

53. <http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/210>

54. <http://tgeu.org/protection-of-trans-people-under-the-istanbul-convention/>

55. http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/HRC/RES/2/32

56. <https://www.icj.org/sogi-un-database>

57. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1421925131614&uri=CELEX:32012L0029>

3. Përveç kur është kundër interesave të viktimës apo përveç kur cenohet ecuria e procesit gjyqësor, Vendet anëtare lejojnë që viktimat të shoqërohen nga një person i zgjedhur prej tyre në kontaktin e parë me një autoritet kompetent, ku, për shkak të impaktit të krimit, viktima kërkon ndihmë për të kuptuar ose për t'u kuptuar.

Neni 8: E drejta për të patur akses ndaj shërbimeve për mbështetjen e viktimave

1. Vendet anëtare sigurojnë që viktimat, në përputhje me nevojat e tyre, të kenë akses ndaj shërbimeve konfidenciale falas për mbështetjen e viktimave, që veprojnë në interes të viktimave përpara, gjatë dhe për një periudhë të përshtatshme pas procedurës së ndjekjes penale. Pjesëtarët e familjes kanë akses ndaj shërbimeve për mbështetjen e viktimave në përputhje me nevojat e tyre dhe shkallën e dëmit të pësuar si rezultat i veprës kriminale të kryer ndaj viktimës.
2. Vendet anëtare mundësojnë referimin e viktimave, nga autoriteti kompetent që ka marrë ankesën dhe nga subjekte të tjerë përkatës, tek shërbimet për mbështetjen e viktimave.

Vendet anëtare marrin masa për të ngritur shërbime të specializuara falas dhe konfidenciale për ofrimin e mbështetjes përveç apo si pjesë përbërëse e shërbimeve të përgjithshme për mbështetjen e viktimave, apo për të bërë të mundur që organizatat, të cilat ofrojnë mbështetje për viktimat, t'u drejtohen agjencive të specializuara ekzistuese që e ofrojnë këtë mbështetje të specializuar. Viktimat, në përputhje me nevojat e tyre specifike, kanë akses ndaj këtyre shërbimeve dhe pjesëtarët e familjeve kanë akses në përputhje me nevojat e tyre specifike dhe shkallën e dëmit të pësuar si rezultat i veprës kriminale të kryer ndaj viktimës.

3. Shërbimet për mbështetjen e viktimave dhe një shërbim mbështetës i specializuar mund të ngrihen si organizata publike ose joqeveritare dhe mund të organizohen mbi baza profesionale ose vullnetare.
4. Vendet Anëtare sigurojnë që aksesin ndaj një shërbimi për mbështetjen e viktimave të mos varet nga viktima që bën një ankesë formale pranë një autoriteti kompetent lidhur me një vepër kriminale.

Neni 20: E drejta për mbrojtje e viktimave gjatë hetimit penal

1. Pa rënë ndesh me të drejtat për mbrojtje dhe në përputhje me rregullat e vlerësimit gjyqësor, Vendet Anëtare sigurojnë që gjatë hetimeve penale:
 - a) intervistat e viktimave kryhen pa vonesë të pajustificuar pasi ankesa lidhur me një vepër kriminale është bërë pranë autoritetit kompetent;
 - b) numri i intervistave të viktimave të jetë sa më i vogël dhe intervistat të bëhen vetëm kur janë absolutisht të nevojshme për qëllime të hetimit për veprën penale;
 - c) viktimat mund të shoqërohen nga përfaqësuesi i tyre ligjor dhe nga një person i zgjedhur prej tyre, përveç kur është marrë një vendim i arsyetuar për të kundërtën;
 - d) vizitat mjekësore të jenë sa më të pakta dhe të bëhen vetëm kur janë absolutisht të nevojshme për qëllime të procedurës së ndjekjes penale.

Neni 22: Vlerësimi individual i viktimave për identifikimin e nevojave për mbrojtjen e tyre

1. Vendet anëtare sigurojnë që vlerësimi i viktimave të bëhet në kohë dhe të jetë individual, në përputhje me procedurat kombëtare, për të identifikuar nevojat e veçanta për mbrojtje dhe për të përcaktuar nëse dhe në çfarë mase përfitojnë ato nga masat e posaçme gjatë procedurave të ndjekjes penale, siç përcaktohet në Nenet 23 dhe 24, për shkak të cënueshmërisë së veçantë ndaj një viktimizimi të dytë e të përsëritur, kanosjes dhe hakmarrjes.
2. Vlerësimi individual, në mënyrë të veçantë, merr parasysh:
 - a. karakteristikat personale të viktimës;
 - b. llojin apo natyrën e krimit; dhe
 - c. rrethanat e krimit.
3. Në kontekstin e vlerësimit individual, vëmendje e posaçme u kushtohet viktimave, të cilat kanë pësuar dëm të konsiderueshëm për shkak të ashpërsisë së krimit; viktimave, ndaj të cilave është bërë një krim me motiv paragjykes ose diskriminues që mund të lidhet, në mënyrë të veçantë, me karakteristikat e tyre personale; viktimave marrëdhëniet e të cilave me autorin e veprës kriminale dhe varësia ndaj tij i bëjnë ato veçanërisht të cënueshme. Në këtë aspekt, merren në konsideratë sipas rregullave viktimat e

terrorizmit, krimet të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës me bazë gjininë, dhunës në një marrëdhënie të ngushtë, dhunës seksuale, shfrytëzimit apo krimeve të urrejtjes, dhe viktimat me aftësi të kufizuara.

4. Për qëllime të kësaj Direktive, fëmijët viktimë supozohet se kanë nevojë të veçanta për mbrojtje për shkak të cenueshmërisë ndaj një viktimizimi të dytë dhe të përsëritur, kanosjes dhe hakmarrjes. Për të përcaktuar nëse dhe në çfarë mase përfitojnë ata nga masat e posaçme që parashikohen në Nenet 23 dhe 24, fëmijët viktimë i nënshtrohen një vlerësimi individual siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni.
5. Shkalla e vlerësimit individual mund të përshtatet sipas ashpërsisë së krimet dhe dëmit real që ka pësuar viktimë.
6. Vlerësimet individuale bëhen me përfshirjen e drejtpërdrejtë të viktimës dhe marrin parasysh dëshirat e tyre, përfshirë kur nuk duan që të përfitojnë nga masat e posaçme që parashikohen në Nenet 23 dhe 24.
7. Në qoftë se elementet që përbëjnë bazën e vlerësimit individual kanë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme, Vendet Anëtare sigurojnë që ai të përditësohet gjatë gjithë ndjekjes penale.

Neni 25: Trajnimi i profesionistëve

1. Vendet anëtare sigurojnë që zyrtarët, të cilët mund të hyjnë në kontakt me viktimat, si: oficerët e policisë dhe personeli i gjykatave, i nënshtrohen si trajnimit të përgjithshëm, ashtu dhe atij të specializuar, në një nivel të përshtatshëm për kontaktin e tyre me viktimat me qëllim sensibilizimin e tyre lidhur me nevojat e viktimave dhe aftësimin e tyre për t'i trajtuar viktimat me paanësi, respekt dhe profesionalizëm.
2. Pa cenuar pavarësinë e gjyqësorit dhe dallimet në organizimin e gjyqësorit në gjithë Bashkimin Evropian, Vendet Anëtare kërkojnë që ata, që janë ngarkuar me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përfshirë në ndjekje penale, të vënë në dispozicion si trajnimin e përgjithshëm, ashtu dhe atë të specializuar, me qëllim rritjen e sensibilizimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me nevojat e viktimave.
3. Me gjithë respektin për pavarësinë e profesionit ligjor, Vendet Anëtare rekomandojnë se ata që janë të ngarkuar me trajnimin e avokatëve, të vënë në dispozicion si trajnimin e përgjithshëm, ashtu dhe atë të specializuar, me qëllim rritjen e sensibilizimit të avokatëve lidhur me nevojat e viktimave.
4. Nëpërmjet shërbimeve të tyre publike ose duke financuar organizatat që ofrojnë mbështetje për viktimat, Vendet Anëtare inkurajojnë iniciativë që bëjnë të mundur që ata, të cilët ofrojnë mbështetje për viktimat dhe shërbime gjyqësore për rehabilitimin, t'i nënshtrohen trajnimit të përshtatshëm, në një nivel të përshtatshëm për kontaktin e tyre me viktimat, dhe të respektojnë standardet profesionale me qëllim që këto shërbime të ofrohen me paanësi, respekt dhe profesionalizëm.
5. Në përputhje me detyrat që ushtrohen, si dhe natyrën dhe nivelin e kontaktit që ka profesionisti me viktimat, trajnimi synon ta aftësojë profesionistin që t'i njohë viktimat dhe t'i trajtojë ato me respekt, profesionalizëm dhe pa diskriminim.

Moduli i Katërt: Hetimi i krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI

HYRJE DHE HISTORIKU

Përgjegjësia kryesore e punonjësve të policisë është që të parandalojnë krimin dhe, në qoftë se krimi ndodh, të hetojnë dhe zbulojnë ngjarjen kriminale dhe autorët e saj. Kjo është me rëndësi të veçantë në fushën e krimeve urrejtjes, duke patur parasysh ndikimin psikologjik tek viktimat,⁵⁸ tendencën e krimeve për shkak të urrejtjes për t'u përshkallëzuar dhe ndikimin e mundshëm tek komuniteti më i gjerë LGBTI. Parandalimi i përsëritjes së viktimizimit është gjithashtu një faktor i rëndësishëm. Në qoftë se kjo gjë mbetet pa u trajtuar, krimet e urrejtjes mund të rezultojnë në sjellje kriminale të mëtejshme dhe më të ashpra. Mosreagimi me efektivitet nga ana e policisë mund të sjellë si rezultat sfida të konsiderueshme për sa i takon kompetencës së policisë dhe mund të dëmtojë marrëdhëniet me komunitetin.

Siç është diskutuar në kapitujt e mëparshëm, policia ka përgjegjësi pozitive për ta bërë punën e saj në mënyrë profesionale dhe të plotë. Ky modul synon që të pajisë oficerët e policisë me njohuri dhe aftësi për hetimin me profesionalizëm të krimeve të urrejtjes.

Hetimi i krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI është i vështirë, meqenëse ai kërkon që policia të marrë provat nga viktimat të cenushme, shpeshherë, në situata personale shumë stresuese. Hetimi kërkon që viktimat të bëjnë publike informacione për të cilat mund të ndiejnë zor që të flasin.

Komuniteti dhe viktimat presin reagim të shpejtë dhe profesional nga ana e policisë. Mungesa për ta treguar qartë këtë mund të dëmtojë besimin dhe dërgon tek komuniteti mesazhin se policia nuk i merr seriozisht krimet e urrejtjes apo, më keq, se i miraton krimet e urrejtjes.

Moduli nis me një ushtrim për të mbështetur të kuptuarit nga ana e oficerëve të policisë të vijës së parë të hapave që duhen ndërmarë kur reagohet fillimisht ndaj një incidenti të krimeve të urrejtjes. Ndër të përfshihet marrja e hollësive nga viktimat, mbledhja e provave fizike dhe përpilimi i një raporti zyrtar për krimin.

Më tej, në modul hulumtohet hetimi i kimit të urrejtjes nga një këndvështrim që vendos viktimën në qendër. Kjo përfshin mbështetjen e viktimës në vendngjarjen e kimit, me telefon ose në rajonin e policisë. Në modul hulumtohet mënyra ideale si mund të merret një kallëzim dhe, më pas, analizohen vlerësimet e mëtejshme për t'i ofruar viktimës mbështetje pasi është hartuar kallëzimi i plotë.

Më pas, vëzhgohen në mënyrë të hollësishme nevojat unike të personave transgjiorë viktimat të kimit. Kjo është me rëndësi duke patur parasysh njohuritë e kufizuara që, shpeshherë, kanë oficerët e policisë për personat transgjiorë dhe nivelet e larta të viktimizimit të cilave u nënshtrohet ky grup.

Më tej, në modul merren në analizë treguesit paragjykses, tërësia e provave për të vërtetuar se ka ndodhur krim për shkak të urrejtjes. Më pas, përdoren shembuj praktikë për të siguruar përqendrimin e vëmendjes së pjesëmarrësve tek ajo çka kërkohet për të identifikuar dhe provuar një krim për shkak të urrejtjes nga këndvështrimi i policimit në vijën e parë.

58 Këshilli i Evropës pranon se termi "viktimë" nuk pranohet nga shumë njerëz, të cilët kanë qenë shënjestër të kimit për shkak të urrejtjes. Ne e pranojmë se, në shumë raste, njerëzit preferojnë termin "i mbijetuar" meqenëse ai pasqyron më mirë përvojën që kanë përjetuar. Në këtë Manual përdoret termi "viktimë" pasi ai përputhet më mirë me statusin ligjor dhe teknik të një personi të vënë në shënjestër nga krimi për shkak të urrejtjes, i cili është në kontakt me policinë dhe agjencitë e ndjekjes penale më gjerë. Siç theksohet gjatë gjithë Manualit, policia duhet të zbatojë një qasje që ka në qendër viktimën, si dhe ta pyesë personin e vënë në shënjestër si preferon që t'i drejtohen dhe, kur është e mundur, si preferon t'i ndjekë dëshirat e veta.

Së fundi, pjesëmarrësit do të përballen me sfidën e bërjes së analizës së marrëdhënieve që ekzistojnë ndërmjet shërbimit policor dhe komunitetit lokal LGBTI. Moduli i fundit do të përqendrohet tek rëndësia e besimit, faktor kryesor ky për të inkurajuar kallëzimin dhe për të ndihmuar sigurimin e provave të nevojshme për të mbështetur ndjekjen penale.

REZULTATET E PËRFTUARA NGA TË MËSUARIT

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të identifikojnë praktikën e mira në hetimin e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI. Kjo do të bëhet si nga këndvështrimi teknik i një hetimi policor, ashtu dhe nga këndvështrimi që ka në qendër viktimën;
- ▶ do të përftojnë një perceptim më të mirë të sfidave specifike me të cilat përballen komuniteti transgjinnor, dhe si të mbështeten më së miri, nga këndvështrimi i policimit, personat transgjinnorë kur janë viktimë të krimit;
- ▶ do të kuptojnë dhe do të arrijnë të identifikojnë treguesit e motivit paragjykes, komponentët që përdoren për të provuar motivin paragjykes të nevojshëm për hetimin dhe ngritjen me sukses të akuzës lidhur me krimin për shkak të urrejtjes;
- ▶ do të jenë të aftë për të identifikuar krimet e urrejtjes;
- ▶ do të kuptojnë rolin e policimit proaktiv në krijimin e besimit, komponent kryesor ky me qëllim që policimi të jetë efektiv.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE DHE AFATET KOHORE

- ▶ Aktiviteti 4.1: Mbledhja e provave: krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI – veprimi në vendngjarjen e krimit dhe hetimi i mëpasshëm i veprës kriminale (30 minuta)
- ▶ Aktiviteti 4.2: Mbledhja e provave: krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI – një qasje që vendos në qendër viktimën (30 minuta)
- ▶ Aktiviteti 4.3: Mbledhja e provave: viktimë e krimit të urrejtjes kundër – vlerësime specifike për personat transgjinnorë (60 minuta)
- ▶ Aktiviteti 4.4: Mbledhja e provave: Treguesit e paragjykimit – Të provosh paragjykimin/et në përzgjedhje / motivi paragjykes (30 minuta)
- ▶ Aktiviteti 4.5: Mbledhja e provave: Treguesit e paragjykimit – identifikimi i krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI (30 minuta)
- ▶ Aktiviteti 4.6a: Rëndësia e besimit: reagimet nga ana e policisë dhe komuniteti LGBTI (30 minuta)

AKTIVITETI 4.1: Mbledhja e provave: krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI – veprimet në vendngjarje dhe hetimi i mëpasshëm i veprës penale (30 minuta)

Ky aktivitet përmbledh lexime, diskutime në grupe të vogla dhe diskutimin në seancë plenare nën drejtimin e moderatorëve.

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme, stilolapsa
Dhoma ose hapësirë në dhomën e trajnimit për ndarjen në grupe
Prezantimet 4.1a dhe 4.1b

1. Përgatitni tri fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme.

- ▶ Fletën e parë titullojeni:
“Mbledhja e dëshmisë gojore: prova nga viktimat dhe dëshmitarët”
- ▶ Fletën e dytë titullojeni:
“Çfarë duhet mbledhur: provat shkencore kriminalistike dhe teknike të vendit të ngjarjes”
- ▶ Fletën e tretë titullojeni:
“Në rajon: përpilimi i një raporti të parë zyrtar për çështjen”
- ▶ Fletën e katërt titullojeni:
“Hetimi i mëtejshëm: hulumtimi i gjithë rrugëve”.

2. Ndajini pjesëmarrësit në katër grupe. Përpiluni të siguroheni që t’i ndani njerëzit, të cilët zakonisht punojnë bashkë, dhe të siguroni një përzierje të mirë të gjinive, nëse është e mundur.

3. Shpërndajeni prezantimin 4.1a dhe kërkoni nga pjesëmarrësit që të ndjekin udhëzimet. Jepini çdo grupi 10-15 minuta kohë që të lexojë të gjithë skenarin dhe, duke përdorur titujt e mësipërm, ngrini të gjitha çështjet që duhet të marrë në konsideratë një oficer policie kur heton një krim. Këto duhet t’i mbajë shënim një anëtar i grupit.

4. Bashkujini grupet e vogla në një grup më të madh. Kërkoni nga personi që luan rolin e zëdhënësit të çdo grupi që të bëjë një listë të çështjeve kryesore që ka identifikuar grupi i tij. Më pas, pyetini të gjithë pjesëmarrësit nëse ndokush ka mundur të mendojë për çështje që mungojnë.

5. Kur të shqyrtoni çështjet, referojuni udhëzuesit të praktikave të mira tek prezantimi 4.1b, duke nënvizuar çështjet kryesore dhe ndonjë që mund të ketë shpëtuar.

PREZANTIMI 4.1A: Mbledhja e provave: krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI – veprimi në vendngjarje dhe hetimi i mëposhëm i veprës penale

Ky aktivitet përmblodh lexime, diskutime në grupe të vogla dhe diskutimin në seancë plenare nën drejtimin e moderatorëve.

- ▶ Një pjesëmarrës duhet ngarkuar me leximin e këtij skenari përpara grupit.
- ▶ Një pjesëmarrës duhet ngarkuar me marrjen e shënimeve.

Skenari:

Akt dhune në qendër të qytetit:

Dy gra lezbike largohen nga një pikëtakimi për personat LGBTI në qendër të qytetit.

100 metra larg këtij pikëtakimi gratë sulmohen nga një grup meshkujsh, disa prej tyre të pajisur me shkopinj.

Gratë rrihen keqas me shkopinj, me grushte dhe me shkelma.

Autorët e veprës kriminale flasin me zë të lartë fjalë abuzive homofobike ndaj grave përpara dhe gjatë aktit të dhunës.

Një kalimtar i telefonon policisë dhe ju mbërrini në vendngjarje.

Pasi të keni lexuar skenarin më sipër, lexoni më poshtë përshkrimin e detyrës që i është ngarkuar grupit tuaj. Sugjeroni ide për 10-15 minuta, duke mbajtur shënime që të paraqisni konkluzionet tuaja përpara grupit kryesor.

Grupi 1 – detyrë:

Mbledhja e dëshmisë verbale: dëshmi verbale nga viktimat dhe dëshmitarët

Cilat janë çështjet kryesore që duhen shqyrtuar kur merrni hollësi nga viktimat dhe dëshmitarët në vendngjarje?

Grupi 2 – detyrë:

Çfarë duhet mbledhur: prova shkencore kriminalistike dhe teknike të vendit të ngjarjes

Cilat janë përgjegjësitë tuaja kryesore për sa i takon mbledhjes së provave shkencore kriminalistike dhe teknike të vendit të ngjarjes?

Grupi 3 – detyrë:

Në rajon: përpilimi i një raporti të parë zyrtar për çështjen

Cilat janë vlerësimet kryesore që duhet të mbajë parasysh policia kur kthehet në rajon dhe bën raportin zyrtar? Çfarë kërkon policia që të bëjë oficeri i policisë dhe pse?

Grupi 4 – detyrë:

Hetimi i mëtejshëm: të eksplorosh të gjitha mundësitë.

Përshkruani përmblodhtas procesin e hetimit pas hetimit fillestar në vendngjarje dhe pasi të keni bërë raportin zyrtar në rajonin e policisë. Pa patur emrin e të dyshuarit të parë, çfarë praktikash të mira hetimore mund të përdorni?

PREZANTIMI 4.1B: HETIMI I NJË KRIMI TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI – MBËRRITJA NË VENDNGJARJE, Mbledhja e provave teknike dhe e dëshmitarëve dhe vazhdimi i hetimit

Veprimet e para në vendngjarjen e krimit mund të kenë rëndësi shumë të madhe për suksesin e një hetimi të plotë penal. Mosdokumentimi i dëshmisë së dhënë me shkrim, mosdokumentimi se çfarë veprimesh ndërmorët ju si oficer policie apo mosmbledhja e provave materiale mund të sjellin si rezultat dështimin e një çështjeje penale.

Është me rëndësi, veçanërisht për krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, që ndërveprimi fillestar i policisë me viktimën dhe/ose dëshmitarët të sjellë si rezultat dhënien ose mosdhënien e informacionit të domosdoshëm, gjë që sërisht mund të rezultojë në suksesin apo dështimin e ndjekjes penale të një krimi serioz.

Ky prezantim ofron disa udhëzime për oficerët e policisë lidhur me veprimet që duhet të merren në vendngjarje, për sa i përket mbledhjes së provave të dëshmitarit dhe provave me rëndësi mjeko-ligjore. Më tej, prezantimi hulumton raportimin e krimit përmes kanaleve zyrtare të policisë dhe disa ide për hetimin vijues.

Këshillë për trajnuesin: ky udhëzues nuk është shterues dhe përpara hulumtimit të mëtejshëm të kësaj fushe duhen konsultuar udhëzuesit dhe rregulloret lokale për përvojën më të mirë.

A) Mbledhja e dëshmisë verbale: prova të viktimës, dëshmitarit dhe të dyshuarit.

Cilat janë çështjet kryesore që duhen mbajtur parasysh kur merren hollësi në vendngjarje nga viktimat dhe dëshmitarët?

B) Çfarë duhet mbledhur: provat shkencore kriminalistike dhe teknike të vendit të ngjarjes.

Cilat janë detyrat kryesore lidhur me mbledhjen e provave shkencore kriminalistike dhe teknike të vendit të ngjarjes?

C) Në rajon: përpilimi i një raporti të parë zyrtar për çështjen.

Cilat janë vlerësimet kryesore që duhet të mbajë parasysh policia kur kthehet në rajon dhe paraqet një raport zyrtar. Çfarë do policia që të bëjë oficeri i policisë dhe pse?

D) Hetimi vijues: hulumtimi i gjithë rrugëve.

Përshkruani përmbledhtas procesin e hetimit pas hetimit fillestar në vendngjarje dhe pasi të keni bërë raportin zyrtar në rajonin e policisë. Çfarë praktikash të mira hetimore mund të përdorni?

► Mbledhja e provave verbale të dëshmitarëve në vendngjarje

Çështjet kryesore që duhen patur parasysh kur merren hollësi në vendngjarje nga viktimat dhe dëshmitarët.

Ndërsa mund të jenë thjesht një dokumentim paraprak, shënimet që merren në vendngjarje mund të përdoren gjatë gjithë hetimit dhe mund të shqyrtohen në fazën e ndjekjes penale. Pra, është me rëndësi thelbësore të dokumentohen sa më shumë hollësi që të jetë e mundur.

Shënimet duhet të përmbajnë hollësi të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi një hetuesi të dytë të vazhdojë hetimin në qoftë se çështja i caktohet një tjetër detektiv/hetuesi të krimeve të urrejtjes.

- Identifikoni në qoftë se dëshmitarët kërkojnë përkthyes apo ndonjë mbështetje tjetër për t'i asistuar për të dhënë prova. Në qoftë se në vendngjarje nuk ka përkthyes, fillimisht, mund të përdoren pjesëtarët e familjes/miqtë. Fëmijët nuk duhen përdorur asnjëherë, përveç kur ekziston një situatë urgjente.
- Oficerët e policisë duhet të përdorin një gjuhë që të jetë e hapur dhe përfshirëse, si:
 - “A keni partner(partnere)?” në vend të “A jeni i/e martuar?”
 - “A keni ndonjë lidhje?” në vend të “A keni të dashur?”
- Viktimat duhen lejuar që të shpjegojnë çfarë ka ndodhur me fjalët e tyre dhe në kohën dhe me ritmin që do të përcaktohet prej tyre. Një qasje e duruar mund të rezultojë në sigurimin e provave kryesore, prova që, nga ana tjetër, mund të humbasin.
- Në qoftë se viktimat janë mjaft të dëshpëruara apo kanë pësuar plagë mjaft të rënda, shtyjeni marrjen e hollësishme në pyetje derisa ato të ndihen më mirë që të flasin (dhe, sipas rastit, organizoni dhënien e ndihmës mjekësore).
- Viktimat duhet të përdorin gjuhën e tyre dhe jo gjuhën e policisë. Në qoftë se ka paqartësi, mund të kërkohen sqarime.
- Dokumentoni fjalë për fjalë çdo gjë që thonë të dyshuarit për dëshmitarët.

- ▶ Në qoftë se në vendngjarje ndodhet ndonjë i dyshuar, dokumentoni çdo pohim në përputhje me legjislacionin vendas/rregulloret e policisë, duke bërë paralajmërime, sipas rastit. Përdorni fjalët e tyre ekzakte.

▶ **Mblidhni prova shkencore kriminalistike dhe teknike të vendit të ngjarjes**

Detyrat kryesore lidhur me mbledhjen e provave shkencore kriminalistike dhe teknike të vendit të ngjarjes lidhur me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI.

Këshillë për trajnuesin: Lista më poshtë nuk është shteruese dhe duhet marrë në konsideratë përdorimi i udhëzuesve lokalë nga ekspertët teknikë.

- ▶ Siguroni vendngjarjen kur të mbërrini, duke e rrethuar me kordon vendin e ngjarjes dhe çdo vend ku mund të kenë qenë autorët e veprës kriminale apo kur janë larguar nga vendngjarja.
- ▶ Ruani çdo provë të dukshme dhe bëni fotografi të të gjithë vendeve dhe provave përkatëse materiale. Merrni në shqyrtim bërjen e një videoje të vendngjarjes në qoftë se disponohen burime dhe është me vend. Siguroni prova materiale që tregojnë përfshirje të njëanshmërisë (p.sh.: fotografoni grafitet homofobike).
- ▶ Ruani tek viktimën çdo gjurmë që përbën provë. Mos harroni se çdo kontakt lë gjurmë dhe prova të autorëve të veprës kriminale mund të jenë të pranishme në lëkurën dhe rrobat e viktimës (gjak, pështymë, fibra të rrobave, flokë, ADN etj.).
- ▶ Merrni në konsideratë marrjen e kampionëve me anë të tamponëve, sipas rastit, dhe sekuestroni rrobat pasi të jetë bërë ndërrimi i rrobave.
- ▶ Fotografoni plagët e viktimës, duke marrë pëlqimin, sipas rastit. Mund t'ju duhet që të bëni fotografi pas një periudhe kohe derisa të nxirat të bëhen të dukshme.
- ▶ Merrni masa që të kërkohen të jenë të pranishëm ekspertë kriminalistë të vendit të ngjarjes ose specialistë të mjekësisë ligjore.
- ▶ Mblidhni dhe sistemojini gjithë provat materiale në përputhje me rregulloret dhe përvojën më të mirë lokale.
- ▶ Identifikoni mundësitë për marrjen e provave të ADN-ës nga vendngjarja. Ndër burimet përfshihen armët/mjetet që janë përdorur, çdo gjë që mund të kenë prekur apo nga e cila mund të kenë pirë, gjaku, pështyma, flokët ose lëngje të tjera të trupit. Siç thuhet më sipër, ADN-ja e të dyshuarit mund të jetë e pranishme tek viktimën.
- ▶ Në qoftë se kallëzimi për ngjarjen bëhet me telefon, këshillojeni viktimën/dëshmitarin që t'i ruajë provat.
- ▶ Kërkoni asistencën e hetuesve të kualifikuar, nëse ka.
- ▶ Mblidhni filmime të kamerave të brendshme nga zonat ngjitur dhe zonat përreth, duke u kushtuar vëmendje të posaçme pikave të hyrjes dhe daljes nga vendngjarja.
- ▶ Në qoftë se një i dyshuar identifikohet dhe arrestohet, kërkoni të sigurohen veshjet dhe këpucët që mund të përmbajnë prova dhe të merrni një kampion ADN-je, si dhe gjurmë gishtash dhe fotografi. Duhet fotografuar tatutë që tregojnë anëtarësim, për shembull, në grupe ekstremiste të djathta.
- ▶ Organizoni një vizitë mjekësore dhe kërkoni miratimin që të siguroni një raport të mjekut ligjor.
- ▶ Supozoni se ky rast do të rezultojë në çështje të mirëfilltë gjyqësore, kështu që mblidhni gjithë provat për këtë rast.

▶ **Sërih në rajonin e policisë: përpilimi i një raporti zyrtar për çështjen**

Kur të bëni dokumentimin dhe raportimin e kërkesave në rajon menjëherë pas ngjarjes, mos harroni se dokumentimi i saktë i krimeve të urrejtjes është me rëndësi thelbësore me qëllim që të mund të identifikohen modele të sjelljes ofenduese dhe të vihen në jetë masa parandaluese. Ky seksion duhet shtuar me praktikat dhe procedurat e vendit.

- ▶ Krijoni një raport për veprën penale në bankën e të dhënave të policisë (në formë shkresore ose jo, në varësi të vendit).
- ▶ Dokumentoni vëzhgimet e para që e identifikojnë ngjarjen si krim të mundshëm për shkak të urrejtjes.
- ▶ Bëni hetime për të identifikuar nëse janë kryer më parë krime të ngjashme. Mund të ekzistojë një model sjelljeje ofenduese. Rishikoni dokumentacionin për krimin për shkak të urrejtjes me qëllim identifikimit e modeleve të viktimizimit.

- ▶ Merrni në analizë dokumentacionin për të parë nëse viktimë ka qenë viktimë më përpara. Kjo është me rëndësi për të identifikuar viktimizimin e mundshëm të përsëritur.
- ▶ Raportojeni ngjarjen tek eprori përkatës siç e kërkojnë politika/rregulloret lokale.
- ▶ Raportojeni ngjarjen tek njësia lokale/kombëtare e krimeve të urrejtjes në përputhje me politikën/rregulloret.
- ▶ Në qoftë se hetimi i kalon një hetuesi/njësie tjetër, bëni kujdes që ata të marrin dijeni se mund të bëhet fjalë për krim për shkak të urrejtjes.
- ▶ Sigurohuni, sipas rastit, që zëdhënësi i eprorit/policisë për median të marrë informacion për ngjarjen.
- ▶ Në qoftë se identifikohet një model i krimeve të urrejtjes, raportojeni me qëllim që të vihet në jetë reagimi/ndërhyrja e përshtatshme.
- ▶ Organizoni që në të ardhmen të angazhoni përkthyes për viktimë/dëshmitarë/të dyshuar, nëse është e nevojshme.
- ▶ Organizoni dorëzimin e provave materiale tek një oficer hetues/ekip hetues.

▶ **Hetimi i mëtejshëm: eksplorimi i të gjitha mundësive.**

Pas hetimit fillestar në vendngjarje dhe pasi keni përpiluar raportin zyrtar në rajonin e policisë, shpeshherë, çështja kërkon hetim të konsiderueshëm të mëtejshëm, sidomos, kur nuk përmendet asnjë i dyshuar. Praktikant e mira hetimore më poshtë nuk janë shpesh dhe duhen plotësuar me hollësi që t'u përshtaten praktikave/procedurave lokale. Vendosmëria e oficerëve të policisë për të identifikuar autorët e veprave kriminale në ngjarje të krimeve të urrejtjes është me rëndësi vendimtare për krijimin e besimit tek komunitetet e pakicave. Kur besimi tek shërbimi policor nuk është i madh, dëshmitarët LGBTI mund të mos ndihen të qetë që të flasin me policinë. Në këto raste duhen bërë përpjekje të mëtejshme për inkurajimin e paraqitjes së dëshmitarëve.

Oficerët e policisë:

- ▶ duhet të bëjnë thirrje për dëshmitarë duke përdorur median, median sociale etj.
- ▶ duhet të kërkojnë për ngjarje të ngjashme në vende/rajone të tjera të policisë.
- ▶ duhet të kërkojnë dëshmitarë, të cilët mund të shkojnë rregullisht në atë zonë/vendngjarje (punonjësit të postës, mbledhësit e mbeturinave, njerëz në linjat e autobusit). Mund të ndihmojnë oficerët e policisë të rrugës/komunitetit lokal.
- ▶ duhet të kenë një oficer me përvojë që të rishikojë provat e mbledhura deri në atë moment, me qëllim identifikimin e linjave të reja të hetimit.
- ▶ duhet të shqyrtojnë regjistrimet e qendrës së thirrjeve urgjente.
- ▶ duhet të përdorin mjekun ligjor për çështjen, sipas rastit.
- ▶ duhet të kryejnë hetime derë më derë në zonë.
- ▶ duhet të mbikëqyrin filmimet e kamerave të brendshme.
- ▶ duhet të shqyrtojnë gjithë dokumentacionin që disponohet për krimin dhe dokumentacionin e sektorit operativ të krimeve për të identifikuar lidhjet.
- ▶ duhet të shqyrtojnë përdorimin e telefonit celular dhe të shqyrtojnë provat nga telefoni, sipas rastit.
- ▶ duhet të përdorin njësi të specializuara, sipas rastit.
- ▶ duhet të kërkojnë shërbimet e sektorit të analizës së krimeve (në qoftë se ekzistojnë të tilla) me qëllim shqyrtimin e provave dhe hetimeve pasi kanë kaluar 28 ditë në rastin e krimeve të rënda.
- ▶ duhet të pyesin punonjësit e sigurisë dhe personelin në vendet e frekuentuara nga persona LGBTI për të parë nëse ata kanë ndonjë informacion që mund jetë i dobishëm. Shumë njerëz mund të zhvillojnë me komuniteti biseda që nuk i bëjnë me policinë. Edhe informacionet "e tërthorta" mund të jenë të dobishme.
- ▶ duhet të kërkojnë ndihmën e organizatave të shoqërisë civile për personat LGBTI që të bëjnë thirrje për informacione.
- ▶ duhet të përdorin informacionet nga grupet e faqeve të internetit të palëve të treta, kur gjenden.

AKTIVITETI 4.2: Mbledhja e provave: krimet e urrejtjes – një qasje që vendos në qendër viktimën (30 minuta)

Ky aktivitet përmbledh lexime, diskutime në grupe të vogla dhe diskutimin në seancë plenare nën drejtimin e moderatorëve.

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme, stilolapsa

Dhoma ose hapësirë në dhomën e trajnimit për ndarjen në grupe

Prezantimet 4.2a dhe 4.2b

1. Përgatisni tri fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme.

- ▶ Fletën e parë titullojeni:
"Raporti fillestar: dhënia e mbështetjes viktimës në vendin e krimit/me telefon/pritja në rajon"
- ▶ Fletën e dytë titullojeni:
"Marrja e një kallëzimi të hollësishëm nga viktimia"
- ▶ Fletën e tretë titullojeni:
"Mbështetje e vazhdueshme dhe zbutja e risqeve"

2. Ndajini pjesëmarrësit në tre grupe. Përpiquni të siguroheni që t'i ndani njerëzit, të cilët zakonisht punojnë bashkë, dhe të siguroni një përzierje të mirë të gjinive, nëse është e mundur.

3. Shpërndajuni prezantimin 4.2a dhe kërkonin nga grupet që të ndjekin udhëzimet. Jepuni grupeve 10-15 minuta që të sugjerojnë ide. Këto duhet t'i mbajë shënim një anëtar i grupit.

4. Bashkujini grupet e vogla në një grup më të madh. Kërkonin nga personi që luan rolin e zëdhënësit të çdo grupi, që të bëjë një listë të çështjeve kryesore që ka identifikuar grupi i tij. Më pas, pyetini të gjithë pjesëmarrësit nëse ndokush ka mundur të mendojë për çështje që mungojnë.

5. Kur të shqyrtoni çështjet, referojuni udhëzuesit të praktikave të mira tek prezantimi 4.2b, duke nënvizuar çështjet kryesore dhe ndonjë që mund të ketë shpëtuar.

PREZANTIMI 4.2A: HETIMI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI: NJË QASJE QË VENDOS NË QENDËR VIKTIMËN (30 MINUTA)

Një pjesëmarrës duhet ngarkuar për të mbajtur shënime.

Për këtë ushtrim mund të përdoret i njëjti skenar si ai i aktivitetit 4.1.

Skenari:

Akt dhune në qendër të qytetit:

Dy gra lezbike largohen nga një pikëtakimi për personat LGBTI në qendër të qytetit.

100 metra larg këtij pikëtakimi gratë sulmohen nga një grup meshkujsh, disa prej tyre të pajisur me shkopinj.

Gratë rrihen keqas me shkopinj, me grushte dhe me shkelma.

Autorët e veprës kriminale flasin me zë të lartë fjalë abuzive homofobike ndaj grave përpara dhe gjatë aktit të dhunës.

Një kalimtar i telefonon policisë dhe ju mbërrini në vendngjarje.

Pasi ta keni lexuar skenarin, lexoni më poshtë detyrën që i është ngarkuar grupit tuaj. Sugjeroni ide për 10-15 minuta, duke mbajtur shënime, sipas rastit.

Grupi 1 – detyrë:

Reagimi fillestar: dhënia e mbështetjes viktimave në vendin e krimit, kur bëhet kallëzim për një krim me telefon ose kur mbërrin në një rajon policie për të bërë kallëzimin e një krimi të urrejtjes kundër personave LGBTI. Çfarë duhet të mbajë parasysh policia?

Grupi 2 – detyrë:

Marrja e denoncimit/kallëzimit zyrtar: mbledhja e provave më të mira dhe dhënia e mbështetjes viktimës kur merret një denoncim a kallëzim i hollësishëm nga viktima.

Çfarë duhet të mbajë parasysh policia?

Grupi 3 – detyrë:

Pas mbledhjes së provave të para: dhënia e informacioneve dhe mbështetjes viktimës. Reduktimi i riskut të riviktimizimit.

Çfarë duhet të mbajë parasysh policia?

PREZANTIMI 4.2B: HETIMI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI: NJË QASJE QË VENDOS NË QENDËR VIKTIMËN

Cilat janë vlerësimet kryesore që duhet të mbajë parasysh policia për sa i takon dhënies së mbështetjes viktimës në vendngjarje, kur merr një denoncim të hollësishëm nga një dëshmitar dhe në mënyrë të vazhdueshme? Ky prezantim ofron udhëzim në këto fusha:

- A) dhënia e mbështetjes viktimave në fazat fillestare të hetimit penal.
- B) marrja e denoncimit të hollësishëm nga viktimat/dëshmitari dhe krijimi i një mjedisi të favorshëm për mbledhjen e provave më të mira.
- C) dhënia e mbështetjes së vazhdueshme viktimës dhe zbutja e riskut.

Duhet vënë në dukje se këto rekomandime nuk janë shteruese dhe duhen përshtatur për të marrë në konsideratë legjislacionin, politikat dhe procedurat vendase.

A) Dhënia e mbështetjes viktimave në fazat fillestare të hetimit penal

Kontakti fillestar me viktimën do të lërë një përshtypje të përhershme si e konsideron viktimat policinë dhe pritshmëritë që viktimat do të ketë për sa i takon ofrimit të shërbimeve. Një fillim i keq mund të shkatërrojë mundësitë e sigurimit të bashkëpunimit të dëshmitarit.

Më poshtë përmbledhen çështjet kryesore që duhen mbajtur parasysh në fazat fillestare të hetimit.

Në vendin e krimit

- ▶ Kërkoni ndihmë mjekësore kurdo është e nevojshme, pasi ajo duhet të jetë prioriteti kryesor.
- ▶ Siguroni që viktimat është e sigurt në vendngjarje; largojeni nga vendi i krimit nëse është në rrezik.
- ▶ Viktimat duhet intervistuar nga një oficer policie për të minimizuar traumën; një oficer i dytë mund të jetë i pranishëm, nëse është e nevojshme, por që më e mira do të ishte që të mos bënte pyetje.
- ▶ Qetësojeni viktimën se nuk ka faj për atë që ndodhi.
- ▶ Oficerët e policisë duhet të përdorin gjuhë që është e hapur dhe përfshirëse, si:
 - “A keni partner(partnere)?” në vend të “A jeni i/e martuar?”
 - “A keni ndonjë lidhje?” në vend të “A keni të dashur?”
- ▶ Tregohuni të duruar dhe krijojeni viktimës hapësirë që të shprehë çfarë ndien.
- ▶ Mbrojeni identitetin e viktimës nga ekspozimi i panevojshëm. Këshillojeni viktimën se policia do ta mbrojë jetën e tij/saj private sa më shumë që të jetë ligjërish e mundur.
- ▶ Njoftojeni viktimën se çfarë mundësisht ekzistojnë realisht që ngjarja të bëhet publike dhe/ose të jepet si lajm në media. Sigurohuni që ky informacion të mos përcillet në mënyrë të tillë që viktimat të mendojë se policia nuk ka dëshirë që ta ndjekë çështjen.
- ▶ Referojeni viktimën tek një shërbim lokal për mbështetjen e viktimave (me miratimin e vet). Hollësitë për shërbimet mbështetëse duhen dhënë me gojë dhe me shkrim.
- ▶ Viktimës duhet t’i jepen kontaktet e oficerit hetues ose të asistentit social nëse ka dëshirë që të komunikojë më tej me ta. Duhet marrë në konsideratë një asistent i dytë në qoftë se asistenti fillestar do të mungojë për periudha të gjata kohe.
- ▶ Pyeteni viktimën nëse ka ndonjë shok(shoqe)/partner(partnere), të cilin/cilën dëshiron që të kontaktohet për t’i dhënë mbështetje.
- ▶ Dokumentojeni gjendjen emocionale të viktimës (p.sh.: a është në gjendje shoku?)
- ▶ Bazuar në informacionin e mbledhur më sipër, vlerësoni riskun e menjëhershëm ndaj viktimës ose partnerit (partnere) / familjes së tij/të saj të afërt. Përveç çështjeve më sipër, përcaktoni nëse viktimat ka marrë kërcënime, nëse janë përdorur armë, nëse ka patur ngjarje të mëparshme dhe nëse autori i veprës kriminale – nëse njihet – ka kryer vepra të ngjashme kriminale në të kaluarën. Bazuar tek vlerësimi, menjëherë vini në jetë masat e nevojshme për mbrojtje. Për një shembull të vlerësimit të hollësishëm të riskut, shih një vlerësim model të incidentit të urrejtjes hartuar nga policia e Hampshajërit.⁵⁹

59. <http://www.hampshire.police.uk/internet/asset/de7ad9c4-8783-0cae9-cb2-9bc004ab0eal/hc20%15-002299-additional20%information.pdf>

Në qoftë se kallëzimin e parë e merrni me telefon

- ▶ Identifikoni ndihmën mjekësore që nevojitet dhe merrni masa për një ambulancë, nëse është e nevojshme.
- ▶ Bëni pyetje për t'u siguruar nëse viktimë është e sigurt në vendngjarje, dhe këshillojeni viktimën që të largohet nga vendngjarja nëse është në rrezik dhe ka mundësi që të largohet. Drejtojini oficerët e ndërhyrjes së shpejtë për në vendngjarje në qoftë se viktimë është në rrezik dhe nuk mund të largohet.
- ▶ Tregojuni të duruar dhe krijoni viktimës hapësirë të shpjegojë çfarë i ka ndodhur, duke marrë shënim sa më shumë hollësi që të jetë e mundur.
- ▶ Viktimës duhet t'i jepet informacion si ta bëjë sa më mirë kallëzimin zyrtar. Viktimës duhet t'i jepen hollësi se cilin duhet të kontaktojë, kur dhe ku. Duhet bërë përgatitje që viktimë të kontaktohet nga një oficer hetues në përputhje me politikën e policisë lokale.
- ▶ Referojeni viktimën tek një shërbim lokal për mbështetjen e viktimave (me miratimin e vet). Hollësitë për shërbimet mbështetëse duhen dhënë me gojë dhe me shkrim.
- ▶ Dokumentojeni gjendjen emocionale të viktimës (p.sh.: a është në gjendje shoku?)
- ▶ Bëni vlerësimin e riskut ndaj viktimës dhe menjëherë vini në jetë masat e nevojshme për mbrojtje. Shihni seksionin më sipër për më shumë informacion lidhur me vlerësimet e riskut.

Në qoftë se viktimë vjen në rajonin e policisë

- ▶ Kërkoni ndihmë mjekësore, nëse është e nevojshme.
- ▶ Viktimë duhet intervistuar nga një oficer policie për të minimizuar traumën; një oficer i dytë mund të jetë i pranishëm, nëse është e nevojshme.
- ▶ Qetësojeni viktimën se nuk ka faj për atë që ndodhi.
- ▶ Hollësitë fillestare nga viktimë merrni në një dhomë private dhe jo tek sporteli publik.
- ▶ Oficerët e policisë duhet të përdorin një gjuhë që të jetë e hapur dhe përfshirëse, si:
 - “A keni partner (partnere)?” në vend të “A jeni i/e martuar?”
 - “A keni ndonjë lidhje?” në vend të “A keni të dashur?”
- ▶ Mbrojeni identitetin e viktimës nga ekspozimi i panevojshëm. Këshillojeni viktimën se policia do ta mbrojë e jetën e tij/saj private sa më shumë që të jetë ligjërisht e mundur.
- ▶ Viktimës duhet t'i jepen kontaktet e oficerit hetues ose të asistentit social nëse ka dëshirë që të komunikojë më tej me ta. Duhet marrë në konsideratë një asistent i dytë në qoftë se asistenti fillestar do të mungojë për periudha të gjata kohe.
- ▶ Referojeni viktimën tek një shërbim lokal për mbështetjen e viktimave (me miratimin e vet). Hollësitë për shërbimet mbështetëse duhen dhënë me gojë dhe me shkrim.
- ▶ Njoftojeni viktimën se çfarë mundësisht ekzistojnë realisht që ngjarja të bëhet publike dhe/ose të jepet si lajm në media. Sigurohuni që ky informacion të mos përcillet në mënyrë të tillë që viktimë të mendojë se policia nuk ka dëshirë që ta ndjekë çështjen.
- ▶ Tregohuni të duruar dhe krijoni viktimës hapësirë që të shprehë çfarë ndien.
- ▶ Pyeteni viktimën nëse ka ndonjë shok(shoqe)/partner(partnere), të cilin/të cilën dëshiron që të kontaktohet për të dhënë mbështetje.
- ▶ Dokumentojeni gjendjen emocionale të viktimës (p.sh.: a është në gjendje shoku?)
- ▶ Bëni vlerësimin e riskut ndaj viktimës dhe menjëherë vini në jetë masat e nevojshme për mbrojtje. Shihni seksionin më sipër për më shumë informacion lidhur me vlerësimet e riskut.

B) Marrja e denoncimit të hollësishëm nga viktimë/dëshmitari. Krijimi i një mjedisi të favorshëm për mbledhjen e provave më të mira.

Shpeshherë, intervista është momenti gjatë hetimit kur sigurohen provat kryesore. Kjo mund të vendosë suksesin ose dështimin e një çështjeje penale. Policia duhet të ekuilibrojë nevojën për të kërkuar informacion sa më të hollësishëm që të jetë e mundur me nevojat e viktimës, përfshirë nevojën për konfidencialitet.

- ▶ Sigurohuni që dhoma ku zhvillohet intervista të jetë e qetë dhe që juve nuk do t'ju shqetësojnë gjatë marrjes së denoncimit.
- ▶ Vendosni tek dera tabelën “Mos hyni”.

- ▶ Bëjeni mjedisin sa më të rehatshëm që të jetë e mundur.
- ▶ Mbyllini celularët dhe përpiquni që të siguroheni që të mos ju shqetësojnë gjatë kohës në fjalë.
- ▶ Lejoni pauza, nëse është e nevojshme.
- ▶ Mos përdorni gjuhë gjykuese apo mos e jepni opinionin tuaj personal për rrethanat individuale të viktimës.
- ▶ Bëjani të ditur viktimës se ju e kuptoni që shpjegimi i fakteve është i vështirë.
- ▶ Përdorni ton qetësues.
- ▶ Bëni kujdes me gjuhën e shenjave dhe ruani një shprehje sa më asnjënjëse që të jetë e mundur.
- ▶ Tregohuni i respektueshëm gjatë gjithë kohës, duke e pranuar dhimbjen/shqetësimin.
- ▶ Mos ushtroni presion ndaj viktimës nëse viktimë është e shqetësuar. Në një fazë më të vonshme mund të jetë e nevojshme të merret një denoncim i dytë. Kur kjo gjë paraqet vështirësi ligjore, kjo i duhet shpjeguar viktimës.
- ▶ Tregohuni të duruar me viktimën nëse viktimë jep më shumë hollësi lidhur me ngjarjen nga çka ju nevojitet për një denoncim.
- ▶ Bëni të mundur kohën e mjaftueshme dhe mos e ngutni procesin.
- ▶ Shmangni të kritikuarit e sjelljes së viktimës.
- ▶ Shmangni bërjen e hamendësimeve lidhur me besim fetar, mënyrën e jetesës, orientimin seksual të viktimës etj.
- ▶ Asnjëherë mos përdorni terma diskriminues.
- ▶ Asnjëherë mos e nënvlerësoni karakterin e rëndë të krimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur autorët e veprave kriminale janë në moshë të re apo ka patur përdorim të alkoolit.
- ▶ Mbani parasysh që denoncimin ta merrni në një vend asnjënjës ose në shtëpinë e viktimës nëse është e përshtatshme, duke patur parasysh faktet e çështjes.

C) **Mbështetje e vazhdueshme për viktimën dhe zbutja e riskut**

Pas ndërveprimit fillestar dhe pasi është marrë denoncimi, ndiqni rekomandimet që jepen më poshtë:

- ▶ Viktimë duhet të kontaktohet brenda 24 orësh pas caktimit të prokurorit të çështjes me qëllim risigurimin e viktimës se çështja po merret seriozisht.
- ▶ Pasi është bërë vlerësimi fillestar i riskut, viktimë në risk duhet monitoruar në mënyrë periodike dhe duhen marrë masat e duhura për zbutjen e risqeve të identifikuara.
- ▶ Këshilloni oficerin e policisë në komunitet që të shkojë ta shohë viktimën dhe ta risigurojë, nëse është e nevojshme. Duhet të diskutoni me viktimën përpara se të veproni kështu.
- ▶ Në raste të rënda, merrni në konsideratë që të përfshini një oficer të çështjeve familjare (oficer policie i trajnuar, i cili bën lidhjen me viktimën/familjen në një hetim të rëndësishëm) apo oficer të trajnuar të marrëdhënieve me personat LGBTI.
- ▶ Viktimë duhet të marrë njoftim, nëse një i dyshuar është arrestuar, nëse ndaj një të dyshuari është ngritur akuzë apo nëse një i dyshuar është lënë në gjendje të lirë.
- ▶ Në qoftë se i dyshuari është lënë në gjendje të lirë, viktimë duhet të marrë njoftim pse i dyshuari është lënë në gjendje të lirë.
- ▶ Viktimës duhet t'i jepet një pikë e vetme kontakti dhe një person i dytë kontakti, në qoftë se pika e vetme e kontaktit do të mungojë për periudha të konsiderueshme kohe.
- ▶ Duhet bërë referimet për mbështetjen e viktimës në qoftë se kjo gjë nuk është bërë ende.
- ▶ Duhet dhënë këshilla lidhur me parandalimin e krimeve dhe sigurinë personale dhe të shtëpisë.
- ▶ Viktimë duhet të njoftohet lidhur me ndonjë kërkesë të mediave për informacion.
- ▶ Për zbutjen e risqeve, viktimë duhet pajisur me pajisje sigurie personale dhe për shtëpinë (alarme kundër vjedhjeve, roje për sigurinë etj.), sipas rastit.
- ▶ Duhet mbështetur sigurimi i një vendbanimi të ri, nëse është e nevojshme.
- ▶ Hollësitë për viktimën duhen ruajtur në mënyrë shkresore dhe në bankat elektronike të të dhënave, nëse është e nevojshme.
- ▶ Në rastet e rënda viktimat mund të kërkojnë ndryshim të emrit apo një identitet krejt të ri.

- ▶ Në këto rrethana duhen marrë në konsideratë programet për transferimin e viktimave.
- ▶ Ofroni mbështetje të përshtatshme për viktimat kur iu duhet të dalin në gjyq, përfshirë:
 - marrjen e masave për hyrjen në dhomat për mbështetjen e viktimave/dhomat e pritjes të dëshmitarëve;
 - marrjen e masave që viktima të shkojë e të shohë gjykatën përpara zhvillimit të gjyqit (në bashkëpunim me shërbimet e gjykatës, nëse ka);
 - marrjen e masave që hetuesi i çështjes ose një oficer i caktuar ta takojë viktimën dhe të qëndrojë me të, nëse është e mundur. Në pamundësi që të bëhet kjo, me viktimën duhet të takohet dhe të qëndrojë një "oficer i marrëdhënieve me dëshmitarët".
 - Në qoftë se asgjë sa më sipër nuk është e mundur, mund t'ia vlejë që të sugjerohet që viktima të shoqërohet nga një shok/shoqe ose pjesëtar i familjes që nuk është dëshmitar për çështjen.

AKTIVITETI 4.3: MBLEDHJA E PROVAVE: VIKTIMA E KRIMIT TË URREJTJES – VLERËSIME SPECIFIKE PËR PERSONAT TRANSGJINORË (60 MINUTA)

Materialet e nevojshme:

Letër për tabelën me fletë të lëvizshme, stilolapsa
Prezantimet 4.3a dhe 4.3b

Në këtë aktivitet përfshihet një prezantim nga trajnuesit (ndoshta krahas një prezantimi nga një OSHC, që përqendrohet tek çështjet e transgjitorëve, apo prezantimi i një materiali të përshtatshëm në video për jetën e personave transgjitorë), që përmbledh krime për shkak të urrejtjes ndaj personave transgjitorë dhe praktika të mira të policimit, diskutime në grupe të vogla dhe diskutimin në seancë plenare nën drejtimin e moderatorëve.

Në fillim të prezantimit, pjesëmarrësve u duhet kërkuar që gjatë prezantimit të marrin shënime lidhur me pikat kryesore në të cilat ngrihen këto çështje:

1. Çfarë i bën personat transgjitorë veçanërisht të cenueshëm nga krimi?
2. Çfarë mund të bëjë policia për t'u dhënë mbështetje personave transgjitorë viktimë të krimit?

Këshillë për trajnuesin: Kur është e mundur, duhen ftuar OSHC-të lokale për personat transgjitorë ose LGBTI që të bëjnë një përmbledhje të plotë të përvojave të personave transgjitorë, përvojës së tyre si viktimë dhe të japë këshilla për mënyrën më të mirë se si mund të ndërveprojnë me to zyrtarët publikë. Kur kjo nuk është e mundur, duhet marrë në konsideratë përdorimi i videove.

Ekziston një mori faktorësh lidhur me dhënien e mbështetjes viktimave transgjitorë, dhe prezantimi 4.3a përmban një listë të hollësishme, por jo shteruese të çështjeve që duhet të marrin në konsideratë oficerët e policisë kur hyjnë në kontakt me persona transgjitorë në cilësinë e tyre si persona zyrtarë. Prezantimi 4.3b mund të bëhet përpara pjesëmarrësve për t'i asistuar që të përqendrohen në pyetjet kryesore lidhur me aktivitetin.

PREZANTIMI 4.3A: Mbledhja e provave: Viktimat e krimeve të urrejtjes – Vlerësim specifik për personat transgjnorë

Informacioni që jepet më poshtë përmbledh disa udhëzues dhe praktika të mira për ndërveprimin profesional dhe mbështetës të policisë me viktimat transgjnore të krimit. Një numër çështjesh lidhen edhe me personat Intersex.

1) Identiteti gjinor dhe zbatimi i ligjit

Siç është parashtruar më parë, viktimizimi që pësojnë personat transgjnorë renditet në nivele të larta në një sërë fushash të krimit, përfshirë dhunën seksuale dhe vrasjen me paramendim. Nivelet e viktimizimit janë më të larta në rastin e disa nëngrupeve, si: personat transgjnorë nga pakicat etnike dhe personat transgjnorë në moshë të re. Duke patur parasysh nivelet e larta të stigmës sociale dhe viktimizimit penal, reagimi me profesionalizëm në rastin e personave transgjnorë duhet të jetë prioritet për zbatimin e ligjit.

Në shumë vende, personat transgjnorë, sidomos ata që përfshihen në punë seksi, shpeshherë, përballen me diskriminim nga ana e oficerëve të policisë, gjë që mund të minojë besimin dhe ta bëjë më të vështirë që ata të bëjnë kallëzim për krimet ku ato janë viktima. Manifestimi i **profesionalizmit** dhe **respektimi i identitetit** të viktimës transgjnore të krimit është me rëndësi thelbësore në qoftë se oficerët e policisë duhet të bëhen të aftë për t'i ofruar efektivisht mbështetje dhe për t'i shërbyer këtij komuniteti të cenueshëm të pakicës.

2) Menaxhimi i kuriozitetit

Oficerët e policisë mund të mos kenë patur ndërveprim me një person transgjnor përpara ndërveprimit të tyre me një viktimë transgjnore të krimit. Meqenëse, shpeshherë, oficerët e policisë janë për nga natyra njerëz kureshtarë, oficerët e policisë mund të kenë pyetje lidhur me mënyrën e jetesës, fiziologjisë dhe psikologjisë së personit transgjnor. Është me rëndësi të mbahet parasysh se jo të gjithë personat transgjnorë janë zëdhënës të komunitetit të tyre. Gjatë gjithë jetës së tyre, personat transgjnorë ndeshen rëndom me dyshime dhe paragjykime. Nuk është e nevojshme që policia t'u krijojë situata stresuese, duke u bërë pyetje që nuk lidhen me ndërveprimin e tyre profesional me viktimën. **Përgjegjësia kryesore e oficerëve të policisë është që t'i përmbahen rolit të tyre profesional dhe të bëjnë vetëm pyetje që lidhen me hetimin në fjalë.**

Kur bëjnë një hetim, oficerët e policisë duhet të jenë të vetëdijshëm për akuzën penale që po përpiqen të vërtetojnë, dhe informacionin e nevojshëm për të siguruar prova për motivin paragjykses. Mund të jetë me rëndësi që t'i referohen viktimës që është transgjnore, kur vërtetohet një incident për shkak të urrejtjes ndaj personave transgjnorë. Sidoqoftë, mund të mos jetë e nevojshme që të sigurohen prova lidhur me elemente më personale të procesit të tranzicionit, përfshirë çështjet lidhur me historinë fizike/anatomike e personit. **Në qoftë se informacioni nuk përmban prova lidhur me krimin apo qëndrime të njëanshme, mos e bëni pyetjen.**

Shpeshherë, personat transgjnorë mund të ndeshen me reagime kritike nga ana e familjes, miqve dhe komunitetit më gjerë. Kur mbërrijnë në rajonin e policisë, pasi kanë qenë viktima të krimit, është me rëndësi thelbësore që ata të mos përballen me paragjykime të mëtejshme nga ana e policisë. Sigurohuni që shprehjet e fytyrës tuaj janë asnjansë dhe mbani qëndrim profesional gjatë të gjithë kohës. Gjuha duhet të jetë asnjansë, teknike dhe jokritike. Një oficer policie profesionist ka rolin që të jetë mbështetës dhe mirëkuptues. **Viktimizimi i dytë mund të ndodhë në qoftë se viktima ndihet sikur po kalon nëpër një proces të dytë paragjykses/diskriminues, pasi ka filluar ndjekja penale.**

2a) Konfidencialiteti

Oficerët e policisë kanë përgjegjësinë profesionale që, kur hetojnë çështje penale, të ruajnë konfidencialitetin. Shpeshherë, personat transgjnorë janë të rezervuar lidhur me të kaluarën e tyre ose, për një mori arsyesh, e bëjnë jetën pa iu referuar të qenit transgjnorë (d.m.th., si mashkull ose si femër në rolin e tyre të ri). Dhënia e këtij informacioni palëve të treta paraqet rrisje të konsiderueshme për mbrojtjen dhe mirëqenien e individit. Gjithashtu, kjo gjë mund të shkaktojë probleme për sa u takon marrëdhëniet e tyre me familjen dhe miqtë, si dhe statusin e punësimit. Oficerët e policisë kanë përgjegjësi që informacionin personal ta mbajnë konfidencial. Gjithashtu, duhet marrë në konsideratë legjislativonin mbi mbrojtjen e të dhënave, kur ekziston. Kjo gjë është me rëndësi të veçantë në qytete dhe qyteza më të vogla ku është më vështirë të ruhet anonimiteti.

Roli që përcaktohet më sipër duhet vlerësuar bashkërisht me riskun që hollësitë e çështjes penale arrijnë në media përmes daljes në gjiq apo ndryshe. Viktimës duhet t'i thuhet se cilat janë rrisjet, në mënyrë që viktima të arrijë të marrë një vendim të mbështetur tek informacioni se si të vazhdojë më tej. *Ky informacion*

asnjëherë nuk duhet përcjellë në një mënyrë që viktimë të ndiejë sikur po përpriqen ta bindin që të mos bëjë ankesë. Së fundi, **asnjëherë mos bëni premtime që nuk mund t'i mbani lidhur me konfidencialitetin**, me qëllim që të ndikoni tek dikush që të paraqesë ankesë penale.

2b) Kushtet mbështetëse

Kur viktimë është veçanërisht e shqetësuar dhe, sidomos, kur marrëdhëniet ndërmjet komunitetit transgjinnor dhe policisë janë të vështira, mund të jetë me vend që **personi transgjinnor viktimë e krimit të pyetet nëse dëshiron të ketë të pranishëm ndonjë shok/shoqe apo pjesëtar të familjes**. Ky person nuk duhet të jetë dëshmitar për çështjen. Gjithashtu, mund të jetë e dobishme që denoncimi të merret në një vend asnjanes, si: një qendër komuniteti apo shtëpia e viktimës. Politika dhe legjislati vendas mund të kenë impakt në këtë dhe, kur merren të tilla vendime, duhen marrë në konsideratë politika dhe legjislati i përshtatshëm.

3) Përdorimi i përemrave

Siç diskutohet tek Moduli i Parë, përemrat janë mënyrat si u referohemi njerëzve – përdorimi i emrave të një personi dhe fjalë, si: ai ose ajo, i tij apo i saj. Normalisht, përemrat janë specifike sipas gjinisë dhe duhen përdorur në mënyrë të përshtatshme gjatë ndërveprimit me personat transgjinnorë.

Në qoftë se përfshihen në një ndërveprim të shkurtër me një person transgjinnor, më e mira mund të jetë që të shmangni përdorimin e përemrave, kur është e mundur, dhe të vazhdoni. Në qoftë se përfshirja juaj është më e gjatë sesa një angazhim i shkurtër, duhet **të pyesni personin çfarë përemri preferon që të përdoret/ si preferon që t'i drejtohen**.

Në qoftë se konstatooni se po përdorni përemrin e gabuar, gjëja më e mirë është që të kërkoni menjëherë ndjesë dhe të vazhdoni. Zgjatja në këtë temë mund të jetë e sikletshme për këdo, ndërsa gjithë e gjithë mjafton pranimi shkurtimisht i gabimit.

Është me rëndësi të vihet në dukje se disa persona transgjinnorë nuk identifikohen si mashkull apo femër. Ata identifikohen si *jo të dyfishtë*. Sipas personave jo të dyfishtë, përemra, si: ata/atyre/i tyre (në vend të ajo/asaj/i saj), janë përemrat e përshtatshëm që duhen përdorur për personat transgjinnorë jo të dyfishtë.

Përdorimi i qëllimshëm i përemrit të gabuar konsiderohet fyes dhe mund të shkaktojë lëndim të konsiderueshëm. Përdorimi nga ana e oficerëve të policisë i përemrave korrekte dhe pyetjet e një natyre konfidenciale për përemrat e preferuar tregojnë kompetencë kulturore dhe krijojnë besim.

4) Emri ligjor

Shumë vende nuk kanë ligje që të parashikojnë që personat ta ndryshojnë emrin e tyre me qëllim që të përkojë me gjininë e tyre të preferuar. Në rrethana të tjera, një person transgjinnor mund të mos jetë në gjendje që ta ndryshojë emrin ligjërisht, edhe sikur të lejohet nga shteti. Kjo mund të krijojë një mori vështirësish, sidomos, në marrëdhënie me oficerët e policisë, të cilët janë të trajnuar dhe me përvojë në shqyrtimin e dokumenteve të identitetit.

Mund të jetë e nevojshme që oficerët e policisë të përdorin emrin e ligjshëm/të lindjes të personit, që mund të mos përputhet me gjininë e preferuar të personit. Kur ekziston kjo kërkesë ligjore, **është me rëndësi që të shpjegohen arsyet pse, kur dhe ku do të përdoret emri** (formularë, denoncime, dokumente gjyqate dhe mjekësore etj.). Megjithatë, kur është e mundur, gjatë ndërveprimit me të oficeri i policisë duhet t'i referohet emrit dhe gjinisë që preferon personi.

Kur merrni një deklaratë ankimore me shkrim, pranoni identitetin e dëshmitarit dhe emrin dhe përemrat e preferuar prej tij dhe përdorini kur ndërveproni me të. Në deklaratë, filloni duke dhënë *emrin dhe gjininë ligjore të dëshmitarit* dhe se ai identifikohet si *emri dhe gjinia e preferuar*. Specifikoni se dëshmitarit të njohur ligjërisht si (emri ligjor) në vijim ju do t'i referoheni si (emri i zgjedhur). Pasi kjo gjë sqarohet në deklaratë, gjatë gjithë deklaratimit/kallëzimit ju duhet të vazhdoni të përdorni identitetin dhe përemrat e preferuar të personit.

Nuk duhen kërkuar dokumente për të vërtetuar identitetin/gjininë, përveç kur ligjërisht është e nevojshme për një qëllim specifik.

5) Ndjeshmëria trupore

Dhuna seksuale është një krim që e lë viktimën të dëmtuar fizikisht dhe emocionalisht. Kjo është veçanërisht e vërtetë për persona, të cilët mund të kenë sfida të tjera të përballimit të vështirësive me trupin e tyre. Shumë persona transgjinnorë mund të jenë të anktshëm për pjesë të trupit të tyre, çka i bën ata që të ngurrojnë që të diskutojnë për to. Kjo e bën edhe më të rëndësishëm krijimin e besimit.

Kur është e nevojshme që të bëhet ekzaminim mjeko-ligjor seksual, procedurat duhet t'i shpjegohen viktimës paraprakisht, në mënyrë që viktima të ketë informacion të mjaftueshëm që të marrë vendim se si do të vazhdojë më tej. Në raste të tilla duhen respektuar vendimet e viktimës.

6) Dhuna në familje

Nganjëherë, urrejtja ndaj personave transgjnorë dhe turpi, që mbahen përbrenda, mund të sjellin si rezultat vetëvlerësim të ulët. Për disa persona transgjnorë, një marrëdhënie mund të konsiderohet më mirë se asnjë. Kjo krijon terren të favorshëm për abuzim në familje.

Oficerët e policisë duhet të jenë të vetëdijshëm se personi që shoqëron një viktimë të dhunës në familje mund të jetë abuzuesi. Në këto rrethana, mund të jetë me vend që viktima të veçohet për pak kohë nga partneri/partnerja dhe t'i bëhen pyetje, si: A ndiheni i/e mbrojtur në shtëpi? A ju godet, lëndon apo kërcënon ndokush që bën pjesë në jetën tuaj? A ekziston ndonjë arsye pse mund të ndiheni në siklet apo pse mund të mos jeni në gjendje që t'u përgjigjeni hapur pyetjeve në prani të shoqëruesit/shoqërueses tuaj?

7) Familja

Mund të dalë e nevojshme që policia të hyjë në kontakt me familjen e viktimës, sidomos, në qoftë se viktima ka humbur, ka vdekur ose nuk gjendet. Përpikuni që të vlerësoni në bazë të perceptimit tuaj nivelin e pranimit nga ana e familjes dhe të identifikoni sa/në qoftë se familja dëshiron që të përfshihet në dhënien e mbështetjes për hetimin. Këtu mund të përfshihet që familja të pyetet nëse ka interes që të flasë me mediat.

Familja mund të mos e pranojë gjininë e re të pjesëtarit të saj dhe këtë mund ta konstatojë vetë duke përdorur hollësi/përemra të mëparshëm gjatë marrëdhënieve me të. Mund të dalë e nevojshme që të zhvillohen dy lloje bisedash: një me familjen dhe një me viktimën.

Familja e viktimës mund të mos e ketë idenë e çështjeve transgjnore dhe, në raste të caktuara, mund të jetë me vend që të merren masa që familja të marrë informacion lidhur me këtë temë dhe që familjes t'i ofrohen shërbime për mbështetjen e viktimave.

8) Ndalimi i personave transgjnorë

Në qoftë se del e nevojshme që të arrestohet një person transgjnor, policisë do t'i duhet që të vlerësojë me kujdes masat për ndalimin e tyre. Forcat policore në pjesën më të madhe nuk kanë ndonjë politikë lidhur me personat transgjnorë që mbahen të ndaluar. Strehimi në strukturat e burgut e një personi transgjnor bashkë me persona me gjininë e tyre ligjore/të lindjes mund të jetë i rrezikshëm. Ndërsa janë të burgosur, personat transgjnorë rrezikojnë ngacmimin, dhunën dhe dhunën seksuale.

Në rast të ndalimit në një periudhë afatshkurtër, kur është e mundur, personi transgjnor duhet të mbahet me vete. Për ndalime në periudha afatgjata këshillohet të identifikohet një mënyrë për strehimin e të burgosurit me gjininë e vet të preferuar. Çështja më e rëndësishme është siguria e të burgosurit.

Përveç ndalimit në një periudhë afatshkurtër, policia duhet të interesohet për ndonjë mjekim gjatë periudhës tranzitore për të siguruar shëndetin e të burgosurit gjatë ndalimit.

9) Çështje specifike për personat Intersex

Edhe brenda një harku të shkurtër kohor si në rastin e 24 orëve, personat Intersex mund të kenë nevoja mjekësore. Për shembull, mund të nevojitet menaxhimi i kortizolit për parandalimin e humbjes së kripërave apo mund të nevojitet ajri i kondicionuar për të parandaluar mbinxehjen trupore.

Shumica e personave, të cilët janë në terapi për zëvendësimin e hormoneve për shkak të gonadektomive në fëmijëri, përgjithësisht, mund të durojnë deri 24 orë pa marrë hormone. Do të jetë e nevojshme që të merren masa menjëherë pas 24 orëve dhe, gjithashtu, duhet marrë parasysh sa kohë ka kaluar ndërmjet marrjes së dozës së fundit dhe ndalimit të personit.

Personat Intersex, të cilët janë me transplante apo injeksione, përgjithësisht, nuk kanë nevojë t'i marrin hormonet në një periudhë afatshkurtër. Sidoqoftë, ata mund të kenë nevojë për një infermiere të kualifikuar për injeksionet ose një mjek të kualifikuar për transplantet.

Në disa grupe brenda "ombrellës" ndërgjinore, ekziston rreziku i madh i osteoporozës për shkak të keqadministrimit të hormoneve në vitet e mëparshëm. Në disa raste, individët mund të kenë pësuar thyerje dhe fraktura të shumëfishta, që do të thotë se kockat e tyre mund të thyhen shumë lehtë. Është me rëndësi thelbësore që këto çështje të përfshihen në një vlerësim mbështetës dhe të plotë të nevojave.

PREZANTIMI 4.3 B: PYETJE QË DUHEN MBAJTUR PARASYSH

1. Çfarë i bën personat transgjnorë veçanërisht të cenushtëm nga krimi?

2. Çfarë mund të bëjë policia për të mbështetur viktimat transgjnore të krimit?

AKTIVITETI 4.4: MBLEDHJA E PROVAVE: TREGUESIT E PARAGJYKIMIT – TË PROVOSH MOTIVET PARAGJYKUESE (30 MINUTA)

Ky aktivitet përmbledh një prezantim në seancë plenare, punë individuale dhe diskutimin në grup nën drejtimin e moderatorëve.

Materialet e nevojshme:

Prezantimet 4.4a dhe 4.4b.

- 1) Tema e treguesve të qëndrimeve paragjyquese duhet trajtuar duke përdorur informacionin që jepet në fillim të prezantimit 4.4a.
- 2) Prezantimin 4.4a duhet ta marrë në dorë çdo pjesëtar i grupit dhe secilit prej tyre duhet t'i kërkohet që, në secilën prej kolonave, të hedhë në letër sa më shumë shembuj treguesish të qëndrimeve dhe motiveve paragjyquese që mund të mendojë.
- 3) Më pas, rezultatet duhen krahasuar në një diskutim në grup, duke përdorur shembujt që jepen tek prezantimi 4.4b me qëllim identifikimin e ideve apo treguesve të rinj që mund të jenë nënvlerësuar.

PREZANTIMI 4.4A: USHTRIM PËR TREGUESIT E PARAGJYKIMIT (NJËANSHMËRISË)

Treguesit e qëndrimeve apo bindjeve paragjyquese

Siç parashtrohet në modulet e mëparshme, krimet e urrejtjes përkufizohen si **akte kriminale** shoqëruar me një **motiv apo qëndrim paragjyques**.

Oficerët e policisë kanë përvojë në identifikimin dhe mbledhjen e provave për vërtetimin e **akteve kriminale**. Për të mbështetur mbledhjen e provave lidhur me krimet, çdo vepër penale parashikohet në Kodin Penal. Ndër këto përkufizime përfshihen "faktet" që duhet të disponohen me qëllim që të kalohet tek arrestimi/ngritja e akuzës/ndjekja penale për një vepër penale.

Kur hetohet për krime për shkak të urrejtjes, kërkohen prova për të vërtetuar një element/fakt shtesë: praninë e **motivit / qëndrimit paragjyques**. Motivimi është disi subjektiv dhe mund të jetë e vështirë për ta përkufizuar saktë. Ekziston një numër faktorësh që mund të përdoren për të identifikuar motivin paragjyques, disa dukshëm më të fortë se të tjerët. Këta faktorë mund të kategorizohen për efekt përdorimi nën këto tituj:

1. Perceptimi i viktimës ose i dëshmitarit
2. Komente, deklarime me shkrim dhe gjeste
3. Përfshirja e grupeve të organizuara që nxisin urrejtjen apo e anëtarëve të tyre
4. Vendndodhja dhe periudha kohore
5. Modele apo frekuenca e krimeve ose incidenteve të mëparshme
6. Natyra e dhunës
7. Mungesa e motiveve të tjera

Duke patur parasysh natyrën subjektive të motiveve, si dhe faktin që disa tregues do të jenë më të fortë se të tjerët, mund të jetë e nevojshme që të ngrihet një çështje duke përdorur një kombinim treguesish të paragjyqeshmërisë. Në disa raste, ndërsa mund të ketë një tregues të pranishëm, mund të mos jetë e mjaftueshme që të vërtetohet se incidenti është krim për shkak të urrejtjes dhe, për këtë arsye, rasti mund të trajtohet si një akt standard kriminal. Nëse rasti është ose jo në të vërtetë krim për shkak të urrejtjes, është çështje që do ta vendosë prokurori, mbi bazën e fakteve që paraqet policia. Kështu, është me rëndësi thelbësore që policia të mbledhë dhe t'i paraqesë prokurorit gjithë provat në dispozicion dhe të mos vendosë vetë se krimi nuk është krim për shkak të urrejtjes, në qoftë se provat tregojnë se mund të jetë.

Është me rëndësi që të vihet në dukje se, edhe pse viktimat mund të mos jetë person LGBTI, fakti që agresorët përzgjedhën viktimën *duke e menduar të tillë*, e bën veprën kriminale krim për shkak të urrejtjes. Ajo që ka rëndësi është *motivimi i autorit të veprës kriminale*, jo orientimi seksual apo identiteti gjinor i viktimës.

Çdo rast do të duhet të merret në analizë mbi bazën e fakteve në dispozicion. Duhet bërë kujdes që të kërkohet për fakte ose raste devijuese, kur autorët e veprës kriminale me qëllim fshehin motivin e urrejtjes.

Për t'i kuptuar më mirë treguesit e paragjyqimit, lexoni këtë skenar dhe merrni në analizë përgjigjet e pyetjeve a-d.

Skenari:

Një çift gej largohet nga një lokal për persona gej në qendër të qytetit në orën 2 pas mesnate. Dalja e lokalit është në një rrugicë anësore ku nuk ka shumë dritë. Në fund të rrugicës, qëndron një bandë të rinjsh. Kur çifti i gej kalon përpara tyre, të rinjtë i sulmojnë dhe i rrahin, duke i goditur me grushte dhe me shkelma ndërsa ata ndodhen të shtrirë për tokë. Teksa janë duke i sulmuar, banda i quan ata "pederastë" dhe "plehra". Më pas, pjesëtarët e saj largohen me vrap. Një dëshmitar i telefonon policisë.

a) A ka ndodhur një vepër kriminale?

Po, dhunë e rëndë apo rrahje (përdorni përkufizimin lokal të veprës penale).

b) A demonstron qëndrimi paragjyques në skenarin e dhënë më sipër?

Po, motivi paragjyques kundër personave LGBTI u demonstrua në një sërë mënyrash:

Vendndodhja: Ngjarja ndodhi kur burrat dolën nga një vendndodhje për personat LGBTI (bari për persona gej).

Periudha kohore: Ndodhi në një kohë kur personat LGBTI priteshin që të largoheshin nga ajo vendndodhje.

Komente: Gjatë sulmit u bënë komente homofobike (“pederastë” dhe “plehra”).

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: Dy viktimat ishin burra gej.

c) Për çfarë provash të tjera mund të vihet policia në kërkim?

Vlerësimi i mësipërm bëhet mbi bazën e informacionit të kufizuar që është në dispozicion tek shembulli. Hetime të mëtejshme nga policia mund të japin informacione, si:

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: Viktimat mund ta perceptojnë se ishin vënë në shënjestër pasi ishin gej. Dëshmitari mund ta ketë perceptuar sulmin si sulm të natyrës homofobike.

Mungesa e motiveve të tjera: Mund të ketë mungesë motivesh të tjera (sulm i paprovokuar, asgjë nuk u vodh, etj.).

Anëtarësia e grupeve që nxisin urrejtjen: Për sa u takon të dyshuarve, në qoftë se identifikohen, mund të bëhet lidhje me grupet që nxisin urrejtjen. Mund të ketë afishime në mediat sociale për sulmin.

Modele/frekuenca e krimeve të ngjashme: A kanë ndodhur akte të ngjashme dhune në të njëjtën zonë, në orare të ngjashme apo me mënyra të ngjashme të vepruari?

d) A është ky krim për shkak të urrejtjes?:

Incidenti është një krim për shkak të urrejtjes, meqenëse ai përbën veprë kriminale me motiv paragjykses.

Treguesit e krimeve të urrejtjes ndaj personave gej dhe transgjiorë.

Përdorni kohën që ju mbetet në dispozicion për të parashtruar disa nga treguesit e paragjytimeve që do t'u jepnin hetuesve të çështjes prova se ka ndodhur një krim për shkak të urrejtjes ndaj personave gej/transgjiorë:

Perceptimi i viktimës ose i dëshmitarit

Komente, deklarime me shkrim dhe gjeste

Përfshirja e grupeve të organizuara, që nxisin urrejtjen, apo e anëtarëve të tyre

Vendndodhja dhe periudha kohore

Modele apo frekuenca e krimeve ose incidenteve të mëparshëm

Natyra e dhunës

Mungesa e motiveve të tjera

PREZANTIMI 4.4B: TREGUESIT E QËNDRIMEVE DHE MOTIVEVE PARAGJYKUESE PËR SHKAK TË URREJTJES HOMOFBIKE DHE TRANSFOBIKE

Bazuar në përkufizimin e krimeve të urrejtjes, krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI janë krime që motivohen nga njëanshmëria ose paragjykimi ndaj personave lezbike, gej, biseksualë, transgjjinorë dhe Intersex. "Motivi paragjykues kundër personave LGBTI" do të thotë se autori i veprës kriminale e ka zgjedhur objektivin e krimit mbi bazën e orientimit seksual të këtij të fundit apo identitetit gjinor aktual ose të dallueshëm të këtij të fundit. Objektivi mund të jetë një person a persona ose pronë që, me të drejtë ose jo, lidhen me komunitetin LGBTI.

Është me rëndësi shumë të madhe që të identifikohen treguesit paragjykues të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, meqenëse kjo do t'i ndihmojë autoritetet përkatëse që të vendosin nëse çështja në fjalë duhet hetuar si krim i mundshëm për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI.

Më poshtë jepet një listë jo shteruese e treguesve të qëndrimeve të njëanshme dhe paragjyquese

Perceptimi i viktimës ose i dëshmitarit

- ▶ A e perceptoi viktimën ose dëshmitarin se akti kriminal që ndodhi ishte i motivuar nga paragjykimet kundër personave LGBTI? (Vini në dukje se viktimën mund të mos e kuptojë se ka qenë viktimë e një krimi me motive paragjyquese. Gjithashtu, viktimën mund të ketë dëshirë që ta mohojë se ai ka qenë krim me motive paragjyquese, meqenëse viktimën mund ta mohojë se personat LGBTI janë pjesë e komunitetit të tij.)
- ▶ Një pjesë e konsiderueshme e komunitetit, ku ndodhi krimi, e perceptoi se incidenti ishte i motivuar nga anshmëria.
- ▶ A ishte viktimën me një partner të të njëjtit seks në kohën e ngjarjes? A ishin zënë ata për dore apo po putheshin? A mbanin distinktivë/shirita/veshje (ngjyrë ylberi/rozë apo me trekëndësha të zinj) të paradës së krenarisë apo të tjera tipike për personat LGBTI?
- ▶ A ishte angazhuar viktimën në aktivitete që nxisnin të drejtat/shërbimet/çështjet e personave LGBTI në kohën e ngjarjes?
- ▶ A ishte viktimën dukshëm i identifikueshëm si person LGB ose person T për shkak të veshjes, sjelljes apo paraqitjes?
- ▶ A është viktimën figurë publike, e cila njihet se është person LGBTI apo mbështet të drejtat e personave LGBTI (haptas viktimën mund të jetë heteroseksual, por mund të mbështesë kauzat e personave LGBTI dhe, kështu, bëhet viktimë e krimit me motive paragjyquese kundër personave LGBTI)?

Komente, deklarime me shkrim dhe gjeste

- ▶ A përdori autori i veprës kriminale gjuhë apo terminologji të urrejtjes ndaj personave gej/transgjjinorë ndërsa kryente krimin?
- ▶ A iu referua autori i veprës kriminale orientimit seksual, statusit transgjjinor apo identitetit gjinor të dallueshëm të viktimës?
- ▶ A bëri autori i veprës kriminale deklarime me shkrim me bazë urrejtjen ndaj personave gej ose transgjjinorë, apo a iu referua ai me shkrim orientimit seksual/identitetit gjinor të dallueshëm (ndoshta në një postë elektronike/letër/në një adresë të lidhjes në rrjete sociale)?
- ▶ A përdori autori i veprës kriminale gjeste me duar që tregonin orientim seksual të dallueshëm?
- ▶ A mbetën në vendngjarje grafitet me bazë urrejtjen ndaj personave gej/transgjjinorë?

Përfshirja e grupeve të organizuara që nxisin urrejtjen apo e anëtarëve të tyre

- ▶ A u identifikua autori i veprës kriminale si pjesë e ndonjë grupi të organizuar që nxit urrejtjen?
- ▶ A shfaqti autori i veprës kriminale nëpërmjet veshjes apo tatuazheve të veta ndonjë shenjë të përkatësisë në ndonjë grup të organizuar që nxit urrejtjen?
- ▶ A identifikohet autori i veprës kriminale përmes internetit, mediave sociale etj., me ndonjë grup që nxit urrejtjen?
- ▶ A është autori i veprës kriminale i njohur për mbajtjen e fjalimeve me gjuhë urrejtjeje apo për mbajtjen e fjalimeve ose bërjen e komenteve me gjuhë urrejtjeje ndaj personave gej/ transgjjinorë (me shkrim ose me gojë)?
- ▶ A mori përgjegjësi për dhunën ndonjë grup që nxit urrejtjen?

Vendndodhja dhe periudha kohore

- ▶ A ndodhi dhuna gjatë ndonjë aktiviteti të rëndësishëm LGBTI (p.sh.: Parada e Krenarisë)?
- ▶ A ndodhi dhuna në një kohë me domethënie politike për personat LGBTI të zonës (kalimi i ligjeve për të drejtën martesore të barabartë, hapja për herë të parë në një qytet e një bari të ri për personat LGBTI apo mbajtja e paradës së parë të krenarisë të personave gej)?
- ▶ A ndodhi vepra kriminale në afërsi të një godine/lokali/qendre që shërben për personat LGBTI?
- ▶ A ndodhi vepra kriminale në një zonë që njihet si vend takimi i personave LGB ose T?
- ▶ A ndodhi vepra kriminale në ndonjë vendndodhje që njihet si mjedis publik ku bëhen propozime për takime seksuale/zonë publike për gjuajtjen e partnerëve seksualë?
- ▶ A ndodhi incidenti në afërsi të ndonjë vendndodhjeje që përdoret nga grupe ekstremiste/që nxisin urrejtjen?
- ▶ A ka qenë vendndodhja historikisht një vend takimi i personave LGBTI, edhe sikur tani të mos jetë?

Modele/frekuenca e krimeve apo incidenteve të mëparshëm

- ▶ A ka ndodhur vepra kriminale në një vendndodhje ku ka patur ngjarje të mëparshme ose në orare të ngjashme?
- ▶ A ekziston ndonjë model i llojit të veprës kriminale/graftëve/dhunës ndaj pjesëtarëve të grupit të pakicës?
- ▶ A ka kryer autori i veprës kriminale në të kaluarën e vet vepra kriminale të këtij lloji?

Natyra e dhunës

- ▶ A ishte dhuna/brutaliteti apo dhuna seksuale gjatë sulmit e një niveli të pazakontë, që do të dukej e papranueshme, duke patur parasysh faktet e çështjes?
- ▶ A u përqendrua dhuna tek organet gjinore apo seksuale?

Mungesa e motiveve të tjera

- ▶ A dështoi agresori që të shfaqte ndonjë motiv financiar apo tjetër gjatë kryerjes së veprës kriminale (p.sh.: asnjë vjedhje gjatë sulmit apo vjedhje të shtëpisë me thyerje)?

AKTIVITETI 4.5: MBLEDHJA E PROVAVE: TREGUESIT E QËNDRIMEVE PARAGJYKUESE – IDENTIFIKIMI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI (30 MINUTA)

Ky aktivitet përmblodh lexime, diskutime në grupe të vogla dhe diskutimin në grup nën drejtimin e moderatorëve.

Materialet e nevojshme:

Prezantimet 4.5a dhe 4.5b

1. Ndajini pjesëmarrësit në grupe të vogla. Përpiquni që t'i ndani njerëzit, të cilët zakonisht punojnë së bashku, dhe të siguroni një përzierje të mirë të gjinive, nëse është e mundur.
2. Shpërndajeni prezantimin 4.5a dhe kërkoni që grupet të ndjekin udhëzimet. Jepuni grupeve 10-15 minuta kohë për të lexuar skenarët. Më pas, ata duhet të trajtojnë çështjet më poshtë:
 - a) Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim
 - b) Identifikojini provat e motivit paragjykses në skenarin e shkruar
 - c) Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?
 - d) Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes
3. Diskutoni konkluzionet e grupeve lidhur me çdo skenar bashkë me prezantimin 4.5b. Mbani shënim treguesit e tjerë të paragjyqeshmërisë që identifikohen nga grupi, por që nuk jepen tek prezantimi.

Këshillë për trajnuesin: Skenari 6 është veçanërisht i vështirë dhe i detyron pjesëmarrësit që ta analizojnë nga afër përkufizimin dhe legjislacionin mbi krimin për shkak të urrejtjes. Mund të jetë e dobishme që, përpara fillimit të seancës së trajnimit, të merrni në analizë skenarin në kontekstin e legjislacionit dhe të kufijve ligjorë vendas.

PREZANTIMI 4.5A: IDENTIFIKIMI I MOTIVEVE PARAGJYKUESE (30 MINUTA)

Skenari 1:

Paraditen e paradës së parë të krenarisë që do të zhvillohet në kryeqytet, një grup djemsh gej në moshë të re po ecin nëpër rrugë drejt një pike takimi. Një nga djemtë ka hedhur supeve një flamur me ngjyrat e ylberit dhe një çift i grupit ishin të kapur për dore. Grupi sulmohet nga një grup naziskinësh, të cilët i godasin me grushte, me shkelma dhe i pështynë.

- Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një akt i kundërligjshëm dhe i dënueshëm (vepër kriminale ose krim)
- Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar
- Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?
- Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes

Skenari 2:

Një zyrë që i përket një politikani vendas, i cili njihet gjerësisht në media për mbështetjen e të drejtave të personave LGBTI, është dhunuar. Pjesa e brendshme e godinës është dëmtuar dhe afshet e fushatës së politikantit janë bojatisur me parulla homofobike. Politikani është heteroseksual. Nuk është vjedhur asgjë.

- Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim
- Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar
- Për çfarë provash të tjera është në kërkim policia?
- Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b)

Skenari 3:

Një grua transgjimore po ecën rrugës, kur i afrohet një burrë, i cili e pështyn dhe i thotë duke bërtitur me zë të lartë se është një "qenie vërtet e neveritshme" dhe se ajo duhej eliminuar. Gruaja nuk njihet me burrin dhe nuk e ka takuar ndonjëherë më parë.

- Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim
- Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar
- Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?
- Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b)

Skenari 4:

Një bandë të rinjsh sulmojnë një burrë në një rrugë kryesore tregtare dhe i vjedhin kuletën, telefonin dhe çantën. Teksa e grabisin burrin, njëri prej agresorëve e shan pederast dhe me emra të tjerë. Burri nuk është gej.

- Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim
- Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar
- Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?
- Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b)

Skenari 5:

Një burrë transgjimor gjendet i vrarë në apartamentin e tij. Burrin e kanë rrahur dhe e kanë goditur me thikë derisa i kanë shkaktuar vdekjen. Trupi është gjymtuar dhe në anusin e tij kanë futur një objekt.

- Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim
- Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar
- Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?
- Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b)

Skenari 6:

Në një faqe në internetit për takime mes personave LGBTI një mashkull 20-vjeçar i propozon një mashkulli gej në moshë më të madhe. Të dy meshkujt takohen në një hotel dhe e kalojnë natën bashkë. I riu fshehurazi i regjistron në celularin e tij të dy duke bërë seks. I riu fillon t'i bëjë shantazh mashkullit më të madh në moshë, duke i thënë se do ta ekspozojë tek familja dhe kolegët e tij nëse nuk i jep para.

- Sigurohuni në qoftë se është kryer një krim
- Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar

- c) Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?
- d) Vendorsni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b)

Skenari 7:

Një person 17-vjeçar intersex, që prezantohet dhe identifikohet si mashkull, ia tregon statusin e vet një shoku shkolle dhe i kërkon që ta mbajë të fshehtë këtë gjë. Të nesërmen, në dhomën e zhveshjes së meshkujve përpara mësimin të fizikulturës, shoku i shkollës bashkë me 5 nxënës të tjerë e rrethojnë viktimën dhe i thonë që t'i ulë pantallonat që të mund "t'ia shohin mirë". Kur ai nuk pranon, djemtë e grupit ia heqin pantallonat, e godasin me grushte dhe e quajnë "të ndyrë" dhe "pederast". Djemtë e grupit e lënë atë në dysheme dhe ia marrin pantallonat dhe mbathjet. Viktima e ka hundën të thyer, ndërsa emocionalisht është mjaft i tronditur nga ngjarja dhe nuk pranon të kthehet në shkollë.

- a. Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim
- b. Identifikoni provat e motivit paragjykes në skenar
- c. Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?
- d. Vendorsni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b)

PREZANTIMI 4.5B: IDENTIFIKIMI I TREGUESVE TË QËNDRIMEVE PARAGJYKUESE (30 MINUTA)

Skenari 1:

Paraditen e paradës së parë të krenarisë që do të zhvillohet në kryeqytet, një grup djemsh gej në moshë të re po ecin nëpër rrugë për tek një pikë takimi. Një burrë ka hedhur supeve një flamur me ngjyrat e ylberit dhe një çift i grupit ishin kapur për dore. Grupi sulmohet nga një grup naziskinësh, të cilët i godasin me grushte, me shkelma dhe i pështynë.

- Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim – *Po – Sulm*
- Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar

Periudha kohore: Është dita kur në qytet do të zhvillohet parada e parë e krenarisë e personave gej.

Vendndodhja: Djemtë ishin rrugës për tek pika e takimit të paradës së krenarisë.

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: Viktimat ishin të gjithë burra gej. Ata mbanin një flamur me ngjyrat e ylberit që i identifikonte ata si gej. Dy prej tyre ishin kapur për dore.

- Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?

Komente: A përdorën autorët e veprës kriminale gjuhë homofobike gjatë sulmit apo a iu referuan ata orientimit seksual të viktimave?

Përfshirja e grupeve që nxisin urrejtjen: Nëse u identifikuan, a ishin autorët e veprës kriminale pjesëtarë të grupeve që nxisin urrejtjen? A kishin tatuazhe apo veshje që tregojnë anëtarësinë në grupe të tilla?

Modele të krimit: Kontrolli i raporteve të policisë – a kishin ndodhur atë ditë sulme të ngjashme ndaj personave të tjerë LGBTI?

Natyrë e dhunës: Dhuna e përdorur e niveleve të pazakonta/armë etj.

Mungesa e motiveve të tjera: A u grabit grupi gjatë sulmit?

- Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b).

Incidenti është krim për shkak të urrejtjes, meqenëse në të ndërthuret vepra kriminale dhe motivi paragjykues.

Skenari 2:

Është dhunuar një zyrë që i përket një politikani vendas, i cili njihet gjerësisht në media për mbështetjen e të drejtave të personave LGBTI. Pjesa e brendshme e godinës është dëmtuar dhe në afishet e fushatës së politikantit janë bojatisur parulla homofobike. Politikani është heteroseksual. Nuk është vjedhur asgjë.

- Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim – *Po – Hyrje me dhunë dhe shkatërrim i pasurisë*
- Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: Viktima është përkrahës i njohur i personave LGBTI.

Komente, deklaram me shkrim: Parulla homofobike në afishe.

Mungesa e motiveve të tjera: Nuk ishte vjedhur asgjë.

- Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?

Përfshirja e grupeve që nxisin urrejtjen: Afishimet përmes internetit/në mediat sociale për marrjen përgjegjësinë për krimin.

Periudha kohore: A ishte përfshirë politikani në ndonjë fushatë të rëndësishme të komuniteteve LGBTI në atë kohë?

Modele: A ka ndodhur kjo gjë më parë, apo a ka ndodhur kohët e fundit ndonjë ngjarje tjetër homofobike me politikantin, afishet e tij apo politikanë të tjerë që mbështesin personat LGBTI?

- Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b).

Incidenti është krim për shkak të urrejtjes, meqenëse në të ndërthuret vepra kriminale dhe motivi paragjykues.

Skenari 3:

Një grua transgjimore po ecën rrugës, kur i afrohet një burrë, i cili e pështyn dhe i thotë duke bërëtitur me zë të lartë se është një "qenie vërtet e neveritshme" dhe se ajo duhej eliminuar. Gruaja nuk njihet me burrin dhe nuk e ka takuar ndonjëherë më parë.

- a) Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim – *Po – Dhunë dhe ndoshta shkelje e rendit publik*
- b) Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: *Viktima është person transgjimor – dukshmëria e tranzicionit mund të jetë e rëndësishme në kuptimin që personi transgjimor është lehtësisht i identifikueshëm.*

Komente: *Autori i veprës kriminale e quajti atë qenie të neveritshme, që është një term i pazakontë dhe mund të mbartë kuptime fetare/biologjike.*

Mungesa e motiveve të tjera: *Autori i veprës kriminale dhe viktima nuk njiheshin me njëri-tjetrin.*

Natyrë e dhunës: *Akti i pështyrjes nënkupton ndjenja të forta neverie.*

- c) Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: A mendon viktima se ky ishte një sulm për shkak të urrejtjes ndaj personave transgjimorë? A e percepton ndonjë dëshmitar i pranishëm se sulmi është motivuar nga paragjykimi kundër personave LGBTI?

Vendndodhja: A ekziston në atë zonë ndonjë vend për personat LGBTI nga ku mund të ishte duke ardhur personi/ku ishte duke shkuar personi? A është fakt i njohur që zona frekuentohet nga persona LGBTI?

Modele: A tregon dokumentacioni i policisë se në zonë kanë ndodhur ngjarje të ngjashme në të kaluarën?

- d) Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b).

Incidenti është krim për shkak të urrejtjes, meqenëse në të ndërthuret vepra kriminale dhe motivi paragjykues.

Skenari 4:

Një bandë të rinjsh sulmojnë një burrë në një rrugë kryesore tregtare dhe i vjedhin kuletën, telefonin dhe çantën. Teksa e grabisin burrin, njëri prej agresorëve e shan pederast dhe me emra të tjerë. Burri nuk është gejt.

- a) Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim – *Po – Grabitje*
- b) Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar

Komente: *Gjatë sulmit u përdor fjala pederast.*

- c) Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?

Perceptimi i viktimës: A mendoi viktima se ky ishte një krim homofobik?

Përfshirja e grupeve që nxisin urrejtjen: A ekziston ndonjë provë që të mendohet se kanë qenë të përfshira grupe që nxisin urrejtjen?

- d) Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b).

Nuk ekzistojnë prova të qarta, përveç përdorimit një herë të një termi përçmues, që të vërtetojnë motivin homofobik. Shpeshherë, termat homofobikë përdoren si term i përgjithshëm abuziv dhe nuk janë gjithmonë të drejtuar kundër personave LGBTI.

Skenari 5:

Një burrë transgjimor gjendet i vrarë në apartamentin e tij. Burrin e kanë rrahur dhe e kanë goditur me thikë derisa i kanë shkaktuar vdekjen. Trupi është gjymtuar dhe në anusin e tij kanë futur një objekt.

- a) Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim – *Po – Vrasje me paramendim/Vrasje*
- b) Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: *Viktima është person transgjimor.*

Natyrë e dhunës: *Shihet dhunë e tejskajshme, gjymtim i organeve gjinore, goditje me thikë e viktimës.*

- c) Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?

Komente, deklarime me shkrim: Çdo provë me shkrim në apartament/komente në mediat sociale.

Modele: Prova të mënyrave të ngjashme të të vepruarit në vrasje të tjera me paramendim/akte të tjera dhune të rëndë.

Mungesa e motiveve të tjera: A e kishin grabitur viktimën? A ka patur ndonjë ndodhi me ndonjërin prej njerëzve të përfshirë, që mund ta shpjegonte këtë akt dhune?

d) Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b).

Incidenti është krim për shkak të urrejtjes, meqenëse në të ndërthuret vepra kriminale dhe motivi paragjykues.

Skenari 6:

Në një grup të faqeve të internetit për takime mes njerëzve një mashkull 20-vjeçar i propozon një mashkulligj në moshë më të madhe. Të dy meshkujt takohen në një hotel dhe e kalojnë natën bashkë. I riu fshehurazi i regjistron në celularin e tij të dy duke bërë seks. I riu fillon t'i bëjë shantazh mashkullit më të madh në moshë, duke i thënë se do ta ekspozojë tek familja dhe kolegët e tij nëse nuk i jep para.

- a) Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim – *Po - Shantazh*
- b) Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: *Viktima është gej. Edhe autori i veprës kriminale mund të jetë gej.*

Komente: *Autori i veprës kriminale kërcënon se do ta ekspozojë burrin si gej tek personat, të cilët mund të reagojnë negativisht.*

c) Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?

Modele: Prova të ofendimeve të ngjashme nga mashkulli shantazhist.

d) Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b).

Incidenti është krim për shkak të urrejtjes, meqenëse në të ndërthuret vepra kriminale dhe motivi paragjykues. Ndonëse edhe ai mund të jetë gej, autori i krimit e përzgjedhi viktimën bazuar në orientimin e tij seksual, i vetëdijshëm për avantazhin që mund të përdorte për shkak të paragjykimit të shoqërisë.

Skenari 7:

Një person 17-vjeçar intersex, që prezantohet dhe identifikohet si mashkull, ia tregon statusin e vet një shoku shkollë dhe i kërkon që ta mbajë të fshehtë këtë gjë. Të nesërmen, në dhomën e zhveshjes së meshkujve përpara mësimin të fizikut, shoku i shkollës bashkë me 5 nxënës të tjerë e rrethojnë viktimën dhe i thonë që t'i ulë pantallonat që të mund "t'i shohin mirë". Kur ai nuk pranon, djemtë e grupit ia heqin pantallonat, e godasin me grushte dhe e quajnë "të ndyrë" dhe "pederast". Djemtë e grupit e lënë atë në dysheme dhe ia marrin pantallonat dhe mbathjet. Viktima e ka hundën të thyer, ndërsa emocionalisht është mjaft i tronditur nga ngjarja dhe nuk pranon të kthehet në shkollë.

- a) Sigurohuni në qoftë se ka ndodhur një krim – *Po – Dhunë fizike.*
- b) Identifikoni provat e motivit paragjykues në skenar:

Perceptimi i viktimës/dëshmitarit: *Viktima është interseks dhe u shqetësua thellësisht nga incidenti, duke përjetuar një shkelje të jashtëzakonshme të besimit.*

Komente: *Autorët e krimit përdorën gjuhë armiqësore për trupin dhe organet gjinore të viktimës. U përdor edhe gjuhë homofobike.*

Natyrë e dhunës: *Akti i dhunshëm ishte veçanërisht dashakeq dhe drejtohej ndaj organeve gjinore të viktimës, shoqëruar me zhveshjen e pantallonave dhe të mbathjeve.*

c) Për çfarë provash të tjera mund të jetë në kërkim policia?

d) Vendosni në qoftë se incidenti është krim për shkak të urrejtjes në bazë të pikave a) dhe b).

Incidenti është krim për shkak të urrejtjes, meqenëse në të ndërthuret vepra kriminale dhe motivi paragjykues. Do të bëhen pyetje lidhur me legjislacionin vendas mbi moshën e ndëshkueshmërisë (autorët e krimit ishin adoleshentë) dhe nëse krimet e urrejtjes me objekt karakteristikat seksuale parashikohet nga kuadri aktual ligjor.

AKTIVITETI 4.6A: RËNDËSIA E BESIMIT – REAGIMET NGA ANA E POLICISË DHE KOMUNITETIT LGBTI (30 MINUTA)

Ky aktivitet përmbledh lexime dhe diskutimin në seancë plenare nën drejtimin e moderatorëve.

Materialet e nevojshme:

Prezantimi 4.6

1. Lexoni dy shembujt, siç parashtrohen tek prezantimi 4.6.
2. Kërkoni nga oficerët e pranishëm të policisë që të marrin në shqyrtim çështjet që shtrohen në prezantim.
3. Pyetini oficerët e pranishëm të policisë cili mendojnë se duhet të jetë niveli i besimit ndërmjet komunitetit LGBTI dhe policisë në fushat e punës së tyre.
4. Pyetini oficerët e pranishëm të policisë çfarë mendojnë se do të ndodhte në qoftë se ngjarje të tilla do të ndodhnin javën e ardhshme në qytetin e tyre.
5. Pyetini oficerët e pranishëm të policisë çfarë mendojnë se mund të bënin individualisht dhe si shërbim policor për të përmirësuar nivelin e besimit.

Këshillë për trajnuesin: Mund të ekzistojnë shembuj të tjerë specifikë për vendin/të kohëve të fundit që mund t'i përdorni në vend të shembujve që jepen këtu.

PREZANTIMI 4.6: RËNDËSIA E BESIMIT – REAGIMET NGA ANA E POLICISË DHE KOMUNITETIT LGBTI

Shembujt në vijim bazohen në ngjarje të vërteta dhe tregojnë dy reagime krejt të ndryshme nga ana e policisë ndaj krimeve të ndodhura kundër personave LGBTI. Është bërë një përmbledhje e tyre për të evidentuar çështjet kryesore me qëllim që të nxirren mësimet prej tyre. Ndonëse ato kanë ndodhur në vende të ndryshme gjatë periudhave të ndryshme kohore, përvojat kanë lidhje me temën.

Kryesorja këtu është sensibilizimi se kapacitetet për hetimin në mënyrë efektive të krimeve të urrejtjes rriten ndjeshëm kur ekziston një marrëdhënie pozitive ndërmjet komunitetit LGBTI dhe policisë.

Aktivitetet që ndërmerr policia për krijimin vazhdimisht të besimit e mbështesin policimin e mirë në dy mënyra kryesore.

- ▶ Së pari, ato mund të krijojnë dhe mbështesin fluksin e informacionit dhe shërbimin e inteligjencës në bazë të të cilit oficerët e policisë mund të veprojnë në mënyrë proaktive për të penguar që krimet e urrejtjes, para së gjithash, të mos ndodhin.
- ▶ Së dyti, ato mund të krijojnë ndjenjën e gatishmërisë që njerëzit të paraqiten në polici pasi ka ndodhur një krim, qoftë në cilësinë e viktimës për të bërë kallëzim për ngjarjen, qoftë në cilësinë e dëshmitarit për të dhënë prova mbështetëse.

Merrni në analizë rastet më poshtë dhe, më pas, debatonini për pikat e diskutimit.

Rasti A) Vrasja me paramendim e një burri gej

Një burrë gej i mirënjohur futej në shoqëri me njerëzit në një numër baresh të qendrës së qytetit. Pasi doli nga lokali i fundit, ai shkoi në shtëpi me një burrë që e kishte takuar atë natë. Të nesërmen u gjend në dhomën e tij të ndenjës pasi e kishin goditur në mënyrë të përsëritur me thikë në qafë dhe në gjoks.

Forcat policore përdorën hetimin për krijimin e një banke të dhënash (databazë) për burrat gej në qytet. Burrat gej në qytet morën udhëzimin që të paraqiteshin në rajonin e policisë në qendër të qytetit që të fotografoheshin dhe t'u merreshin gjurmët e gishtërinjve. U fol shumë që policia abuzoi me burrat gej dhe i kanosi për t'i detyruar që të shkonin në rajonin e policisë. Si rezultat i hetimit numri i burrave gej, të cilët u morën në pyetje, u fotografuan dhe u morën gjurmët e gishtave, arriti në afro 1.500.

Mbledhja e informacionit për burrat gej, të cilët banonin në qytet, u ndërpre kur grupe të komunitetit gej ndërmorën veprim ligjor kundër drejtuesve të policisë vendore. Në atë kohë drejtuesit e hetimit vunë re se komuniteti nuk po ofronte mbështetje për hetimin. Çështja nuk u zgjidh asnjëherë.

Rasti B) Shpërthim bombe në një vend të frekuentuar nga persona LGBT

Një ekstremist i djathtë vuri një bombë të bërë me gozhde në një bar të populluar nga persona LGBT. Nga shpërthimi u vranë tre persona dhe u plagosën 70 të tjerë.

Në një takim në mjedis të hapur në një shesh ngjitur që u zhvillua disa ditë pas aktivitetit të organizuar nga grupet LGBT, mori pjesë shefi i policisë lokale, i cili iu drejtua komunitetit LGBTI. Ai tha se në rrugën ku kishte ndodhur shpërthimi i bombës do të vendoste një njësi të lëvizshme policie dhe se kjo njësi do të qëndronte në zonë derisa të mbyllej hetimi.

Personeli i njësisë do të përbëhej nga oficerë policie të deklaruar si persona LGBTI. Shumë persona LGBTI u paraqitën pranë njësisë së lëvizshme dhe bënë denoncime tek oficerët e policisë.

Diskutimi në grup:

Rasti A) Vrasja me paramendim e një burri gej

- ▶ Çfarë do të bënit ju në qoftë se do të ishit ngarkuar me hetimin siç është rasti që parashtrohet më sipër?
- ▶ Cili ishte funksioni kryesor i policisë në këtë rast?
- ▶ Cili ishte impakti i qasjes së policisë ndaj komunitetit LGBTI dhe pjesëtarëve të tij?
- ▶ Cili ishte impakti i qasjes së policisë ndaj hetimit penal?
- ▶ Në qoftë se javën e ardhshme në qytetin tuaj do të ndodhte një vrasje e ngjashme me paramendim, a do të ishit të aftë të gjenit dëshmitarë LGBTI? A do t'i përgjigjeshin ata thirrjes publike për t'u paraqitur dhe për të dhënë informacion në polici?

Rasti B) Shpërthim bombe në një vend të frekuentuar nga persona LGBT

- ▶ Çfarë do të bënit ju në qoftë se do të ishit ngarkuar me hetimin siç është rasti që parashtrohet më sipër?
- ▶ Cili ishte funksioni kryesor i policisë në këtë rast?
- ▶ Cili ishte impakti i qasjes së policisë ndaj komunitetit LGBTI dhe pjesëtarëve të tij?
- ▶ Cili ishte impakti i qasjes së policisë ndaj hetimit penal?
- ▶ Në qoftë se javën e ardhshme në qytetin tuaj do të ndodhte një vrasje e ngjashme me paramendim, a do të ishit të aftë të gjenit dëshmitarë LGBTI? A do t'i përgjigjeshin ata thirrjes publike për t'u paraqitur dhe për të dhënë informacion në polici?

Pikë e përgjithshme për diskutim:

- ▶ Në qoftë se dëshmitarët do të kishin ankth që të jepnin dëshmi në polici, çfarë mund të bëjë policia për të krijuar besim tek komuniteti LGBTI?

AKTIVITETI 4.7: OFRIMI I MBËSHTETJES KOMUNITETIT LGBT – NJË REAGIM EFEKTIV I POLICISË (15 MINUTA)

Ky aktivitet përmbledh një pjesë të shkurtër leximi dhe diskutimin e pikave specifike në grupe të vogla, pasuar nga prezantimi dhe diskutimi në seancë plenare. Gjithë skenarët janë raste reale dhe pasqyrojnë situata që lidhen me policimin dhe komunitetin LGBTI.

Këshillë për trajnuesin: Përpara se të përdorin shembujt më poshtë, trajnuesit duhet të shqyrtojnë skenarët në të cilët mund të përfshihen oficerët e policisë të vendit në fjalë. Rastet dhe pikat për diskutim më poshtë duhen përdorur në rastin më të mirë si një orientim dhe jo të përkthehen drejtpërsëdrejti, përveç kur skenari i përmbush nevojat lokale. Çdo rast që përdoret, duhet hartuar në mënyrë që të ketë lidhje me oficerët e policisë në fjalë, duke përdorur emra lokale, vendndodhje lokale etj. Kjo do të bëjë që rastet të jenë sa më realë që të jetë e mundur për pjesëmarrësit.

Materialet e nevojshme:

Prezantimi 4.7 (ose raste të ngjashme)

Letër, stilolapsa

1. Ndajini pjesëmarrësit në grupe.
2. Çdo grupi jepini detyrën që të lexojë rastin e shkurtër që kanë përpara.
3. Jepini grupit detyrë që të diskutojë dhe të formulojë një përgjigje për pikat e diskutimit në bazë të çdo skenari.
4. Duhet përzgjedhur një pjesëtar i grupit që të mbajë shënim përgjigjet përkatëse.
5. Kthejini pjesëmarrësit në seancë plenare dhe diskutoni rastet dhe çështjet që janë ngritur, duke u përqendruar tek reagimi profesional që kërkohet nga ana e policisë.

PREZANTIMI 4.7: RASTE STUDIMORE

Rasti 1 – Akt dhune në një bar për persona gej

Majkëll është avokat në një firmë ligjore në qendër të qytetit. Bashkë me partnerin e tij Aleksin ai shkon një natë në një bar për persona gej që ndodhet në qendër të qytetit. Ata dalin nga bari në orën 2 pas mesnate. Dalja e barit është në një rrugë kalimi. Në fund të rrugës së kalimit është mbledhur një bandë të rinjsh. Kur Majkëll dhe Aleks kalojnë përpara bandës, pjesëtarët e saj e rrethojnë çiftin dhe i rrahin duke i goditur me grushte. Pjesëtarët e bandës i fyejnë "pederastë". Pasi banda i rrahu paq, të dy burrat kthehen tek dera e barit ku një nga rojet e sigurisë u jep ndihmën e shpejtë.

Aleksi do që t'i telefonojë policisë, por Majkëlli i thotë "jo". Ai ka frikë se hollësitë e këtij rasti do të bëhen publike dhe se do t'i duhet që të shkojë në gjyq, çka mund të bëjë që ai të identifikohet si gej përpara kolegëve, klientëve të mundshëm ose familjes së tij. Majkëll i thotë Aleksit: "Thjesht u ndodh gejve nganjëherë, ç'të bësh – duhet të durojmë".

Rasti 1 -- Pika për diskutim

- ▶ A duhet të bëjnë Majkëlli dhe Aleks kallëzim në polici për sulmin e dhunshëm?
- ▶ Cili është rezultati përfundimtar për çiftin nëse bëjnë kallëzim?
- ▶ Cili është rezultati përfundimtar për policinë nëse merret një kallëzim i tillë?
- ▶ Në qoftë se çifti nuk bën kallëzim për sulmin e dhunshëm, cili është impakti tek: a) çifti, b) komuniteti lokal LGBT, dhe c) policia?
- ▶ Si mund t'i inkurajojë policia njerëzit që të bëjnë kallëzim në polici për ngjarje të tilla?

Rasti 2 (a) – Aktivitet seksual në mjedis publik

Jeni në patrullim në zonën e bregut të detit. Është ora 11 e darkës dhe jashtë ka rënë errësira. Shikoni një makinë në plazh në ndenjësën e pasme të së cilës është një djalë dhe një vajzë. Të dy janë të zhveshur lakuriq nga mesi e poshtë.

Vajza po i bën seks oral djalit.

Rasti 2 (b) – Aktivitet seksual në mjedis publik

Jeni në patrullim në zonën e bregut të detit. Është ora 11 e darkës dhe jashtë ka rënë errësira. Shikoni një makinë në plazh në ndenjësën e pasme të së cilës janë dy djem. Të dy janë të zhveshur lakuriq nga mesi e poshtë.

Njëri djalë po i bën seks oral tjetrit.

Rasti 2 – Pika për diskutim

- ▶ A keni hasur më parë situata si kjo e skenarit B?
- ▶ Si e keni trajtuar/do ta trajtonit një situatë të tillë?
- ▶ A do t'i trajtonit në mënyrë të ndryshme skenarët A dhe B?
- ▶ Cilët janë faktorët që merrni në konsideratë kur përcaktoni rrugën e veprimit në këtë skenar?
- ▶ Në qoftë se hasni një skenar si ai A ose B më sipër dhe do të rezultonte se njëri prej personave të përfshirë do të ishte punëtor seksi që paguhet për takimin seksual: a) cila do të ishte rruga e duhur e veprimit, dhe b) çfarë parashikon legjislacioni?

Rasti 3 – Aktivitet seksual në mjedis publik – Në kërkim të partnerëve për seks dhe dhuna

Riçardi punon si menaxher i mesëm në një kompani të madhe sigurimesh. Është i martuar me tre fëmijë dhe banon në një qytet të vogël provincial. Riçardi merr vesh për një vendndalim në autostradë ku burrat takohen për të bërë takime të shkurtra me partnerë të panjohur seksualë. Riçardi udhëton me makinë drejt këtij vendndalimi dhe vjen rrotull zonës ngjitur me pyllin. Riçardi takon një burrë dhe bashkë me të hyn në pyll për një takim seksual. Pasi hyjnë në pyll, burri e rreh Riçardin derisa e lë pa ndjenja dhe i grabit kuletën dhe telefonin. Nuk kalon shumë dhe Riçardi gjendet i plagosur dhe dërgohet me ambulancë në spitalin lokal, ku vjen në vete. Spitali ka njoftuar policinë që vjen për të marrë kallëzimin.

Rasti 3 – Pika për diskutim

- ▶ Si vepron policia për të mbrojtur të drejtat e individëve për të patur marrëdhënie seksuale në një vend publik, edhe pse mund të jetë shkelje?
- ▶ Në qoftë se Riçardi nuk ia tregon policisë hollësitë e saj që i ndodhi, cilat janë risqet për të dhe publikun? A ekzistojnë probleme se autori i veprës kriminale do ta përsërisë veprën?
- ▶ Pse autorët e veprave kriminale zgjedhin që t'i grabisin dhe ushtrojnë dhunë ndaj njerëzve në këto rrethana?
- ▶ Çfarë çështjesh lidhur me jetën private ngrihen nga ky rast?

Rasti 4 – Shkolla – bullizmi dhe akti i dhunës

Tomasi, 15 vjeç, është nxënës në një shkollë të mesme. Djalë i qetë, studioz, ai nuk ushtron asnjë nga sportet “mashkullore” që praktikohen në shkollë, si: futboll apo basketboll. I konsideruar si “i butë” nga djemtë e tjerë, Tomasin shpeshherë e fyejnë “plehrë”, “pederast” dhe me emra të tjerë përçmues, që nënkuptojnë qenien e tij gej dhe nuk u përshtaten pritshmërive gjinore për një “burrë të vërtetë”. Nxënësit e shkollës së Tomasit marrin vesh se Tomasi është parë në një pikëtakimi për gej në qendër të qytetit.

Të nesërmen në orën sportive Tomasin e rrahin keqas në dhomat e zhveshjes. Ndërsa e rrahin djemtë e fyejnë emra homofobikë dhe kokën ia fusin në WC, që më pas shkarkohet. Tomasi largohet nga shkolla atë ditë dhe nuk kthehet më kurrë.

Rasti 4 – Pika për diskutim

- ▶ A është kjo çështje për policinë?
- ▶ A është përgjegjësi e drejtorisë së shkollës që të mbajë rregull lidhur me sjelljen në shkollë apo policia duhet të luajë ndonjë rol?
- ▶ Cili është impakti i përdorimit të fjalëve homofobike si terma përçmues në shkolla apo në shoqëri më gjerë?
- ▶ Si mund të parandalohen ngjarje të këtij lloji?

Rasti 5 – Vjedhje nga persona që takohen përmes internetit

Xhoni është mësues i shkollës fillore në një qytet të vogël. Ai nuk ka “dalë hapur” si gej përpara familjes apo kolegëve të tij dhe punon për një shkollë që drejtohet nga një institucion fetar. Prindërit e tij janë të moshuar dhe ai kishte vendosur se nuk do të “dilte hapur” si gej derisa ata të ishin gjallë, meqenëse mendon se ata asnjëherë nuk do ta kuptonin. Ai ka shqetësim se qëndrimi i tij në shkollë do të ishte i përkohshëm, nëse punëdhënësit e tij do ta mësonin se ai është gej.

Xhoni përdor një adresë të rrjeteve sociale për gej për të takuar burra të tjerë gej. Një mbrëmje ai fton në shtëpi Alfredin, të cilin e ka kontaktuar përmes internetit. Alfredi e kalon natën aty, por largohet herët në mëngjes. Teksa del ai i merr Xhoni laptopin dhe kuletën. Xhoni i duhet të bëjë kallëzim në polici për humbjen e laptopit që është i shkollës.

Rasti 5 – Pika për diskutim

- ▶ A është e mundur që pala e dëmtuar t'i tregojë faktet e rastit në polici?
- ▶ Çfarë duhet të dijë policia për ta trajtuar me efektivitet rastin?
- ▶ Cili është rezultati i dëshiruar për palën e dëmtuar?
- ▶ Cili është rezultati i dëshiruar për policinë?
- ▶ Çfarë do ta ndihmonte palën e dëmtuar që t'i besonte policisë?
- ▶ A mund ta zgjidhë policia çështjen pa e “eksponuar” palën e dëmtuar?
- ▶ Në çdo çështje penale që heton policia, a është ngritja e akuzës së suksesshme penale rezultati i dëshiruar?
- ▶ Si duhet të veprojë policia për të penguar palën e dëmtuar që të fshehë apo ndryshojë faktet për shkak të frikës së “eksponimit” si gej apo lezbike?

Rasti 6 – Shantazhi

Suzana është lezbike, por asnjëherë nuk ka dalë hapur. Para 16 vitesh u martua me Piterin dhe kanë një fëmijë 14-vjeçar. Ajo ka një marrëdhënie formale me të shoqin, por dëshiron që të qëndrojnë të martuar në interes të djalit. Suzana është punonjëse e lartë civile në një institucion shtetëror.

Një kolege ka zbuluar se ajo është lezbike dhe kërcënon se do t'ia tregojë orientimin e saj seksual të shoqit dhe menaxherëve të saj, nëse Suzana nuk i jep një sasi të konsiderueshme parash. Suzana do që t'ia tregojë policisë për shantazhin, por ka frikë se policia mund të mos e kuptojë situatën e saj. Gjithashtu, ka frikë se policia do t'ia tregojë të shoqit lidhur me situatën e saj.

Rasti 6 – Pika për diskutim

- ▶ A është e mundur që personat LGBT, të cilët janë të izoluar, të jenë viktimat e shantazhit?
- ▶ Pse ndodh kjo?
- ▶ Cilat janë pasojat për Suzanën në qoftë se ekspozohet?
- ▶ A është e mundur që personat, ndaj të cilëve bëhet shantazh, të bëjnë kallëzim për të në polici?
- ▶ Çfarë duhet të bëjë policia për të inkurajuar njerëzit, ndaj të cilëve bëhet shantazh, që të paraqiten në polici?
- ▶ Çfarë përgjegjësie ka policia për të mbrojtur jetën private të Suzanës?

MODULI I REFERENCAVE

Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut (2011), "Përmbledhje me informacione dhe këshilla për ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes: udhëzues për policinë".

ILGA, Projekt raport "Për ngjarje të krimeve të urrejtjes ndaj personave gej dhe transgjnorë".

Byroja Federale e Hetimit (2015), Udhëzues "Për mbledhjen e të dhënave për krimet e urrejtjes" Manual trajnimi.

Franey, P. dhe Del Aguila E. (2012), "Mbështetja për komuniteti LGBT: përmbledhje me informacione dhe këshilla për policinë", Shkolla UCD e Drejtësisë Shoqërore, "G-Force" dhe Shoqata Evropiane e Policëve Gej.

Logar, R. dhe Marvanove Vargova B. (2015), "Bashkëpunim efektiv ndërmjet shumë agjencive për të parandaluar dhe luftuar dhunën në familje" (Këshilli i Evropës).

Koalicioni Kombëtar i Programeve kundër Dhunës dhe Qendra Kombëtare e Viktimave të Krimet. (2010), "Pse ka rëndësi: marrja serioze në analizë e asistencës për viktimat për personat lezbike, gej, biseksualë, transgjnorë dhe personave Queer, viktimat të dhunës për shkak të urrejtjes dhe dhunës nga partnerët intimë".

Qendra Kombëtare për Barazimin e Personave Transgjnorë (2009), "Reagimi ndaj krimeve të urrejtjes: manual i burimeve të komuniteti".

Zyra e Viktimave të Krimet (2014), "Si duhet reaguar ndaj viktimave transgjnore të dhunës seksuale".

Polack, R. dhe LeDeroff, J. (2010), "Përmbledhje me informacione dhe këshilla e 'ILGA-Europe' për trajnimin e oficerëve të policisë lidhur me ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes ndaj personave gej", "ILGA-Europe".

Polack, R. dhe LeDeroff, J. (2010), "Bashkimi i forcave për të luftuar krimet e urrejtjes për shkak të homofobisë dhe transfobisë: bashkëpunimi ndërmjet forcave të policisë dhe organizatave LGBT në Europë", "ILGA-Europe".

Aleanca Skoceze e Personave Transgjnorë (2013), "Identiteti gjinor", udhëzues bazë për "Dhënien e mbështetjes personave transgjnorë" www.scottishtrans.org/resources/.

Stout, B. (2010), "Barazia dhe diversiteti në policim", "Learning Matters Limited", "Exeter".

Moduli i Pestë: Puna me organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të)

HISTORIKU DHE ARSYEJA THEMELORE

Këshilli i Evropës qysh prej kohësh e ka konsideruar shoqërinë civile “një komponent thelbësor të shoqërisë evropiane dhe një element të rëndësishëm dhe të domosdoshëm të demokracisë”.⁶⁰ Përveç që bëjnë vlerësimin e masave për të luftuar racizmin dhe ksenofobinë, Këshilli dhe institucionet e tij, përfshirë Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) dhe Komisionerin për të Drejtat e Njeriut, monitorojnë në mënyrë të posaçme ecurinë në nivel kombëtar me qëllim trajtimin e diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Për përgatitjen e raporteve për vendet dhe vizitave me qëllim vlerësimin e situatës për sa i takon diskriminimit dhe të drejtave të njeriut në shkallë vendi, ata kanë kërkuar dhe janë mbështetur në të dhënat që kanë siguruar OSHC-të. Vëmendje e posaçme i kushtohet analizës së të dhënave për krimin për shkak të urrejtjes që mbledh shoqëria civile, dhe vlerësimin nga ana e OSHC-ve të efektivitetit të policisë dhe agjencive të tjera në reagimin ndaj dhunës së këtij lloji.

Shpeshherë, organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) janë pika e parë e kontaktit për viktimat e krimeve të urrejtjes. Shumë organizata ofrojnë mbështetjen bazë emocionale, praktike, ligjore dhe, nganjëherë, mjekësore. Si të tilla ato janë një burim kryesor për policinë dhe mund ta ndihmojnë atë që të kuptojë ndikimin e vërtetë të krimeve të urrejtjes tek viktimat dhe komuniteti i tyre. Shumë shpesh, mbështetja që ofrojnë OSHC-të rrit mundësinë që viktimat të bashkëpunojnë me hetimin dhe të mbeten të angazhuara në procesin gjyqësor penal.

Puna në bashkëpunim nuk është përherë e lehtë. Në disa raste, mund të ekzistojë një mosbesim i ndërsjellë ndërmjet shoqërisë civile dhe policisë. Ky modul ndihmon pjesëmarrësit që të kuptojnë punën e OSHC-ve dhe si mund të punojë sa më mirë policia me to për përmirësimin e reagimeve ndaj viktimave. Këtu përfshihet kontributi i drejtpërdrejtë i organizatave të shoqërisë civile, të cilat do të shpjegojnë shërbimet që ofrojnë, të dhënat që kanë mbledhur dhe çfarë kanë mësuar lidhur me nevojat e viktimave LGBTI. Më pas, pjesëmarrësit do të kenë rast që të punojnë me përfaqësues të shoqërisë civile me qëllim identifikimin e fushave për përmirësim dhe mundësi për bashkëpunim.

Rekomandohet me forcë që ky modul të përfshihet në seancat e trajnimit, në qoftë se shoqëria civile nuk është përfshirë ende. Gjithashtu, ky modul mund të shtjellohet edhe në ndonjë aktivitet të organizatave të shoqërisë civile. Kjo gjë do t’u japë pjesëmarrësve rastin që ta njohin nga afër një organizatë, duke nënvizuar më tej mesazhin se OSHC-të janë një partner kryesor për të kuptuar dhe ndjekur krimin kundër personave LGBTI, si dhe për të shtruar çështje dhe mundësi të reja për angazhim.

60. Rezoluta CM/Res(3)(2016 “Statusi për pjesëmarrje në Këshillin e Evropës i organizatave ndërkombëtare joqeveritare”.

REZULTATET E PËRFTUARA NGA TË MËSUARIT

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të kuptojnë çfarë mund të ofrojë shoqëria civile për të përmirësuar hetimin dhe dokumentimin e krimeve të urrejtjes;
- ▶ do të jenë të aftë që t'u drejtohen organizatave lokale të shoqërisë civile për të bashkëpunuar për ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI;
- ▶ do të jenë të aftë që të hartojnë aktivitete bashkëpunimi me shoqërinë civile.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE

- ▶ 5.1 Çfarë janë organizatat e shoqërisë civile, si mund të ndihmojnë ato, si mund të bashkëpunojmë? (40-45 minuta)
- ▶ 5.2 "Po të isha në vend të tyre: për çfarë kam nevojë dhe çfarë mund të bëj?" (45 minuta)
- ▶ 5.3 Krijimi i marrëdhënieve efektive me komuniteti (40 minuta)

AKTIVITETI 5.1: ÇFARË JANË ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC-TË) DHE SI MUND TË NDIHMOJNË ATO?

1. Përpara aktivitetit:

- a. Bëni kërkime lidhur me OSHC-të specifike lokale dhe kombëtare që merren me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI. Mblidhni emra, hollësi për t'i kontaktuar dhe një përshkrim të shkurtër për punën dhe shërbimet e tyre. Shtojini këto tek prezantimi 5.1 në pikën për informacionin për ILGA-në dhe TGEU-në.
- b. Identifikoni një OSHC specifike që të zhvillojë seancën për prezantimin e këtij aktiviteti. Në rrethana ideale, OSHC-të duhet të ketë kryer punë me cilësi shumë të lartë në fushën e monitorimit të krimeve të urrejtjes dhe/ose mbështetjes së viktimave. Ju mund të keni dëshirë që të konsultoni ekspertë kombëtarë për krimet e urrejtjes me qëllim që të identifikoni një organizatë të përshtatshme për ta kontaktuar. Paraprakisht, bashkë me OSHC-në planifikoni me kujdes seancën. Diskutoni për planin e seancës, bini dakord për mesazhet kryesore dhe identifikoni fushat e një natyre konfidenciale që është e mundur të ndeshen gjatë seancës së trajnimit. Për shembull, një rast i një natyre veçanërisht konfidenciale mund të jetë kur pretendohet se policia ka keqtrajtuar viktimat dhe/ose mbështetësit e tyre. Pajtohuni paraprakisht lidhur me mënyrën më të mirë si duhen trajtuar diskutimet për të tilla raste a çështje. Mbani parasysh se synimi kryesor i kësaj seance është që problemet dhe tensionet ndërmjet OSHC-ëve dhe policisë të identifikohen drejtpërdrejtë dhe me ndershmëri, duke qenë megjithatë të fokusuar tek zgjidhjet dhe mënyrat në të cilat policia dhe OSHC-të mund të bashkëpunojnë në mënyrë produktive në të ardhmen.

Në prezantim duhet të trajtohen këto çështje kryesore:

- c. puna e OSHC-së;
 - d. ndikimi i krimit të urrejtjes tek viktimat, përfshirë ndoshta një rast studimor apo histori personale;
 - e. përshtypjet lidhur me boshllëqet në ligj apo zbatim;
 - f. të dhëna për krimin për shkak të urrejtjes, që cenon personat LGBTI, që janë dokumentuar nga OSHC-ja e ftuar apo ndonjë organizatë tjetër partnere; një analizë si ndryshojnë nga shifrat që ka policia dhe pse mund të ketë ndryshime (p.sh.: viktimat mund të mos bëjnë kallëzim në polici, ndoshta OSHC-ja dhe policia përdorin kriterë të ndryshme etj.);
 - g. një përmbledhje të metodologjisë së tyre të dokumentimit dhe një vlerësim sa të qëndrueshme janë të dhënat e tyre për krimin për shkak të urrejtjes;
 - h. arsyet pse viktimat nuk bëjnë kallëzim në polici për krimet;
 - i. rekomandime si mund të punojë më së miri policia me viktimat LGBTI dhe t'i mbështesë ato;
 - j. sugjerime si mund të bashkëpunojnë OSHC-ja dhe policia.
2. Niseni aktivitetin me një seancë të shkurtër për shkëmbimin e ideve dhe pyetini pjesëmarrësit çfarë dinë për punën e OSHC-ëve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjatë diskutimit mund të ofroni këto ide:

OSHC-të:

- ▶ mund të jenë organizata të mëdha ndërkombëtare që punojnë për një sërë temash, përfshirë krimin për shkak të urrejtjes dhe çështje më të gjera të të drejtave të njeriut, për shembull, "Amnesty International" ose "Human Rights Watch"
- ▶ mund të përqendrohen në mënyrë specifike në çështje dhe të drejtat e personave LGBTI, si: ILGA dhe TGEU
- ▶ mund të angazhohen në një numër aktivitetesh, përfshirë monitorimin, raportimin dhe sensibilizimin lidhur me krimin për shkak të urrejtjes
- ▶ mund të paraqesin të dhëna dhe informacione tek organizata ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e Evropës, për situatën në vend të krimeve të urrejtjes
- ▶ mund të ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë për viktimat e krimeve të urrejtjes dhe mund t'i mbështesin ato për të bërë kallëzimin e shkeljeve në polici në qoftë se viktimat japin miratimin e tyre.

3. Drejtojeni vëmendjen e pjesëmarrësve tek prezantimi 5.1, ku jepen lista të OSHC-ëve kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me çështje që lidhen me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI.
4. Ftojeni përfaqësuesin e OSHC-së që të bëjë prezantimin e vet.
5. Pas prezantimit, moderoni një seancë pyetje-përgjigje.

PREZANTIMI 5.1: ORGANIZATAT KOMBËTARE, RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE QË PUNOJNË ME RASTE TË KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI

Këto janë disa shembuj të organizatave të shoqërisë civile që punojnë me raste të krimeve të urrejtjes në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Hulumtojini me kujdes grupet e faqeve të tyre të internetit. Do të mësoni për krimet e urrejtjes që kryhen kundër personave LGBTI në vende të tjera, si trajtohen këto krime dhe si mbështeten viktimat.

Organizatat ndërkombëtare joqeveritare që merren me krimet e urrejtjes

Shoqata Ndërkombëtare Europiane e Personave Lezbike, Gej, Biseksualë, Transgjjinorë dhe Intersex (njihet ndryshe si “ILGA-Europe”)

<http://www.ilga-europe.org/>

“ILGA-Europe” synon të sigurojë që, në nivel evropian dhe ndërkombëtar, të ketë njëtrajshmëri për sa i takon ndjekjes së krimeve për shkak të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes. Organizata monitoron mënyrën si i zbatojnë angazhimet e ndryshme shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, dhe punon me anëtarët e vet në shkallë kombëtare për të nxitur përkrahjen mbi bazën e fakteve që mbështet miratimin legjislativ dhe politikave nga ana e ligjvënësve dhe qeverive lokale.

“ILGA-Europe” punon me organizata profesionale për të inkurajuar trajnimin e personelit policor, prokurorëve, gjyqtarëve dhe avokatëve. Ajo nxit grumbullimin nga ana e organizatave anëtare të fakteve për krime dhe incidente për shkak të urrejtjes, dhe i ndihmon anëtarët që të rrisin kapacitetet e tyre në këtë aspekt. Së fundi, organizata mbështet dhe asiston në ndjekjen ligjore të çështjeve në gjykatat evropiane.

“OII Europe” (Organizata Ndërkombëtare e Personave Intersex në Europë)

<https://oiieurope.org/about/>

“OII Europe” është organizatë ombrellë e organizatave evropiane të personave Intersex me bazë të drejtat e njeriut. Ndërsa ajo nuk merret drejtpërsëdrejti me çështje të krimeve të urrejtjes, organizata është një burim i shkëlqyer për të mësuar më shumë lidhur me personat Intersex dhe përvojat e tyre. Gjithashtu, “OII Europe” mund të kontaktohet për informacione të mëtejshme dhe kur bëhen përpjekje për t’u lidhur me organizata kombëtare.

“Transgender EU” (TGEU)

www.Tgeu.org

“Transgender Europe” punon me organizatat anëtare dhe partnerët e saj për të monitoruar dhe rritur sensibilizimin lidhur me situatën serioze të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe dhunës që ushtrohet ndaj personave trans në nivel evropian dhe global. Qysh nga viti 2009, Projekti i saj “Trans Murder Monitoring (TMM)” ka shërbyer për mbledhjen, monitorimin dhe analizën sistematike të informacionit lidhur me vrasjet e personave, të cilët shfaqin mospërputhje gjinore/trans, që raportohen në mbarë botën. Në Evropë, TGEU punon me organizata partnere për dokumentimin e diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimeve për shkak të urrejtjes, dhe ofron mbështetje me bazë komunitetin për viktimat/të mbijetuarit e dhunës në kuadër të Projektit të saj “ProTrans”.

“Amnesty International”

www.Amnesty.org

“Amnesty International” ka bërë një numër hetimesh kombëtare për krime për shkak të urrejtjes, përfshirë kundër personave LGBTI. Ndër raportet e saj përfshihen raste studimore, një analizë e kuadrit ligjor dhe e politikave të vendeve, si dhe rekomandime për përmirësime.

Bëni kërkime për “krimin për shkak të urrejtjes” në grupin e faqeve të saj të internetit dhe do të gjeni një numër raportesh për vende të ndryshme.

“Human Rights Watch”

www.hrw.org

Ashtu si “Amnesty”, “Human Rights Watch” bën kërkime lidhur me krimin për shkak të urrejtjes, përfshirë krimet kundër personave LGBTI. Ndër raportet e saj përfshihen raste studimore, një analizë e kuadrit ligjor dhe e politikave të vendeve, si dhe rekomandime për përmirësime.

Bëni kërkime lidhur me “krimin për shkak të urrejtjes” në grupin e faqeve të saj të internetit dhe do të gjeni një numër raportesh për vende të ndryshme.

Organizata kombëtare që merren me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI

Në Shqipëri numri i organizatave që punojnë për komunitetin LGBTI mbetet ende i vogël, krahasuar me numrin e përgjithshëm të atyre që punojnë për të drejtat e komuniteteve të tjera. Megjithatë, përgjatë një kohe të shkurtër, organizatat kanë arritur të ndërtojnë profilin e tyre të qëndrueshëm.

Organizatave janë fokusuar tek fuqizimi i komunitetit për të mbrojtur të drejtat e tyre, forcimin e dialogut me Qeverinë qendrore dhe lokale, trajnimin e personelit tek institucioneve shtetërore, si punonjësit e policisë, bashkive apo shëndetësisë për të drejtat LGBTI. Një pjesë tjetër e tyre janë fokusuar tek ofrimi i shërbimeve direkte për komunitetin, shërbime të cilat kanë rëndësi për oficerët e policisë, pasi shpesh ata përballen me nevojën për t'i referuar anëtarët e komunitetit LGBTI në shërbime sociale dhe mbrojtëse të specializuara.

Më poshtë do të gjeni një listë të organizatave kryesore që punojnë për komunitetin LGBTI në Shqipëri:

Emri:	Ambasada PINK
E-mail:	pink@pinkembassy.al
Faqja e internetit:	www.pinkembassy.al
Tel:	+ 355 (0) 4 2265741
Cel:	+ 355 67502025

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri është një organizatë jo-fitimprurëse e cila punon për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave lezbike, gej, biseksualë, transgjjinorë, interseks dhe queer në Shqipëri.

Me përpjekjet e saj dhe me mbështetjen e partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë, në 17 Maj 2010 Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri realizoi "Festivalin e Diversitetit", i pari aktivitet publik i realizuar në vend në një mjedis të hapur. Ky ishte një nga momentet më vendimtarë për njohjen e gjerë të kauzës LGBT në vend. Ambasada PINK / LGBT Pro është anëtare e organizmave ndërkombëtarë si ILGA Europe dhe IGLYO si dhe e rrjeteve të organizatave LGBT si Rrjeti Rajonal kundër Homofobisë dhe Transfobisë, etj.,. Prej vitit 2014 Ambasada PINK / LGBT Pro po punon për realizimin e Pride-t të parë LGBT në Shqipëri, në 17 Maj, si dhe për avancimin e të drejtave të personave LGBT me politika qendrore dhe lokale, rritje kapacitetesh, lobim dhe avokim, programe trajnimi, etj.,.

Fushat tona të përparësisë janë:

- ▶ Zbatimi i plotë i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe njohja ligjore e personave LGBT dhe garantimi i barazisë së tyre të plotë;
- ▶ Emancipimi i ligjit shqiptar në raport me njohjen dhe shprehjen e gjinisë;
- ▶ Zbatimi i planit të masave kombëtare nga Qeveria e Shqipërisë për avancimin e të drejtave LGBT;
- ▶ Krijimi i qyteteve miqësore ndaj personave LGBT (qytetet ylber), për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave LGBT në nivel lokal;
- ▶ Reformimi i sistemit arsimor në Shqipëri për integrimin e plotë të çështjeve LGBT, si çështje e të drejtave të njeriut, në kurrikulat e shkollave të vendit për një mirë-informim të brezave të rinj mbi çështje të orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
- ▶ Mbrojtja e fëmijëve dhe adoleshentëve LGBT nga bullizmi dhe dhuna në shkolla si dhe luftimi i këtij fenomeni;
- ▶ Mbrojtja e personave LGBT nga dhuna e krimet e urrejtjes dhe krijimi i një mjedisi dhe përqasjeje pozitive nga Policia e Shtetit;
- ▶ Krijimi i mjediseve pranuese dhe pozitive brenda familjeve shqiptare me anëtarë LGBT, etj.;
- ▶ Garantimi i shërbimeve mjekësore të përshtatshme për personat e LGB dhe krijimi i kushteve për ndryshimin dhe njohjen e gjinisë për personat transgjjinorë.

Emri: Aleanca kundër diskriminimit LGBT

E-mail: aleanca.al@gmail.com
Faqja e internetit: <http://www.aleancalgbt.org/>

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

Aleanca Kundër Diskriminimit të LGBT është një organizatë jo-qeveritare shqiptare që parashikon një shoqëri të lire, të hapur, dhe të barabartë për të gjithë identitetet seksuale e gjinore njerëzore. Aleanca ka për qëllim krijimin dhe fuqizimin e komunitetit shqiptar LGBT, mbrojtjen e të drejtave të tij dhe luftën kundër diskriminimit të bazuar tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Aleanca nisi aktivitetet e saj në mars të vitit 2009, kur një grup vullnetarësh LGBT filluan punën mbi hartimin e programeve dhe aktiviteteve për komunitetin, dhe u regjistrua si organizatë jo-qeveritare në nëntor 2009.

Programet dhe aktivitetet e Aleancës LGBT përfshijnë:

- ▶ Fuqizim i komunitetit LGBT në Shqipëri
- ▶ Organizim i eventeve sociale të vazhdueshme për komunitetin me synim njohjen mes tyre dhe informimin për çështje LGBT (grupe javore diskutimi, festa javore, shfaqje filmash, piknikë, skuadër futbollit për vajza, etj.,).
- ▶ Ndërlidhje e komunitetit shqiptar LGBT me ato në rajon (p.sh. pjesëmarrje në Gay Pride në Kroaci, informim i vazhdueshëm për zhvillime në rajon).
- ▶ Mbështetje për personat LGBT dhe familjarët e tyre që duan të ndajnë problemet me dikë që mund t'i kuptojë dhe ndihmojë.
- ▶ Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri.
- ▶ Ndërgjegjësim dhe edukim publik.
- ▶ Fushata publike informimi nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese (fletushka, postera, broshura) në formë elektronike dhe duke ndaluar njerëzit në rrugë (p.sh. Doktorët e Homofobisë).
- ▶ Prezantime dhe leksione në universitete mbi historikun e lëvizjeve për të drejtat e njerëzve LGBT, për komunitetin LGBT në Shqipëri, etj.,.
- ▶ Pjesëmarrje në emisione televizive dhe radiofonike.
- ▶ Botime shkrimesh dhe intervista në median e shkruar.
- ▶ Advokaci dhe lobim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, aktorë qeveritarë, dhe bashkësinë ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri.

Emri: OMSA (Open Mind Spectrum Albania)

E-mail: omsa.albania@gmail.com
Faqja e internetit: www.omsalbania.org
Tel (mob): +355 693953920

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

OMSA (Open Mind Spectrum Albania) u krijua zyrtarisht në vitin 2013 dhe ka zhvilluar projekte dhe aktivitete në fushën e punës në komunitet dhe advokimit. OMSA synon një shoqëri ku çdo individ, pa marrë parasysh orientimin seksual, identitetin gjinor, gjininë, ngjyrën, moshën, statusin shoqëror, statusin martesor, aftësitë, statusin shëndetësor, përkatësinë etnike, gëzon të drejta dhe liri të plota, sigurimin social, shëndetësor etj. OMSA ka një eksperiencë të gjerë të punës së saj me prindërit e personave LGBTI dhe është pjesë e rrjeteve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të drejtat e komunitetit LGBTI.

Në fillimet e saj, dhe më tej, OMSA zhvilloi një sërë trajnimesh me prindërit dhe të afërmit e njerëzve LGBTI. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte të siguronte informacion të besueshëm, të mbështeste familjet në procesin e tyre të njohjes, pranimit dhe daljes hapur të fëmijëve të tyre LGBTI.

Në përpjekjet e saj për të zhvilluar një program advokimi, OMSA ka filluar në vitin 2016 një projekt që adreson pjesëmarrjen politike dhe përfaqësimin e njerëzve LGBTI në Shqipëri. Qëllimi kryesor i projektit është rritja e pjesëmarrjes së personave LGBTI në jetën politike dhe çështjet kryesore të lidhura me personat LGBTI në arenën politike para zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe pas zgjedhjeve.

Për të realizuar këtë vizion OMSA punon për:

- ▶ promovimin dhe përmirësimin e gjendjes ligjore dhe sociale të grupeve të minoriteteve në Shqipëri, si romë, egjiptian, LGBTQI, me aftësi të kufizuara, të rinj me probleme si droga dhe AIDS , të drejtat e grave dhe të fëmijëve.
- ▶ rritjen e dukshmërisë me kryerjen e fushatave për ndërgjegjësimin dhe informimin mbi çështjet e komuniteteve të përmendura më lart.
- ▶ përgatitjen dhe sigurimin e trajnimeve profesionale, kurseve arsimore, seminareve, workshopeve, konferencave, etj.,.
- ▶ monitorimin dhe raportimin e shkeljeve të të Drejtave të Njeriut, për të rritur mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti sundimin e ligjit.

Mbështetjen në ngritjen e kapaciteteve, aftësive dhe njohurive të individëve, grupeve dhe organizatave qëllimet e të cilave përkohë me organizatën tonë.

Emri:	STREHA LGBT
E-mail:	strehalgbt@gmail.com
Faqja e internetit:	https://www.facebook.com/strehalgbtAlbania
Cel:	+ 355 69 98 39 189

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

“STREHA” është qendra e parë rezidenciale në Shqipëri që i vjen në ndihmë komunitetit LGBTI në rastet e emergjencave në aspektin e strehimit.

Streha nisi aktivitetet e saj si projekt pilot që prej muajit dhjetor 2014 duke operuar si projekt pilot i përbashkët i dy organizatave në fushën e të drejtave të komunitetit LGBTI, nga “Aleanca Kundër Diskriminimit të LGBT” dhe “ProLGBT” (Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT). Që prej Nëntorit 2015, Qendra Streha u themelua si entitet i pavarur në kuadër të qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së konsolidimit të shërbimit për komunitetin LGBTI në risk.

Qendra “Streha” është një shërbim tranzitor për të gjithë të rinjtë LGBTI 18-25 vjeç që hasin dhunë, diskriminim dhe nevojë për strehim për shkak të orientimit të tyre seksual. Streha ofron shërbim ri-integrimi 24 orë në 7 ditë të javës për të rinjtë LGBTI të pastrehë dhe në risk përjashtimi social nëpërmjet 8 personave të stafit. Ajo ka një kapacitet prej 8 shtretërisht dhe synon të ofrojë ndihmë dhe shërbim për të rinjtë LGBTI të pastrehë, si dhe punon për ri-integrimin dhe fuqizimin e tyre si pjesë e shoqërisë.

Ndërhyrjet kryesore që realizon streha janë:

1. **Shërbimi bazë**

- Akomodim
- Ushqim
- Asistence mjekësore
- Asistence për punësim
- Asistence për arsim/kurse profesionale
- Këshillim karriere
- Këshillim psikologjik
- Këshillim në grup
- Negocim me familjet
- Aktivitete psiko-edukuese
- Aktivitete socio-kulturore

2. **Ndjekje e rasteve në distancë** (komunitet)

Që prej tetorit 2017 Streha ka filluar të punojë për ndjekjen e rasteve në distancë. Ngritja e udhëzuesve dhe protokollit të ndjekjes janë hapat e para për të vijuar këtë shërbim.

Emri: Të bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri (ProLGBT)E-mail: prolgbtalbania@gmail.comFaqja e internetit: www.historia-ime.com

Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të organizatës:

“Të bashkuar PRO kauzës LGBT në Shqipëri” ose shkurt ProLGBT nisi si një iniciativë vullnetare e një grupi të vogël djemsh dhe vajzash. Që prej vitit 2011 aktivistët e ProLGBT kanë punuar për të rritur vizibilitetin e komunitetit LGBT në vend, për të kontribuar në fuqizimin e komunitetit dhe në lobimin për të drejtat e tyre brenda dhe jashtë vendit.

Besojmë se Shqipëria është duke jetuar një moment të pazëvendësueshëm të Lëvizjes për të Drejtat e LGBT por nuk mund të konsiderohet një vend demokratik që respekton të drejtat e njeriut pa respektuar dhe garantuar edhe të drejtat e komunitetit LGBT. Për ne, fuqizimi i komunitetit LGBT në vend është çelësi kryesor i suksesit dhe përmirësimit të jetëve të atyre mijëra djemve e vajzave që ende jetojnë me frikë për atë që janë, në mes të një shoqërie ekstremisht armike ndaj të qenit ndryshe.

Pro LGBT që prej vitit 2012 menaxhon portalin për të drejtat e njeriut - Historia Ime, e cila shpesh është bërë burimi kryesor i medias shqiptare dhe të huaj për shpërndarjen e informacioneve apo ngjarjeve në lidhje me komunitetin LGBT.

Programet dhe aktivitetet e ProLGBT përfshijnë:

- ▶ *Ndërgjegjësimin e opinionit publik*
 - Promovon dinjitetin, barazinë dhe të drejtat e personave LGBT në Shqipëri
 - Ndërgjegjëson dhe edukon publikun e gjerë dhe institucionet publike për të drejtat e personave LGBT
- ▶ *Lobimin dhe avokimin për çështjet LGBTI në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar*
 - Ndikon në përmirësimin e politikave dhe ligjeve në favor të komunitetit LGBT
 - Informon institucionet publike, Qeverinë shqiptare dhe organizatat ndërkombëtare për situatën e të drejtave të komunitetit LGBT në vend
 - Punon për përmirësimin e legjislacionit, politikave, dhe standardeve për të drejtat LGBT
- ▶ *Punon për edukimin e medias mbi çështjet LGBT*
 - Menaxhon median për komunitetin LGBT në Shqipëri – Historia Ime
 - Bën trajnime me përfaqësues të medias mbi gjuhën diskriminuese dhe terminologjinë LGBT
 - Asiston komunitetin LGBT dhe vendos në dispozicion të tyre mjete, që bëjnë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së këtij komuniteti në jetën publike të vendit.

AKTIVITETI 5.2: "PO TË ISHA NË VEND TË TYRE: PËR ÇFARË KAM NEVOJË DHE ÇFARË MUND TË BËJ?"

Kjo seancë duhet zhvilluar me përfshirjen e OSHC-ve. Seanca mund të vijojë menjëherë pas prezantimit të OSHC-ve.

1. Përpara seancës, merrni pesë fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme dhe shkruani këto më poshtë:
 - ▶ Fleta një: "Për çfarë kanë nevojë viktimat?"
 - ▶ Fleta dy: "Çfarë i duhet policisë?", "Çfarë mund të bëjë policia?"
 - ▶ Fleta tre: "Çfarë u duhet organizatave të shoqërisë civile?", "Çfarë mund të bëjnë OSHC-të?"
 - ▶ Fleta katër: "Çfarë u duhet prokurorëve?", "Çfarë mund të bëjnë prokurorët?"
 - ▶ Fleta pesë: "Çfarë u duhet ministrive?", "Çfarë mund të bëjnë ministrinë?"
2. Vendosini fletët rreth e rrotull sallës dhe vini në dispozicion stilolapsa.
3. Prezantoni seancën. Shpjegoni se qëllimi i kësaj seance është që pjesëmarrësit:
 - ▶ të kuptojnë këndvështrimet e spektrit të individëve dhe organizatave që punojnë për ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI; dhe
 - ▶ të vlerësojnë sidomos këndvështrimin e viktimës.
4. Ndajeni grupin në pesë grupe më të vogla. Udhëzoni që të shpenzojnë 5-7 minuta për të plotësuar grafikët në vetën e parë. Për shembull, për grafikun e viktimës, të thonë: "Si viktimë unë kam nevojë..." "Si oficer policie, unë mund..." "Theksoni se, ndonëse ka gjëra që viktimat mund të bëjnë me qëllim që të përmirësohen reagimet kundër krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI (p.sh.: të bëjnë kallëzim dhe të vazhdojnë të angazhohen në procesin gjyqësor penal), ato asnjëherë nuk duhet të vihen nën presion që të bëjnë diçka për të cilën ndihen në siklet. Vini në dukje se, në këtë kuptim, roli i tyre është krejtësisht i ndryshëm nga ai i policisë, i OSHC-ëve dhe i ministrive, ku që të gjithë kanë përgjegjësi të ndara për të marrë masa specifike. Shpjegoni se kjo është arsyeja pse fleta e viktimës është e ndryshme nga fletët e tjera.
5. Thojuni se, në përfundim të 7 minutave, një pjesëtar i grupit do të qëndrojë dhe pjesa tjetër e grupit do të shkojë tek tabela tjetër me fletë të lëvizshme. Grupi do të shpenzojë 5-7 minuta tek tabela tjetër me fletë të lëvizshme, ndërsa personi që qëndron do të shpjegojë çfarë ka shkruar grupi i tij/saj, duke ruajtur të njëjtën gjuhë. "Si viktimë unë kam nevojë..." "Si oficer policie, unë mund..." etj.,... Më pas, grupi do të identifikojë të gjitha ato që mungojnë dhe do t'i shtojë në listë.
6. Në përfundim të 7 minutave, një person tjetër do të qëndrojë dhe pjesa tjetër e grupit do të vazhdojë. Grupi do të shpenzojë edhe 5-7 minuta të tjera tek tabela me fletë të lëvizshme dhe do të dëgjojë personin që qëndron, i cili do të shpjegojë çfarë është shkruar në grafik. Grupi do të bëjë shtesa në listë dhe një person tjetër do të qëndrojë për t'i shpjeguar grupit tjetër. Vazhdoni kështu derisa të gjitha grupet të kenë punuar me gjithë fletët e letrave të tabelës me fletë të lëvizshme.
7. Kërkoni që të gjithë të kthehen tek grupi i madh për të marrë informacion. Pyetini çfarë mësuan nga ky aktivitet, çfarë i befaso, çfarë do të marrin me vete. Identifikoni dhe dokumentoni veprimet kryesore që mund të merren në të ardhmen e afërt deri të mesme me qëllim përmbushjen e nevojave që janë identifikuar, në bashkëpunim me policinë, OSHC-të dhe agjencitë e tjera.

Kjo seancë duhet zhvilluar me përfshirjen e OSHC-ve. Seanca mund të vijojë menjëherë pas prezantimit të OSHC-ve.

1. Përpara seancës, merrni pesë fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme dhe shkruani këto më poshtë:
 - ▶ Fleta një: "Për çfarë kanë nevojë viktimat?"
 - ▶ Fleta dy: "Çfarë i duhet policisë?", "Çfarë mund të bëjë policia?"
 - ▶ Fleta tre: "Çfarë u duhet organizatave të shoqërisë civile?", "Çfarë mund të bëjnë OSHC-të?"
 - ▶ Fleta katër: "Çfarë u duhet prokurorëve?", "Çfarë mund të bëjnë prokurorët?"
 - ▶ Fleta pesë: "Çfarë u duhet ministrive?", "Çfarë mund të bëjnë ministrinë?"
2. Vendosini fletët rreth e rrotull sallës dhe vini në dispozicion stilolapsa.
3. Prezantoni seancën. Shpjegoni se qëllimi i kësaj seance është që pjesëmarrësit:
 - të kuptojnë këndvështrimet e spektrit të individëve dhe organizatave që punojnë për ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI; dhe
 - të vlerësojnë sidomos këndvështrimin e viktimës.

4. Ndajeni grupin në pesë grupe më të vogla. Udhëzoni që të shpenzojnë 5-7 minuta për të plotësuar grafikët në vetën e parë. Për shembull, për grafikun e viktimës, të thonë: “Si viktimë unë kam nevojë...”/“Si oficer policie, unë mund ...” Theksoni se, ndonëse ka gjëra që viktimat mund të bëjnë me qëllim që të përmirësohen reagimet kundër krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI (p.sh.: të bëjnë kallëzim dhe të vazhdojnë të angazhohen në procesin gjyqësor penal), ato asnjëherë nuk duhet të vihen nën presion që të bëjnë diçka për të cilën ndihen në siklet. Vini në dukje se, në këtë kuptim, roli i tyre është krejtësisht i ndryshëm nga ai i policisë, i OSHC-ëve dhe i ministrive, ku që të gjithë kanë përgjegjësi të ndara për të marrë masa specifike. Shpjegoni se kjo është arsyeja pse fleta e viktimës është e ndryshme nga fletët e tjera.
5. Thojuni se, në përfundim të 7 minutave, një pjesëtar i grupit do të qëndrojë dhe pjesa tjetër e grupit do të shkojë tek tabela tjetër me fletë të lëvizshme. Grupi do të shpenzojë 5-7 minuta tek tabela tjetër me fletë të lëvizshme, ndërsa personi që qëndron do të shpjegojë çfarë ka shkruar grupi i tij/saj, duke ruajtur të njëjtën gjuhë. “Si viktimë unë kam nevojë ...”/“Si oficer policie, unë mund ...” etj. Më pas, grupi do të identifikojë të gjitha ato që mungojnë dhe do t’i shtojë në listë.
6. Në përfundim të 7 minutave, një person tjetër do të qëndrojë dhe pjesa tjetër e grupit do të vazhdojë. Grupi do të shpenzojë edhe 5-7 minuta të tjera tek tabela me fletë të lëvizshme dhe do të dëgjojë personin që qëndron, i cili do të shpjegojë çfarë është shkruar në grafik. Grupi do të bëjë shtesa në listë dhe një person tjetër do të qëndrojë për t’i shpjeguar grupit tjetër. Vazhdoni kështu derisa të gjitha grupet të kenë punuar me gjithë fletët e letrave të tabelës me fletë të lëvizshme.
7. Kërkoni që të gjithë të kthehen tek grupi i madh për të marrë informacion. Pyetini çfarë mësuan nga ky aktivitet, çfarë i befasoni, çfarë do të marrin me vete. Identifikoni dhe dokumentoni veprimet kryesore që mund të merren në të ardhmen e afërt deri të mesme me qëllim përmbushjen e nevojave që janë identifikuar, në bashkëpunim me policinë, OSHC-të dhe agjencitë e tjera.

AKTIVITETI 5.3: KRIJIMI I MARRËDHËNIEVE EFEKTIVE ME KOMUNITETIN LGBTI (1 ORË)

Ky aktivitet ka dy pjesë. Në pjesën e parë shqyrtohet një rast studimor me qëllim identifikimin e mësimave që janë nxjerrë dhe çfarë mund të ishte bërë ndryshe. Pjesa e dytë është një aktivitet për shkëmbimin e ideve në të cilën pjesëmarrësit identifikojnë veprime specifike që mund të ndërmerren në nivel kombëtar për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe komuniteteve LGBTI. Si në rastin e aktiviteteve të tjera të këtij moduli, rekomandohet me forcë që në këto aktivitete të marrin pjesë OSHC-të.

5.3a: Dita Ndërkombëtare e Policimit kundër Homofobisë, Rumania: çështja gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “M.C. dhe A.C. kundër Rumanisë”

1. Përpara seancës merrni dy fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme. Tek fleta e parë shkruani: “Çfarë gabimesh u bënë?” Tek fleta e dytë shkruani: “Çfarë mund të ishte bërë ndryshe?”
2. Ndajeni pjesëmarrësit në grupe të vogla. Në qoftë se marrin pjesë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, sigurohuni që ata të shpërndahen midis pjesëmarrësve të policisë. Kërkoni që pjesëmarrësit të lexojnë rastin studimor duke patur në mendje këto pyetje. Shpjegoni se qëllimi i aktivitetit është që të mos vihet faj. Vini në dukje se shumë vende të rajonit të Këshillit të Evropës kanë patur sfida të ngjashme. Theksoni se arsyeja pse po përqendrohemi tek ky rast është sepse ai, faktikisht, ka ndodhur dhe sepse ai ngre çështje të zakonshme me të cilat përballen policia dhe komuniteti.
3. Jepuni pjesëmarrësve 5-7 minuta kohë që të lexojnë rastin studimor. Kërkoni nga pjesëmarrësit që t’u japin përgjigje të shkurtra dy pyetjeve.
4. Bashkoni sërish pjesëmarrësit në grupe më të mëdha që të ndajnë me njëri-tjetrin përgjigjet e tyre. Kur të diskutohet se çfarë gabimesh u bënë, sigurohuni që të evidentohen këto çështje:
 - ▶ Pjesëmarrësit u plagosën pas marshimit edhe pasi kishin ndjekur udhëzimet lidhur me veshjen dhe itineraret.
 - ▶ Reagimi i policisë ndaj viktimave ishte i papërshtatshëm (p.sh.: duke shprehur habi që viktimat ishin “në gjendje të mirë ekonomike” dhe duke i shkruajtur ato që të mos e vazhdonin më tej çështjen e tyre).

- ▶ Komunikim i dobët me viktimat për sa i takon çështjes, që, gjithashtu, mund të dëmtojë besimin e komunitetit më të gjerë LGBTI (p.sh.: ACCEPT kishte kontaktuar policinë në tri raste të veçanta për të mësuar se çfarë po ndodhte në këtë rast).
- ▶ Ekzistojnë fakte të planifikimit të pamjaftueshëm përpara ngjarjes lidhur me mbrojtjen e pjesëmarrësve përpara, gjatë dhe pas ngjarjes.

Kur të diskutohet çfarë mund të ishte bërë ndryshe, sigurohuni që të evidentohen këto çështje:

- ▶ Rishikoni procedurat e sigurisë përpara aktivitetit me qëllim që pjesëmarrësit të jenë të sigurt përpara, gjatë dhe pas aktivitetit.
- ▶ Trajnimi i policisë si të intervistojnë me ndjeshmëri dhe efektivitet viktimat e akteve homofobike të dhunës dhe si të hyjnë në kontakt me to.
- ▶ Përmirësimi i mbledhjes së provave për ndjekje të mundshme penale të agresorëve (shënim për trajnuesin: sigurohuni që ky diskutim të mos hyjë shumë në hollësitë e çështjeve hetimore, që trajtohen në Modulin Katër).
- ▶ Përmirësimi i komunikimit me viktimat dhe komuniteti e prekura pas incidenteve.

PREZANTIMI 5.3A: PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJES GJYQËSORE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT “M.C. DHE A.C. KUNDËR RUMANISË”

Ky prezantim jep një përmbledhje të çështjes gjyqësore “M.C. dhe A.C. kundër Rumanisë” për qëllime trajnimi. Për hollësitë e plota të çështjes gjyqësore, shkoni tek grupi i faqeve të internetit të Gjykatës: <https://goo.gl/sHMXb4>.

Çfarë ngjau

Më datë 3 qershor 2006, palët kërkuese morën pjesë në paradën e përvitshme të personave gej në Bukuresht. Parada ishte organizuar nga ACCEPT, organizatë joqeveritare pikësypnimit të cilës është që të ofrojë informacion dhe të asistojë komunitetin LGBTI. Policia siguroi mbrojtjen e paradës. Policia ndaloi disa individë, që kishin shprehur aktivisht mosmiratimin e tyre lidhur me paradën e personave gej, të cilët i fotografuan dhe dokumentet e tyre të identitetit u verifikuan dhe u mbajtën shënim.

Rreth orës 7 të mbrëmjes, në fund të paradës, palët kërkuese dhe katër pjesëmarrës të tjerë u larguan nga zona duke ndjekur itineraret dhe mjetet e transportit që rekomandonin autoritetet në udhëzimet që kishin përgatitur organizatorët për pjesëmarrësit e paradës. Siç rekomandohej në të njëjtën fletëpalosje, ata nuk mbanin veshje apo distinktivë që do t'i identifikonin si pjesëmarrës të paradës.

Pasi hipën në një tren të metrosë, ata u sulmuan nga një grup prej gjashtë të rinjsh, vajza dhe djem, që mbanin tuta me kapuç. Agresorët shkuan drejt e tek viktimat dhe filluan t'i godisnin me grushte dhe me shkelma në kokë dhe në fytyrë. Gjithashtu, kapur pas shufrave metalike mbi kryet e tyre, ata vazhdonin t'i godisnin me shkelma viktimat. Gjatë aktit të dhunshëm ata nuk reshtnin së thirruri: “Pederastë të ndyrë, shkoni në Holandë!”

Viktimat i shtynë në një qoshe të vagonit. Njëri prej tyre u përpoq t'i mbronte të tjerët me trupin e tij, por pala e dytë kërkuese mbeti e pambrojtur dhe pësoi disa goditje.

Akti i dhunës zgjati rreth dy minuta. Duke dalë nga vagoni, agresorët e goditën sërish në fytyrë palën e parë kërkuese.

Gjatë aktit të dhunshëm, pasagjerët e tjerë u tërhoqën në anën tjetër të vagonit. Ndër ta ishte një fotograf, i cili kishte qenë edhe në paradë. Viktimat i kërkuan që ta fotografonte incidentin dhe ai ashtu bëri. Për rrjedhojë, agresorët e goditën edhe atë.

Hetimi nga ana e policisë

Më pas atë natë të datës 3 duke u gdhirë data 4 qershor 2006, viktimat, përfshirë palët kërkuese, dhe një përfaqësues i organizatës ACCEPT shkuan në polici. Ata bënë ankesë penale kundër agresorëve dhe deklaruan se akti i dhunshëm bazohej tek orientimi seksual i viktimave. Ata përsëritën se nuk kishin shenja të dukshme që mund të kishin bërë të ditur faktin se ata po ktheheshin nga parada e personave gej. Ata argumentuan se agresorët i kishin identifikuar ata në paradë (pasi ata nuk kishin vënë maska) dhe i kishin ndjekur më pas, me synimin për t'i dëmtuar. Ata e informuan policinë lidhur me komentet fyese që ishin bërë gjatë aktit të dhunshëm.

Sipas palëve kërkuese, oficerët e policisë ishin befasuar kur kishin kuptuar se palët kërkuese dhe viktimat e tjera, ndonëse gej, ishin individë në gjendje me punë të rregullt dhe pozicione me përgjegjësi. Oficerët e policisë u përpoqën që t'i bindnin që të mos e ndiqnin ligjërisht ankesën, duke i paralajmëruar se do t'u duhej të përballëshin me agresorët e tyre në gjyq.

Për shkak të riorganizimit në forcat e policisë, dosja e çështjes kaloi nga një komisariat policie tek tjetri dhe, më datë 4 prill 2007, u regjistrua në Rajonin e Policisë së Kryeqytetit. Ndërsa dukej se asgjë nuk po bëhej me çështjen, palët kërkuese kërkuan informacion për ecurinë e hetimit me anë të letrave që organizata ACCEPT dërgoi më datë 25 shtator 2006, 28 mars 2007 dhe 20 korrik 2011. Më datë 19 mars 2007, ata u ankuan edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme për mungesën e një hetimi efektiv të çështjes, por më kot.

Më datë 9 gusht 2011, në përgjigje të një kërkesë që kishin bërë palët kërkuese për të marrë informacion, Policia e Kryeqytetit i informoi se nuk kishte synim që të fillonte ndjekjen penale, meqenëse afati për ndjekjen e padisë *për krimet e pretenduara kishte kaluar*. Policia shpjegoi se hetimi ishte vështirësuar më shumë nga fakti se dosja kishte mbërritur në zyrën e Policisë së Kryeqytetit një vit pas ngjarjeve. Për më tepër, kishin dështuar gjithë veprimet që ndërmori policia për identifikimin e autorëve të pretenduar të krimit.

Më datë 4 tetor 2011, prokuroria e Rrethit Gjyqësor të Bukureshtit të Qarkut të Katërt miratoi propozimin e policisë dhe vendosi ta mbyllë hetimin. Vendimi iu dërgua në shtëpi palës së parë kërkuese më datë 27 shkurt 2012.

Pyetje:

Çfarë gabimesh u bënë?

Si mund të ishte trajtuar më mirë situata?

PREZANTIMI 5.3B: KRIJIMI I MARRËDHËNIEVE POZITIVE NDËRMJET POLICISË DHE KOMUNITETIT LGBTI

Shënim i rëndësishëm: Jo të gjitha këto ide do të jenë të përshtatshme në çdo kontekst, dhe është me rëndësi që idetë të përshtaten siç duhet. Për shembull, mund të ndodhë që në polici të mos ketë ndonjë shoqatë LGBT dhe mund të mos ketë oficerë policie të deklaruar haptazi si persona gej. Mund të ndodhë që, në këtë fazë, vetëm disa hapa shumë të vogla drejt përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe shoqërisë civile janë realiste. Ky nuk është problem. Identifikimi dhe zbatimi qoftë edhe vetëm i një hapi mund të jetë arritje e konsiderueshme dhe mund të hedhë themelin për më shumë arritje të konsiderueshme në të ardhmen.

Hapi një: Vlerësimi

1. Gjatë kësaj faze, pjesëmarrësit vlerësojnë marrëdhëniet aktuale ndërmjet policisë dhe komuniteteve LGBTI. Ky është një nga hapat më të vështirë dhe kërkon transparencë dhe ndershmëri. Në qoftë se dy seancat e mëparshme kanë shkuar mirë, mundësia e marrjes së një vlerësimi të përpiktë dhe konstruktiv të situatës së marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe komunitetit LGBTI është më e madhe.

Hapi dy: Plani

2. Kërkoni që pjesëmarrësit të rishikojnë prezantimin 5.3b dhe të pajtohen të paktën për të paktën dy hapa që mund të ndërmerren në një periudhë afatshkurtër.

Hapi tre: Realizimi

3. Kërkoni nga pjesëmarrësit të thonë si do të ndërmerren hapat dhe nga kush. Në qoftë se pjesëmarrësit kanë identifikuar pengesa që janë jashtë kontrollit të tyre (p.sh.: mungesë e kuadrit ligjor, mbështetje e pamjaftueshme politike), inkurajojini që të identifikojnë si mund të kapërcehen ato dhe kujtojini se kjo është diçka që do të analizohet sërish në modulin e ardhshëm.

5.3b: Krijimi i marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe komunitetit LGBTI: disa hapa praktikë

Filloni me gjëra të vogla

Në qoftë se kjo është hera e parë që policia dhe OSHC-të kontaktojnë, filloni me gjëra të vogla. Për shembull, organizoni një takim jozyrtar në mënyrë që secila palë të ketë mundësi që të mësojë më shumë për punën dhe aktivitetet e tjetrit dhe të identifikojë mënyra të mundshme për të bashkëpunuar.

Jini praktik dhe përqendrohuni në aktivitete të dobishme reciproke

Arrini mirëkuptim lidhur me pikat e kontaktit të të dyja palëve dhe një përshkrim të shkurtër se çfarë mund të bëjnë ato.

Arrini mirëkuptim lidhur me kontributin e OSHC-ve në trajnimin e policisë, duke u përqendruar në fusha të ekspertizës, përfshirë mbështetjen për viktimat dhe të kuptuarit e impaktit të krimeve të urrejtjes dhe të nevojave të viktimave. Gjithashtu, shpeshherë, OSHC-të kanë një këndvështrim unik për treguesit e njëanshmërisë për sa u përket komuniteteve LGBTI që janë thelbësorë për hetimin dhe mbledhjen e provave.

Shkoni në zyrat e një OSHC-je lokale ose kombëtare që punon me komunitetin LGBTI.

Vizitoni biznese lokale mikpritëse për personat gej, si: baret mikpritës për personat gej dhe pikëtakime të tjera sociale. Planifikojeni vizitën paraprakisht, duke theksuar që jeni të interesuar të mësoni si po shkojnë gjërat dhe në qoftë se ka patur çështje që kanë shqetësuar komunitetin.

Kërkoni një takim për të biseduar për incidente specifike që kanë ndodhur dhe për përshtypjet nëse frekuenca e incidenteve është rritur apo ka ndryshuar.

Kërkoni kontributin e OSHC-ëve për hartimin e udhëzuesve a protokolleve për policinë. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për të përmirësuar rëndësinë dhe cilësinë e këtyre dokumenteve në kuptimin e nevojave të viktimave, e të kuptuarit të impaktit të krimeve të urrejtjes dhe përfundimisht të një këndvështrimi të ri lidhur me treguesit e njëanshmërisë.

Ndërmerrni veprime rregullisht

Angazhimi i rregullt është me rëndësi dhe krijon pikat e forta të marrëdhënieve ku ekziston mundësia për t'u mbështetur gjatë kohëve të vështira (shih më poshtë).

Organizoni një seancë për bërjen e pyetjeve për të marrë njohuri pas një incidenti specifik, të një natyre të ndjeshme apo me profil të lartë

Gabime ndodhin dhe duhen nxjerrë mësim. Shmangeni tërheqjen pas një incidenti të vështirë, si: dhuna në një aktivitet të krenarisë, një incidenti të policimit të dobët ose dhunës së policisë. Mbajini të hapura urat e komunikimit edhe sikur të ketë patur tension lidhur me incidente specifike. Merrni në konsideratë mbajtjen e takimeve jozyrtare kur incidentet diskutohen në mirëbesim, me mirëkuptimin se, para së gjithash, shtypi nuk do të përfshihet. Punoni me OSHC-të për të mundësuar mbështetjen për viktimat, familjen ose komunitetin lidhur me incidente specifike.

Mbështetuni tek arritjet tuaja

Ndonëse mund të keni filluar me hapa të vogla, gjithmonë kërkoni mundësi për të qenë aktivë. Ndoshta sistemi i pikave të takimit po funksionon mirë. Tani mund të jetë koha që të merrni në konsideratë që të bashkëpunoni më nga afër për të diskutuar lidhur me incidentet dhe reagimet. Ju mund të jeni gati që të diskutoni për shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit në mënyrë anonime. Ndoshta mund të jeni dakord për një sistem të referimit të mbështetjes për viktimat.

Sigurohuni që kjo punë të ketë burimet e duhura

Për shembull, shpeshherë, OSHC-të konstatojnë se, ndërsa është e domosdoshme, puna e tyre për monitorimin dhe mbështetjen e viktimave ka gjithashtu burime të pamjaftueshme. Kur është e mundur, është me rëndësi që policia të gjejë burime financiare për punën tek e cila mbështetet.

Jini të qartë lidhur me atë që mund të arrihet ose jo nga të dyja palët

Për shembull, një organizatë e shoqërisë civile nuk mund të garantojë që një viktimë të bëjë kallëzim për një krim apo të marrë pjesë në procesin gjyqësor penal. Po ashtu, policia nuk mund të garantojë që ndjekja penale do të rezultojë e suksesshme në të ardhmen.

“Si do të veprohet më tej”: Planifikimi i hetimit të krimeve të urrejtjes në kontekstin tuaj: kuadri i politikave

HISTORIKU DHE ARSYEJA THEMELORE

Ndërsa mund të rrisë në mënyrë të konsiderueshme aftësinë e policisë për hetimin me efektivitet të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, trajnimi efektiv është vetëm një pjesë e enigmës së një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj ndjekjes së krimeve të urrejtjes. Për shembull, ligjet mbi krimet e urrejtjes mund të parashikojnë vetëm orientimin seksual dhe jo identitetin gjinor, duke e bërë të vështirë që krimet e urrejtjes ndaj personave transgjinorë të hetohen dhe ndiqen penalisht. Formularët që përdor policia për dokumentim mund ta pengojnë policinë që të dokumentojë gjithë aspektet e krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI, kështu që informacioni i rëndësishëm, tani policia ka aftësitë për të arrestuar, thjesht zhduket pa u reflektuar në statistika zyrtare. Procedurat hetimore, që pjesëmarrësit mësuajnë në këtë seancë trajnimi, mund të mos pasqyrohen në protokollet dhe udhëzuesit zyrtarë. Shërbimi i prokurorisë mund të mos i jetë nënshtruar një trajnimi të njëjtë lidhur me krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI dhe, për këtë arsye, mund të jetë më pak i informuar për sa i takon llojit të provave që mund të vërtetojnë motivin paragjykses në këto krime.

Gjatë gjithë seancës së trajnimit, pjesëmarrësit mund t'i kenë identifikuar fare mirë këto dhe të tjera pengesa për zbatimin e përmirësimeve në praktikën e tyre hetimore dhe në mbështetjen për personat LGBTI si viktime. Qëllimi i këtij ushtrimi është që të mbështesë pjesëmarrësit në organizimin e këtyre çështjeve dhe në zbatimin e një qasjeje, që synon zgjidhjen, me qëllim ndjekjen e tyre. Rekomandohet që në këto seanca të marrin pjesë një pjesëtar i lartë i policisë dhe, mundësisht, një përfaqësues i ministrisë apo ministrive përkatëse. Gjithashtu, mund të jetë shumë e dobishme që të jenë të pranishme OSHC-të. Kjo do të rrisë mundësitë që çështjet e rëndësishme të kuptohen dhe të merren vendime për zbatimin e përmirësimeve.

Në këtë modul, pjesëmarrësit inkurajohen që të përcaktojnë kontekstin e tyre kombëtar në bazë të elementeve kryesore të nevojshëm për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj ndjekjes së krimeve të urrejtjes. Ato janë:

- ▶ **Kuadri ligjor:** a i përfshijnë ligjet mbi krimet e urrejtjes orientimin seksual dhe identitetin gjinor si kategori të mbrojtura?
- ▶ **Kuadri dhe sistemi i dokumentimit të krimeve të urrejtjes:** a përfshihen në formularët që përdor policia për dokumentim “kutitë e spontimit” dhe fushat e nevojshme për dokumentimin e treguesve paragjykses lidhur me komuniteti LGBTI, provave të motivit paragjykses dhe perceptimit të viktimës?
- ▶ **Informacione dhe udhëzues:** a ka policia udhëzime të qarta si duhet hetuar krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, si duhet siguruar që viktimat të marrin mbështetje dhe si duhet punuar me prokurorët për ngritjen me sukses të akuzës?
- ▶ **Trajnimi:** a zhvillohen seanca të rregulla trajnimi për policinë lidhur me hetimin e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI? A janë ato në dispozicion për gjithë elementet e policisë?
- ▶ **Shërbimet mbështetëse:** A ekzistojnë shërbime për mbështetjen e viktimave të krimeve të urrejtjes? A i plotësojnë ato nevojat e personave LGBTI?

Është me rëndësi të vihet në dukje se asnjë vend nuk e ka zbatuar plotësisht çdo element të qasjes gjithëpërfshirëse ndaj ndjekjes së krimeve për shkak të urrejtjes, siç parashtrohet më sipër. Për këtë arsye,

ky ushtrim mund të evidentojë boshllëqe të konsiderueshme gjatë zbatimit. Kjo nuk duhet të jetë pengesë për përfundimin e këtij ushtrimi. Qëllimi i tij është që pjesëmarrësit të japin shembullin në përcaktimin e boshllëqeve dhe identifikimin e veprimeve praktike që mund të ndërmerren për trajtimin e boshllëqeve në një a më shumë fusha. Ai është një mundësi për të ecur përpara në mënyrë konstruktive në shkallë vendi.

REZULTATET E PËRFTUARA NGA TË MËSUARIT

Pjesëmarrësit:

- ▶ do të krijojnë një tablo të kontekstit të tyre kombëtar të krimeve të urrejtjes (legjislacion, të dhëna, politikë, trajnim, etj.,) dhe do të identifikojnë boshllëqet aktuale;
- ▶ do të identifikojnë dhe do të kuptojnë pengesat për të zbatuar atë që kanë mësuar gjatë seancës së trajnimit, dhe hapat për trajtimin e këtyre pengesave.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE

- ▶ 6.1 Përcaktimi i boshllëqeve
- ▶ 6.2 Ndërmarrja e veprimeve

6.1: PËRCAKTIMI I BOSHLLËQEVE

1. Përpara seancës së trajnimit, shtypeni në disa kopje fletën më poshtë. Hiqini termat dhe mbajini gati për seancën e trajnimit.

FUSHA
Kuadri ligjor
Informacione dhe udhëzues
Sistemi i dokumentimit të krimeve të urrejtjes
Trajnimi
Shërbimet mbështetëse
Të tjera

2. Merrni një fletë letre për tabelën me fletë të lëvizshme dhe përsëriteni grafikun tek prezantimi 6.1. Përveç kësaj, bëni një kopje letre për çdo pjesëmarrës në mënyrë që të mbajnë shënime në proces e sipër.
3. Urojini pjesëmarrësve mirëseardhjen në seancën e trajnimit dhe shpjegoni se qëllimi i seancës është që të përcaktohet konteksti kombëtar duke përdorur njohuritë që janë marrë gjatë seancës së trajnimit, si dhe njohuritë e tyre ekzistuese.
4. Shpjegoni se do të kërkohet që çdo pjesëmarrës të lexojë me zë të lartë pjesën e vet të letrës dhe të bëjë vlerësimin e vet të kontekstit kombëtar lidhur me termin. Ilustrojeni këtë udhëzim duke përdorur një term, për shembull, "kuadri ligjor", duke dhënë vlerësimin tuaj lidhur me boshllëqet në kuadrin ligjor mbi krimet e urrejtjes. Shpjegoni se më shumë se një person në grup mund të ketë të njëjtin term. Kjo do të thotë se personi i dytë duhet t'i shtojë kontributit të parë hollësi të tjera apo informacionin që mungon.
5. Ndajeni grupin e madh në grupe më të vogla, sipas nevojës (ju mund të doni, gjithashtu, që këtë aktivitet ta zhvilloni në një grup të madh, varet nga ju). Shpërndajini copat e vogla të letrës (grafiku një sipër), duke u siguruar që çdo pjesëmarrës të ketë një të tillë. Në qoftë se pjesëmarrësit do t'i ndani në grupe më të vogla, sigurohuni që në çdo grup të përfshihet të gjitha termat.
6. Drejtojeni vëmendjen e pjesëmarrësve tek grafiku i madh (në qoftë se keni më shumë se një grup, thojuni se do t'u duhet që ta krijojnë sërish grafikun kur të fillojë aktiviteti). Përsëritini termat, për t'u siguruar që të gjithë i kanë kuptuar. Pyesni në qoftë se pjesëmarrësit do të kishin dëshirë të shtonin ndonjë term. Diskutojeni si grup dhe bini dakord nëse duhet shtuar.
7. Thojuni pjesëmarrësve se ky është një rast për ta që të identifikojnë se çfarë duhet bërë për të mbështetur zbatimin e gjithçkaje që ata kanë mësuar gjatë kësaj seance trajnimit. Thojuni se nuk ekzistojnë përgjigje të sakta apo të gabuara; ky është një rast për ta që të përcaktojnë çfarë dinë dhe çfarë duhet bërë.
8. Thojuni ta lënë bosh kolonën e fundit dhe shpjegoni se ajo do të plotësohet gjatë seancës së ardhshme.
9. Jepuni pjesëmarrësve 20-25 minuta kohë që të diskutojnë dhe plotësojnë tabelën.
10. Në qoftë se pjesëmarrësit janë ndarë në grupe, bashkojini sërish.
11. Kërkoni nga çdo grup që të japin opinione vlerësuese lidhur me atë që kanë rënë dakord që të shkruajnë në tabelën e tyre. Moderoni një diskutim të shkurtër për të rënë dakord lidhur me vlerësimin e grupit dhe shtoni pika të tjera që dalin gjatë diskutimit në grup. Në punë e sipër përpiquni që të arrini mirëkuptim për çdo kategori.
12. Inkurajojini pjesëmarrësit që të bëjnë një kopje të tabelës. Kjo mund të realizohet duke i bërë një fotografi tabelës ose duke plotësuar variantin letër.

6.2: NDËRMARRJA E VEPRIMEVE

1. Kjo seancë përmbyll Modulin e Gjashtë. Filloni duke shpjeguar se qëllimi i kësaj seance është që të identifikojë veprimet konkrete dhe konstruktive për përmirësimin e çdo elementi të qasjes gjithëpërfshirëse ndaj ndjekjes së krimeve të urrejtjes. Pranoni se disa veprime janë jashtë mandatit ose kompetencës së pjesëmarrësve; sidoqoftë, puna e bërë këtu mund të shërbejë si një praktikë e mirë për strukturat e larta drejtuese, ministritë etj. Njëkohësisht, theksoni se pikërisht pse mungon një element i qasjes gjithëpërfshirëse (p.sh.: ligjet mbi krimet e urrejtjes), nuk do thotë se nuk është ndërmarrë asnjë veprim.
2. Niseni diskutimin me grupin duke shqyrtuar çdo element. Në varësi të madhësisë së grupit, këtë punë mund ta bëni në grupe të veçanta. Synoni që veprimet t'i kaloni shumë shpejt, duke i inkurajuar pjesëmarrësit që të identifikojnë veprimet që mund të marrin ata personalisht. Në qoftë se janë të pranishëm drejtues të lartë ose përfaqësues të qeverisë, inkurajojini që të marrin pjesë dhe të marrin angazhime për veprime, sado të vogla.
3. Mbylleni aktivitetin duke shpjeguar se ky grafik mund të përdoret si bazë për një plan veprimi në shkallë vendi. Inkurajojini pjesëmarrësit që t'i kthehen grafikut bashkërisht për të monitoruar ecurinë apo për të bërë ndryshime me qëllim që ai të qëndrojë brenda temës. Falënderojini pjesëmarrësit për pjesëmarrjen në aktivitet. Pranoni se ai mund të jetë i vështirë për gjithë policinë në shumë vende, por se ai është një hap thelbësor që duhet bërë në qoftë se kërkohet progres.

PREZANTIME

Prezantimi 6.1: Përcaktimi i boshllëqeve

Fusha	Vlerësimi	Çështje Cilat janë pengesat për ta arritur këtë?	Veprimi Çfarë mund të bëhet tani? Nga cili?
Kuadri ligjor	A i përfshijnë ligjet mbi krimet e urrejtjes orientimin seksual dhe identitetin gjinor si kategori të mbrojtura?		
Informacione dhe udhëzues	A ka policia udhëzime të qarta si duhet hetuar krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, si duhet siguruar që viktimat të marrin mbështetje dhe si duhet punuar me prokurorët për ngritjen me sukses të akuzës?		
Sistemi i dokumentimit të krimeve të urrejtjes	A përfshihen në formularët që përdor policia për dokumentim "kutitë e spontimit" dhe fushat e nevojshme për dokumentimin e indikatorëve (treguesve) të paragjykimeve lidhur me komuniteti LGBTI dhe perceptimit të viktimës?		
Trajnimi	A zhvillohen seanca të rregullta trajnimi për policinë lidhur me hetimin e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI? A janë ato në dispozicion për gjithë policinë?		
Shërbime për mbështetjen e viktimave	A ekzistojnë shërbime për mbështetjen e viktimave të krimeve të urrejtjes? A i plotësojnë ato nevojat e personave LGBTI?		
Tjetër			

VLERËSIMI

Vlerësimi para dhe pas trajnimit me pjesëmarrësit.

Aneksi e Parë (ose Aneks 1): Modeli i Programit të Trajnimit për seanca trajnimi njëditore dhe dyditore

Ky Aneks përmban një model programi për seanca trajnimi njëditore ose dyditore. Për të siguruar kohë dhe angazhim të mjaftueshëm për arritjen e rezultateve kryesore që përftohen nga të mësuarit, rekomandohet që të ndiqet agjenda dyditore. Gjithashtu, rekomandohet që trajnuesit ta rishikojnë Manualin përpara se ta finalizojnë agjendën me qëllim që të sigurohet që, për kontekstin e tyre, janë zgjedhur modulet dhe aktivitetet më të përshtatshme.

Jeni të lutur të lexoni shënimet e plota dhe udhëzimet e Manualit që i përkojnë çdo seksioni të trajnimit. Ato përmbajnë informacion bazë për përgatitjen që duhet bërë përpara trajnimit dhe japin shpjegime të hollësishme të aktiviteteve.

Programi dyditor

9.15-9.30 Hyrje dhe përmbledhje e trajnimit

Pjesëmarrësit prezantohen dhe shprehin pritshmëritë e tyre për trajnimin. Trajnuesi bën një përmbledhje të pikësnyimeve dhe përmbajtjes së trajnimit.

9.30-11.15 Pse jemi këtu?

Këto aktivitete përgatisin tablonë për trajnimin. Në aktivitetin e parë përfshihet kontributi nga një drejtues i lartë i shërbimit policor që përcakton pritshmëritë lidhur me pjesëmarrjen në trajnim dhe zhvillimin në të ardhmen të trajnimit. Në aktivitetin e dytë përfshihet kontributi nga një organizatë e shoqërisë civile që punon nga afër me viktimat e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI, dhe shpjegon natyrën dhe ndikimin e krimeve të urrejtjes.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 1.1: Kontributi nga një drejtues i lartë që përgatit terrenin dhe përcakton pritshmëritë e pjesëmarrësve nga trajnimi.
- ▶ Aktiviteti 1.2: Kontributi nga një organizatë lokale/kombëtare e shoqërisë civile për sa i takon impaktin dhe kontekstin të krimeve të urrejtjes.
- ▶ Aktiviteti 1.3: Konteksti i krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI.

11.15-11.30 Pushim kafeje

11.30-13.00 Koncepte kryesore: Komuniteti LGBTI dhe çfarë janë krimet e urrejtjes?

Në këto aktivitete prezantohen grupet e prekura nga krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI dhe shqyrtohet koncepti i krimeve të urrejtjes në shkallë ndërkombëtare dhe në kontekstin kombëtar.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 2.1: Të kuptuarit e terminologjisë kryesore lidhur me komunitetin LGBTI: prezantimi në seancë plenare nga moderatorët e kursit (30 minuta).
- ▶ Aktiviteti 2.5: Çfarë është krimi i urrejtjes? Prezantimi dhe diskutimi në grup.
- ▶ Aktiviteti 2.7: Përcaktoni kontekstin kombëtar të krimeve të urrejtjes (jeni të lutur, gjithashtu, për më shumë shembuj si duhet përcaktuar konteksti kombëtar të hulumtoni Seksionin "Si do të vepohet më tej").

13.00-13.45 Drekë

13.45-14.45 Të kuptuarit e kallëzimit të pamjaftueshëm

Ky aktivitet mbështet pjesëmarrësit që të kuptojnë dhe të hulumtojnë pse personat LGBTI nuk bëjnë kallëzim për krimet e urrejtjes.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 3.2: Identifikimi i pengesave specifike për sa i takon kallëzimit të krimeve të urrejtjes me të cilat përballen komuniteti LGBTI; leximi i raportit të FRA-së.

14.45-15.45 Të drejtat e njeriut dhe roli i punonjësit të policisë

Në këtë aktivitet shqyrtohen vendimet kryesore gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ato zbatohen për rolin e oficerit të policisë, kur heton krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 3.3: Të kuptuarit e standardeve kryesore të Këshillit të Evropës, të standardeve të tjera për të drejtat e njeriut dhe të standardeve kombëtare për ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI.

15.45-16.00 Pushim kafeje

16.00-17.30 Hetimi i krimeve për shkak të urrejtjes

Në këto aktivitete pjesëmarrësit inkurajohen që të shqyrtojnë hetimin me efektivitet të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI dhe rëndësinë e zbatimit të një qasjeje që ka në qendër viktimën.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 4.2a: Hetimi i krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI: një qasje që vendos në qendër viktimën (30 minuta)
- ▶ Aktiviteti 4.2b: Hetimi i krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI: një qasje që vendos në qendër viktimën

Dita e dytë

9.00-9.15 Mirëseardhja, përmbledhje e ditës së parë dhe një pasqyrë e ditës së dytë

9.15-11.30 (përfshirë pushimin e kafesë) Mbledhja e provave

Në këto aktivitete ofrohet mbështetje për pjesëmarrësit që të bëjnë identifikimin e treguesve të paragjykitimit në krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, dhe që t'i përdorin këto prova për të bërë hetime të suksesshme të krimeve të urrejtjes.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 4.4: Mbledhja e provave: indikatorët e paragjykitimeve – vërtetimi i përzgjedhjes / motiveve paragjykuese
- ▶ Aktiviteti 4.5: Mbledhja e provave: indikatorët e paragjykitimeve – identifikimi i krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI

(Gjithashtu, rekomandohet që pjesëmarrësve t'u shpërndahet prezantimi 5.1.)

11.30-12.30 Ofrimi i mbështetjes për komunitetin LGBTI: reagimi efektiv i policisë

Në këtë aktivitet përdoren raste studimore për të shqyrtuar si duhet reaguar kundër incidenteve specifike në një mënyrë të përshtatshme për komuniteti. Aktiviteti është interaktiv dhe është një mundësi për të hulumtuar stereotipet në mënyrë të ndjeshme dhe praktike.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 4.7: Ofrimi i mbështetjes për komunitetin LGBT: reagimi efektiv i policisë

12.30-13.30 Drekë

13.30-14.45 Puna me organizatat e shoqërisë civile

Në këtë aktivitet përdoret një vendim kryesor gjyqësor i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të shqyrtuar si mund të bashkëpunojë policia me OSHC-të me qëllim përmirësimin e policimit në kontekstin e një aktiviteti të paradës së krenarisë dhe mbështetjen e të drejtës së lirisë së tubimit pa diskriminim.

- ▶ Aktiviteti 5.1: Çfarë janë organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) dhe si mund të ndihmojnë ato?
- ▶ Aktiviteti 5.2: "Po të isha në vend të tyre: për çfarë kam nevojë dhe çfarë mund të bëj?"

14.45-15.00 Pushim kafeje

15.00-16.30 Puna me organizatat e shoqërisë civile (vazhdimi)

Në këto aktivitete ofrohet mbështetje për pjesëmarrësit, në rrethana ideale në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, për të identifikuar dhe zbatuar hapa specifike që mund të ndërmerren për të bashkëpunuar me qëllim ofrimin e mbështetjes viktimave dhe përmirësimin e monitorimit të krimeve të urrejtjes.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 5.3: Krijimi i marrëdhënieve efektive me komuniteti

16.30-17.00 Mbyllja dhe vlerësimi

Gjatë kësaj seance, trajnuesi mbyll trajnimin dhe fton pjesëmarrësit të plotësojnë vlerësimin.

HETIMI I KRIMEVE TË URREJTJES KUNDËR PERSONAVE LGBTI: TRAJNIM PËR NJË PËRGJIGJE PROFESIONALE NGA ANA E POLICISË

Programi njëditor

Shënime për trajnuesin: Një seancë njëditore mund të përqendrohet vetëm tek çështjet themelore që lidhen me policimin e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI. Kufizimet kohore nënkuptojnë se ka më shumë gjasë që informacioni të jepet përmes prezantimit dhe jo përmes punës në grup. Për rrjedhojë, pjesëmarrja, një nga teknikat më të suksesshme për të mësuar, do të jetë detyruesisht e kufizuar. Kur është e mundur, është më mirë që një seancë trajnimi të zgjasë të paktën dy ditë.

9.15-9.30 Hyrje dhe përmbledhje e trajnimit

Pjesëmarrësit prezantohen dhe shprehin pritshmëritë lidhur me trajnimin. Trajnuesi bën një përmbledhje të pikësnyimeve dhe përmbajtjes së trajnimit.

9.30-11.00 Pse jemi këtu?

Këto aktivitete përgatisin tablonë për trajnimin. Në aktivitetin e parë përfshihet kontributi nga një drejtues i lartë i shërbimit policor që përcakton pritshmëritë lidhur me pjesëmarrjen në trajnim dhe zhvillimin në të ardhmen të trajnimit. Në aktivitetin e dytë përfshihet kontributi nga një organizatë e shoqërisë civile që punon nga afër me viktimat e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI, dhe shpjegon natyrën dhe ndikimin e krimeve të urrejtjes.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 1.1: Kontributi nga një drejtues i lartë që përgatit terrenin dhe përcakton pritshmëritë lidhur me trajnimin.
- ▶ Aktiviteti 1.2: Kontributi nga një organizatë lokale/kombëtare e shoqërisë civile për sa i takon ndikimit dhe kontekstit të krimeve të urrejtjes.

11.00-11.30 Pushim kafeje

11.30-13.00 Koncepte kryesore: Komuniteti LGBTI dhe çfarë është krimet e urrejtjes?

Në këto aktivitete prezantohen grupet e prekura nga krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI dhe shqyrtohet koncepti i krimeve të urrejtjes në shkallë ndërkombëtare dhe në kontekstin kombëtar.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 2.1: Të kuptuarit e terminologjisë kryesore lidhur me komunitetin LGBTI.
- ▶ Aktiviteti 2.5: Çfarë është krimet e urrejtjes?
- ▶ Aktiviteti 2.7: Përcaktoni kontekstin kombëtar të krimeve të urrejtjes (jeni të lutur, gjithashtu, për më shumë shembuj si duhet përcaktuar konteksti kombëtar të hulumtoni seksionin "Si do të vepohet më tej").

13.00-13.45 Drekë

13.45-14.45 Të drejtat e njeriut dhe roli i oficerit të policisë

Në këto aktivitete shqyrtohen vendimet kryesore gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ato zbatohen për rolin e oficerit të policisë, kur heton krime për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 3.3: Të kuptuarit e standardeve kryesore të Këshillit të Evropës, të standardeve të tjera për të drejtat e njeriut dhe të standardeve kombëtare për ndjekjen e krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI.

14.45-15.45 Hetimi i krimeve për shkak të urrejtjes

Në këto aktivitete pjesëmarrësit inkurajohen që të shqyrtojnë hetimin me efektivitet të krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI dhe rëndësinë e zbatimit të një qasjeje që ka në qendër viktimën.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 4.2a: Hetimi i krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI: një qasje që vendos në qendër viktimën.
- ▶ Aktiviteti 4.2b: Hetimi i krimeve për shkak të urrejtjes kundër personave LGBTI: një qasje që vendos në qendër viktimën.

15.45-16.00 Pushim kafeje

16.00-17.00 Mbledhja e provave

Në këto aktivitete ofrohet mbështetje për pjesëmarrësit që të bëjnë identifikimin e treguesve të paragjyqimeve në krimet e urrejtjes kundër personave LGBTI, dhe që t'i përdorin këto prova për të bërë hetime të suksesshme të krimeve të urrejtjes.

Lista e aktiviteteve:

- ▶ Aktiviteti 4.4: Mbledhja e provave: indikatorët e paragjyqimeve – vërtetimi i përzgjedhjes/motivit paragjyques.
- ▶ Aktiviteti 4.5: Mbledhja e provave: indikatorët e paragjyqimeve – identifikimi i krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI.

(Gjithashtu, rekomandohet që pjesëmarrësve t'u shpërndahet prezantimi 5.1.).

17.00-17.15 Mbyllja dhe vlerësimi

Gjatë kësaj seance, trajnuesi përfundon trajnimin dhe fton pjesëmarrësit të plotësojnë vlerësimin.

Policia është në vijën e frontit të sistemit të drejtësisë penale dhe pika e parë e kontaktit për shumë viktima të krimit të urrejtjes. Ky manual është krijuar për trajnerë të policisë, prokurorë, drejtues në polici, oficerët e policisë që hetojnë krimet e urrejtjes dhe oficerët e policisë që punojnë në vijën e frontit me qytetarët, në vendet e të gjithë rajonit të Këshillit të Evropës, për të zhvilluar aftësi thelbësore në identifikimin dhe hetimin e krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI.

Ky manual u përkthye dhe redaktua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të asnjë pale.

SQI

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën, diversitetin, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

